



AGJENCIA E SIGURIMIT TË CILËSISË NË ARSIMIN E LARTË

**RAPORTI I VLERËSIMIT TË JASHTËM**

**Programi i Studimit të Ciklit të Parë Bachelor në:**

**Administrim - Biznes**

**Universiteti "Luigj Gurakuqi", Shkodër.**

**Grupi i Vlerësimit të Jashtëm:**

**Prof. Dr. Ermira QOSJA**

**Prof. Asoc. Elena KOKTHI**

**Nëntor / 2023**

**TABELA PËRMBLEDHËSE E TË DHËNAVE TË PROGRAMIT TË STUDIMIT****Bachelor në "Administrim Biznes"**

1	IAL aplikues:	Universiteti "Luigj Gurakuqi"
2	Njësia bazë që e ofron:	Departamenti Administrim - Biznesit
3	Emërtimi i programit të studimit:	Bachelor në Administrim - Biznes
4	Urdhëri/VKM i licencimit:	VKM Nr. 349, datë 10.08. 1992
5	Urdhëri/VKM i riorganizimit:	-
6	Forma e regjistrimit të diplomës:	Urdhër i QSHA Nr. 231, datë 28.05.2021
7	Urdhëri/VBA i akreditimit të parë:	-
8	Cikli i studimit:	Cikli i parë
9	Kohëzgjatja e programit të studimit:	3 vite akademike / 6 semestra
10	Kreditet në total (ECTS):	180 kredite ECTS
11	Forma e studimit:	Me kohë të plotë
12	Gjuha (shqip/tjetër):	Gjuha shqipe
13	Programi ofrohet në bashkëpunim me institucione të tjera:	-
14	Diplomë e përbashkët (shëno emërtimin):	-
15	Diplomë e dyfishtë (shëno emërtimin):	-
16	Niveli në kornizën kombëtare të kualifikimeve:	Niveli i 6 (gjashtë)
17	Stafi akademik PAE/PAK për programin e studimit 2022- 2023	10 PAE / 6 PAK Për sa i përket ngarkesës (88 % / 12 %)
18	Numri i studentëve:	Viti 2020-2021 – 80 studentë Viti 2021-2022 - 101 studentë Viti 2022-2023 – 104 studentë
19	Komente / të tjera:	-



## **PËRMBLEDHJE E TË DHËNAVE PËR PROGRAMIN NË PROCES TË VLERËSIMIT TË JASHTËM**

Universiteti “Luigj Gurakuqi”, Shkodër (UNISHK) është një institucion publik i arsimit të lartë, i themeluar me Vendim të Këshillit të Ministrave Nr.150 dt.18.04.1957, fillimisht si Instituti Pedagogjik 2 vjeçar dhe më pas me VKM 124, dt.. 28.05.1991 si Universiteti “Luigj Gurakuqi” i Shkodrës. UNISHK ka kaluar akreditimin e parë institucional me Vendim të Bordit të Akreditimit Nr. 70, datë 21.09.2017, riakreditimin institucional me Vendim BA Nr. 3, datë 24.01.2020, me kohëzgjatje 4 vite akademike, afati vlefshmërisë deri më 23.01.2024. Universiteti “Luigj Gurakuqi” sipas strukturës aktuale ka në përbërjen e tij gjashtë fakultete emërtuar si vijon:

1. Fakulteti i Shkencave Shoqërore;
2. Fakulteti i Shkencave të Natyrës;
3. Fakulteti i Shkencave të Edukimit;
4. Fakulteti i Drejtësisë;
5. Fakulteti i Ekonomisë;
6. Fakulteti i Gjuhëve të Huaja;

Fakulteti Ekonomisë i UNISHK është themeluar më 13.05.1996, ndërsa Departamenti i Administrim Biznesit është hapur me VKM Nr. 349, datë. 10.08.1992, fillimisht brenda Fakultetit të Shkencave të Natyrës. Departamenti i Administrim biznesit është departamenti pionier i Fakultetit të Ekonomisë që sot në përbërje të tij ka:

1. Departamentin e Administrim Biznesit;
2. Departamentin e Financë – Kontabilitet;
3. Departamentin e Turizmit;

Në strukturën e programeve të Departamentit të Administrim Biznesit bëjnë pjesë 3 programe studimi: Bachelor në Administrim Biznes, Master Profesional në Administrim Biznes 120 ECTS; dhe Master i Shkencave në Administrim Biznes 120 ECTS, të cilat janë hartuar në përputhje me Ligjin e fundit të Arsimit të Lartë Nr.80/2015, udhëzimet që pasuan atë dhe në përputhje me Kornizën Shqiptare të Kualifikimeve.

Prioritetet e programit BA në AB janë në përputhje të plotë me ato të UNISHK, ky program synon të bëhet një faktor kyç në disiplinën e menaxhimit dhe lidërsipit në rajonin e Shkodrës. Një nga pikat e forta të programit është që për shkak të traditës së tij, ka ruajtur numrat e studentëve dhe në 3 vitet e fundit, madje ka qenë në rritje Objektiva të rëndësishme të këtij programi janë dhe lidhja e studentëve me tregun e punës dhe ndërkombëtarizimi.

## **PËRSHKRIMI I PROCESIT TË VLERËSIMIT TË JASHTËM;**

ASCAL, bazuar në "Manualin për Procedurat dhe Afatet për Vlerësimin e Cilësisë në kuadër të Akreditimit të Institucioneve të Arsimit të Lartë dhe programeve të studimit 2017", ka përzgjedhur dy vlerësues të jashtëm për të shqyrtuar dokumentacionin e përcjellë nga Institucioni, për të kryer vizitën në institucion dhe për të përpiluar raportin e vlerësimit të jashtëm. Grupi i vlerësimit të jashtëm ka në përbërje: Prof. Dr. Ermira Qosja dhe Prof. Asoc. Dr. Elena Kokthi. Gjatë gjithë fazës së vlerësimit të jashtëm ky grup pune u asistua dhe nga menaxherja teknike e ASCAL, Znj. Majlinda Demimeli.

Procesi i vlerësimit të jashtëm për akreditimin e programit të studimit Bachelor në "Administrim Biznes", i ofruar nga Departamenti i Administrim Biznesit të Fakultetit të Ekonomisë pranë UNISHK, filloi me prezantimin, si dhe ndarjen e punës ndërmjet ekspertëve të grupit të vlerësimit të jashtëm. Më pas ky grup, bazuar në dokumentacionin e vendosur në dispozicion nga e-ASCAL, filloi shqyrtimin e Raportit të Vlerësimit të Brendshëm, si dhe dokumentet përkatëse në mbështetje të tij. Gjatë kësaj faze u identifikuan dhe u listuan një sërë pyetjesh, që kishin lidhje me standardet dhe kriteret përkatëse, të cilat do të merrnin përgjigje gjatë takimeve që do të realizoheshin në IAL.

Vizita në UNISHK, u realizua në datën 12 dhe 13 Korrik 2023, ku Grupi i Vlerësimit të Jashtëm, realizoi takimet e përcaktuara sipas agjendës së vizitës në IAL. Gjatë vizitës, në UNISHK. Grupi i Vlerësimit të Jashtëm (GVJ) zhvilloi takime me: Përgjegjës të Departamentit të Administrim Biznesit dhe zvDekanan e Fakultetit të Ekonomisë (Dekani i Fakultetit e kishte deleguar takimin e tij), Grupin e Vlerësimit të Brendshëm, stafin akademik të programit të studimit, stafin e Drejtorisë së Kurrikulave dhe të sigurimit të brendshëm të cilësisë, Zyrën e Burimeve Njerëzore, përfaqësues të Zyrës së Karrierës dhe Alumnit, Marketingut, Ndërkombëtarizmit dhe Projekteve; si dhe me Sekretarinë mësimore.

GVJ zhvilloi gjithashtu intervista me studentët e programit, vizitoi Bibliotekën e Institucionit si dhe vëzhgoi mjediset e institucionit si: auditorë, laboratorë, shërbimet për studentët, etj. Gjatë takimeve të realizuara sipas agjendës, u shqyrtuan çështje të ndryshme që lidhen me vlerësimin e programit të studimit bachelor në AB, duke sqaruar edhe elementë të veçantë, për të cilat ekspertët kanë drejtuar pyetjet përkatëse. Pas vizitës në IAL, GVJ hartoi raportin e vlerësimit të jashtëm, bazuar në dokumentacionin në dispozicion nga dosja e vlerësimit të brendshëm, informacioni i depozituar në sistemin e informacionit të ASCAL, si dhe në informacionin e mbledhur gjatë takimeve dhe vizitës të realizuar në Institucion. Në përfundim të këtij procesi ky grup dorëzon draft-raportin pranë ASCAL, si më poshtë vijon.

Universiteti "Luigj Gurakuqi", Shkodër është njohur me Draft-Raportin e Vlerësimit të Jashtëm më datë 28.09.2023, përmes sistemit AMS, si dhe në formë zyrtare me anë të shkresës me Nr. 221/35 Prot, datë 28.09.2023. Universiteti "Luigj Gurakuqi", më datë 09.10.2023, njofton me anë të shkresës me Nr. 1407 Prot, datë 05.10.2023 "Përgjigje ndaj Draft Raportit të Vlerësimit të Jashtëm".

*Ekspertët e vlerësimit u njohën me këto komente dhe japin argumentat si më poshtë:*

### **1. Për Komentin që i përket konkluzioneve të standardit Standartit II.3:**



Konkluzioni: "GVJ vlerëson dhe rekomandon rregullimin në numrin total të orëve të programit, përshtatjen e programit me nevojat e tregut, rishikimi tërësisë së lëndëve që ofrohen, futja e disa lëndëve të reja që lidhen me zhvillimet e fundit teknologjike, zvogëlimi i peshës së lëndëve të finance-kontabilitetit, kalimi i disa lëndëve në MA dhe anasjellteas. formulimi i silabuseve në përputhje me VKM 41/2018 dhe në gjuhën angleze si dhe një mënyrë vlerësimi kah vlerësimin të vazhduar (pra me pak peshë provimi final), përditësimi i literaturës". Ju informojmë që në fakt ne kemi reaguar në avancë dhe kemi bërë ndryshimet.

- Këtë vit akademik silabuset e lëndëve janë realizuar në përputhje me VKM 41/2018. (Bashkengjitur model i Silabus lende "Menaxhim dhe "Komunikim);
- Gjithashtu janë pasqyruar ndryshime edhe në lidhje me vlerësimin. Është ulur pesha e vlerësimin përfundimtar për studentët dhe është rritur pesha që ka vlerësimi gjatë vitit, në ato lëndë që nuk ka qenë kjo hapësirë;
- Janë pasqyruar në silabuset e këtij viti literature e fundit. Libra të përkthyer dhe përshatur nga AADF janë ofruar si literaturë bazë;
- Ne planin mësimor do të realizojmë edhe ndryshime të tjera duke iu referuar sugjerimeve të bëra, por ndryshime që do realizohen gradualisht, duke u përpjekur të ruajmë (%) përqindjen e ndryshimeve të lejuara;
- Ndër vite gradualisht kemi bërë ndryshime të tilla: Lënda "Drejtimit Projektsh" ka qenë lëndë me zgjedhje tashmë është lëndë bazë;
- "Ekonomiksi i Tregut të punës" ka qenë lëndë te Master Profesional tashmë e kemi te lëndë me zgjedhje në Bachelor;
- Sot, në planin mësimor të këtij viti kemi "Sipërmarrje dhe menaxhim i biznesit të vogël", etj;

### **Argumentimi i GVJ**

GVJ vlerëson si pozitive proaktivitetin e IAL për të bërë përmirësimet që janë rekomanduar në RVJ por vlerësimi është bazuar mbi dokumentacionin dhe vizitën që kemi realizuar në IAL, prandaj përmirësimet ex post do të konsiderohen në procesin akreditues vijues. Për sa me sipër vlerësimi i standartit nuk ndryshon

### **2. Për Komentin që i përket përmbushjes së Fushës VI:**

Në lidhje me Standartin VI - Sigurimi i Cilësisë së Programit të Studimit Bachelor që e kemi Përmbushur Kryesisht (kemi Stadanrti VI.1; Standarti VI.2 dhe Standarti VI.3 që përmbushen kryesisht dhe dy standartet e tjera përmbushen plotësisht) po punohet nga departamenti dhe zyrat përkatëse për plotësimin e këtyre standartave dhe krijimin e sinergjise institucionale.

Në Standartin VI.2

Konkluzioni i GVJ-së "Si u përmend edhe më sipër IAL disponon akte normative dhe rregullatore, dhe strategji sektoriale në nivel UNISHK, por nevojitet operacionalizim dhe hapa konkretë të përmbushur në drejtimet që janë vendosur nga IAL". Në Draft Raport janë përmendur me detaje të gjithë instrumentat e përdorura për sigurimin e cilësisë. Strategji, Statuti i UNISHK, Manuali i Cilësisë, Rregullore NJSBC-je, Raporte materiale, aktivitete te NJSBC-së së FE-se, Zyra e Cilësisë si dhe Komisioni Përhershëm për Garantimin e Standarteve të Cilësisë. Ne si departament kemi edhe përfaqësuesit tonë në NJSBC-në e Fakultetit, si dhe

përfaqësuesin e departamentit në Komisionin e Përhershëm për Garantimin e Standarteve të Cilësisë të UNISHK. Përveç pyetësorëve të realizuara nga Universiteti, ne kemi si praktikë disa vjeçare në fakultet, zhvillimin edhe të pyetësorëve për stafin akademik të brendshëm dhe të jashtëm.

### **Argumentimi i GVJ**

GVJ i është referuar të gjithë dokumentacionit të paraqitur pranë ASCAL dhe nga vlerësimi por edhe diskutimeve që u realizuan gjatë vizites në IAL qëndrojmë të mendimit që NJSBC në bashkëpunim me njësinë bazë dhe kryesore duhet të bëjë përpjekje për të krijuar një plan hartimi, vlerësimi dhe monitorimi të cilësisë duke u bazuar jo vetëm te një pyetësor që realizohet me studentët apo stafin. Ashtu si jemi shprehur në RVJ paraqiten si pika të dobëta:

1. Mungesa e një sinergjie institucionale në funksion të planifikimit, vlerësimit dhe monitorimit të cilësisë (*Standardi IV.6 /Kriteri 4*);
2. Mungesa e një raporti vlerësimi cilësie 360 gradë, Raporti permbledhes mbi NJSBC në nivel fakulteti 2023 ofron vetëm një përgjigje të reduktuar të gjetjeve të pyetësorit të studentëve pa një narrative konkrete në lidhje me masa të tjera për sigurimin e cilësisë (*Standardi VI.1 /Kriteri 2*);
3. Me termin operacionalizim nënkuptojmë një IAL duhet të hartojë mekanizma të tjerë që sigurojnë cilësinë duke u mbështetur edhe në praktikat të mira që ekzistojnë në IAL në vend dhe jashtë, psh pyetësor drejtuar alumnit, pyetësor drejtuar biznesit lidhur me nevojat e tyre, realizimi fokus grupesh duke pasur parasysh numrin e ulët të përgjigjive nga shpërndarja e pyetësorëve online;
4. Institucionalizim i vlerësimit të syllabuseve, dhe përditësimit të literaturës, etj janë elementë të cilët duhet ti shtohen paketës së vlerësimit për të siguruar cilësinë e programit të studimit. **Për sa me sipër vlerësimi i standartit nuk ndryshon.**





**I. OFRIMI I PROGRAMIT TË STUDIMEVE**

<b>Standardi I.1</b>	
<b>Institucioni i arsimit të lartë ofron programe studimi në përputhje me misionin dhe qëllimin e tij, me fushën akademike të njësisë kryesore dhe bazë përgjegjëse për programin e studimit, e që synon ruajtjen e interesave dhe vlerave kombëtare.</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<p><b>Kriteri 1.</b> Institucioni i arsimit të lartë ofron programe studimi që nuk bien ndesh me interesat kombëtare dhe synojnë ruajtjen dhe konsolidimin e vlerave akademike e kulturore kombëtare.</p>	<p>Universiteti “Luigj Gurakuqi”, Shkodër zhvillon të gjithë veprimtarinë e tij, në përputhje me Ligjin Nr. 80 të vitit 2015 për Arsimin e Lartë në Republikën e Shqipërisë. Bazuar në misionin e UNISHK, për të krijuar, transmetuar, zhvilluar dhe mbrojtur dijet përmes mësimdhënies, kërkimit shkencor dhe një sërë aktiviteteve, njësitë kryesore dhe njësitë bazë të UNISHK ofrojnë 59 programe në 3 ciklet e studimit dhe 2 programe me karakter profesional.</p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Programi i studimit hartohet dhe ofrohet në përputhje me qëllimet dhe misionin e institucionit, si dhe fushën e veprimtarisë.</p>	<p>Fakulteti i Ekonomisë i UNISHK është themeluar më 13.05.1996, ndërsa Departamenti i Administrim Biznesit është hapur me VKM Nr. 349, dt. 10.08.1992, fillimisht si pjesë e Fakultetit të Shkencave të Natyrës, për t’u bërë në këtë mënyrë departamenti themelues i fakultetit.</p> <p>Në takimin me Zv dekanen e Fakultetit dhe Përgjegjësen e Departamentit të Administrim- Biznesit, u theksua që programet e Fakultetit të Ekonomisë në hapje u mbështetën në përvojën e disa universiteteve amerikane, përfshirë këtu Universitetin e Illinoisit të Jugut apo atë të Nebraskës, duke synuar një rol të rëndësishëm rajonal (e më gjerë) në formimin e kapitalit human, për të vijuar me kontribut në rritjen ekonomike, zhvillimin e qëndrueshëm dhe inovacionin në sipërmarrjet shqiptare.</p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Programi i studimit hartohet dhe ofrohet në përshtatje dhe në zbatim të strategjisë për zhvillim, të Statutit dhe Rregullores së Institucionit si dhe me fushat e drejtimet akademike të tij.</p>	<p>Programi BA në AB është në përputhje me dokumentat e qeverisë shqiptare, si: Strategjia Kombëtare për Arsimin (2021-2026); Strategjia Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim (2015-2020) dhe natyrisht në përputhje Strategjinë e Zhvillimit të UNISHK për periudhën 2022-2026. Tërësia e programeve bachelor që FE-UNISHK ofron i shërben formimit të profesionistëve për tregun e punës lokal, kombëtar e më gjerë në ditët e sotme. Programi fillimisht ka qenë 4 vite studimi, më pas në përputhje me ndryshimet ligjore është përshtatur dhe emërtuar në program bachelor në Administrim Biznesi. Duhet thënë që në vite ky program studimi ka mundur të ruajë</p>

	<p>avantazhet e tij, në këtë drejtim kontribuon dhe stabiliteti në rekrutimin e studentëve në vite.</p> <p><i>Megjithatë GVJ vlerëson që, fakulteti duhet të qaset përmes një studimi tregu të fokusuar në programet që ofron, duke hulumtuar në përvoja europiane dhe rajonale të ngjashme, testuar nevojat e tregut shqiptar dhe europian, si dhe duke vlerësuar nevojat reale, sjelljet e qëndrimet e studentëve në këtë epokë të re.</i></p> <p><i>Dokumenti 1.1. Statuti i UNISHK</i></p> <p><i>Dokumenti 1: VKM Nr. 349, dt. 10.08.1992</i></p> <p><i>Dokumenti 13. XIII: Guida e universitetit</i></p> <p><i>Dokumenti 8. VIII: Strategjia e zhvillimit 2022-2026</i></p> <p><i>Dokumenti 4: RVB BA administrim biznes</i></p> <p><i>Dokumenti 2.27: Studim i tregut të punës 2018</i></p>																								
<p><b>Kriteri 4.</b> Institucioni demonstroi se ka përvojën, kapacitetet dhe burimet e duhura në fushën akademike specifike për ofrimin e një programi studimi në atë fushë.</p>	<p>Programi i studimit BA në AB mbështetet në një përvojë 30 vjeçare, e cila është vlerë e shtuar në drejtim të konsolidimit dhe besueshmërisë të tij, por nga ana tjetër shtrihet nevojën për përmirësime, përshtatje dhe ndryshime në disa lëndë, thelbësore kjo qasje për shkak të zhvillimeve shumë agresive që vijnë nga tregu dhe impakti teknologjisë e digjitalizimit.</p> <p>Fakulteti Ekonomik në vitin akademik 2020-2021 ka gjithsej 67 pedagogë, nga të cilët 30 janë pedagogë efektiv (PAE) dhe 37 pedagogë me kontratë (PAK), me kualifikimin e mëposhtëm: (6.7 Mbledhje e asamblese se fakultetit)</p> <table border="1" data-bbox="587 1245 1342 1632"> <thead> <tr> <th rowspan="2">Kualifikimi i stafit</th> <th colspan="2">Fakulteti Ekonomik</th> </tr> <tr> <th>PAE</th> <th>PAK</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td>Prof.Dr</td> <td>2</td> <td>-</td> </tr> <tr> <td>Prof.Asoc</td> <td>8</td> <td>-</td> </tr> <tr> <td>Dr/PhD</td> <td>15</td> <td>9</td> </tr> <tr> <td>Msc</td> <td>5</td> <td>28</td> </tr> <tr> <td><b>Gjithsej</b></td> <td><b>30</b></td> <td><b>37</b></td> </tr> </tbody> </table> <p>Ndërsa Departamenti i Administrim Biznesit, si njësi bazë përgjegjëse për programin e studimit për vitin akademik 2022-2023, ka këtë paraqitje:</p> <table border="1" data-bbox="587 1827 1342 1908"> <thead> <tr> <th>Kualifikimi i stafit</th> <th>Departamenti i Administrim Biznesit</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td></td> <td></td> </tr> </tbody> </table>	Kualifikimi i stafit	Fakulteti Ekonomik		PAE	PAK	Prof.Dr	2	-	Prof.Asoc	8	-	Dr/PhD	15	9	Msc	5	28	<b>Gjithsej</b>	<b>30</b>	<b>37</b>	Kualifikimi i stafit	Departamenti i Administrim Biznesit		
Kualifikimi i stafit	Fakulteti Ekonomik																								
	PAE	PAK																							
Prof.Dr	2	-																							
Prof.Asoc	8	-																							
Dr/PhD	15	9																							
Msc	5	28																							
<b>Gjithsej</b>	<b>30</b>	<b>37</b>																							
Kualifikimi i stafit	Departamenti i Administrim Biznesit																								



	PAE	PAK
Prof.Dr	-	-
Prof.Asoc	2	-
Dr/PhD	8	5
Msc	-	8
<b>Gjithsej</b>	<b>10</b>	<b>13</b>

*Duke ju referuar dhe takimit në institucion, ekspertët vlerësojnë që në planet e Departamentit dhe Fakultetit duhet të jetë dhe angazhimi si të ftuar në auditor i pedagogëve nga universitetet e tjera (veçanërisht të Tiranës dhe Ballkanit Perëndimor, apo më gjerë) për të sjellë një dinamikë dhe përjasje më proaktive. Shpesh gjatë vizitës të krijohej përshtypja për nevojën e një sinergjie të re në institucion, për më shumë bashkëpunim dhe lidhshmëri nga instancat më të larta, në mënyrë që të mundin të ruajnë avantazhin e numrit të studentëve dhe të impaktit në Veriun e Shqipërisë..*

*Dokumenti 7.VII: Strategjia e tregut të punës 2017 dhe 2022*  
*Dokumenti 1.1.c: Strategjia e tregut të punës 2022-2026*  
*Dokumenti 1.15 dhe 1.16: Programi BA në AB sipas viteve*  
*Dokumenti Viti I, Viti II dhe Viti III: Silabuset sipas viteve dhe lëndëve*  
*Dokumenti 6.11: PAE/PAK të dhëna për programet e FE*  
*Dokumenti 4.4: Curriculum vitae pedagogët*

**Kriteri 5.** Fusha e përgjithshme dhe specifike e programit të studimit duhet të jetë në përputhje me fushën akademike e kërkimore të njësisë kryesore / bazë, përgjegjëse për programin e studimit, sipas klasifikimit/kodifikimit të programeve të studimit sipas direktivave dhe udhëzimeve kombëtare e evropiane.

Ky program studimi ofrohet nga Departamenti i Administrim Biznesit si pjesë e Fakultetit të Ekonomisë. Ky fakultet është i organizuar në tre njësi bazë:

1. Departamenti i Administrim Biznesit;
2. Departamenti i Financës;
3. Departamenti Turizmit;

Përputhshmëria e programit të studimit Bachelor në Administrim Biznesi me fushën akademike e kërkimore të Fakultetit të Ekonomisë është bërë e mundur nga kodifikimi i programeve të studimit dhe lëndëve. E reflektuar edhe në dokumentat strategjike të departamentit, fakultetit dhe UNISHK, programi ka për qëllim që studentët të marrin njohuri teorike dhe praktike për të qënë sa më të aftë dhe konkurrues

	<p>në fushën e ekonomisë dhe biznesit si dhe tregut lokal apo ndërkombëtar të punës.</p> <p><i>Dokumenti 2. II: Rregullore e studimit në UNISHK</i>  <i>Dokumenti 1.17: Rregullore e departamentit të AB</i>  <i>Dokumenti 1.17: Rregullore e programit të studimit BA në AB</i></p>			
<b>Konkluzione</b>	<p>GVJ vlerëson që Departamenti AB përmbush plotësisht këtë standard dhe <u>sugjeron</u> një përjasje më proaktive ndaj ndryshimit dhe përshtatjes me dinamikat që koha shtron përpara universiteteve.</p>			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>		<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				X

### Standardi I.2

**Institucioni i arsimit të lartë siguron marrëdhënie bashkëpunimi me institucione, kompani, palë të treta, aktorë të biznesit vendas dhe/ose të huaj në funksion të realizimit të programit të studimit, në kuadër të aftësisë profesionale, kërkimit shkencor dhe mobilitetit.**

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p><b>Kriteri 1.</b> Institucioni për hartimin, mbikëqyrjen dhe mbarëvajtjen e programit, siguron marrëdhënie të frytshme bashkëpunimi brenda institucionit nëpërmjet ndarjes së detyrave mes njësive e personelit, marrjes së përgjegjësisë përkatëse dhe analizës së vazhdueshme të punës së tyre.</p>	<p>UNISHK drejton të gjithë veprimtarinë e vet akademike dhe administrative në përputhje me Ligjin e Arsimit të Lartë Nr. 80/2015 dhe udhëzimet e MAS, mbi këtë bazë është hartuar Statuti dhe rregullorja e Universitetit “Luigj Gurakuqi”.</p> <p>Nga pikëpamja procedurale dhe e rregulloreve, njësitë kryesore dhe bazë kanë hartuar rregulloret e tyre, të cilat drejtojnë veprimtarinë e përditshme të tyre. Gjithashtu, për çdo vit akademik miratohet struktura akademike e universitetit dhe organika e tij. Një dokument që përcakton organizimin dhe funksionimin e mekanizmave të cilësisë, të mekanizmave dhe procedurave të sigurimit të cilësisë në nivel institucional është Manuali i Cilësisë, i miratuar me vendim senati të UNISHK më 13.04.2022</p> <p><i>Dokumenti 1.1. Statuti i UNISHK</i>  <i>Dokumenti 2. II: Rregullore e studimit në UNISHK</i>  <i>Dokumenti 1.a: Rregullore e Fakultetit</i>  <i>Dokumenti 1.17: Rregullore e departamentit të AB</i>  <i>Dokumenti 1.17: Rregullore e programit të studimit BA në AB</i></p>

	<p><i>Dokumenti 2.3.4. Miratimi NJSBC dhe rregullore</i></p> <p><i>Dokumenti 2.14: Procedurë dhe dokumentat për praktikën mësimore</i></p> <p><i>Dokumenti 3.32: Rregullore amendime për punësimet në UNISHK</i></p> <p><i>Dokumenti 11.XI. Rregullore e punësimit</i></p> <p><i>Dokumenti X.L. Rregullore e Administratës</i></p> <p><i>Dokumenti XXX.VII. Organika e universitetit</i></p> <p><i>Dokumenti XXX.VIII. Struktura akademike e universitetit</i></p> <p><i>Dokumenti 10..X. Manuali i Cilësisë</i></p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Për realizimin e objektivave e procesit mësimor e formues të studentëve, institucioni vendos marrëdhënie bashkëpunimi me institucionet homologe brenda dhe/ose jashtë vendit, aktorët e biznesit vendës dhe/ose të huaj.</p> <p><b>Kriteri 3.</b> Për realizimin e programit të studimit, institucioni nënshkruan marrëveshje të posaçme me institucione, institute kërkimore, kompani të fushës përkatëse për realizimin e praktikave profesionale, klinike, praktikave të punës apo stazhit etj.</p>	<p>Përvoja 30 vjeçare e Departamentit të Administrim Biznesit dhe e programit të studimit që akreditohet, ka krijuar në vite rrjetëzimin e duhur si brenda vendit e rajonit, ashtu dhe jashtë tij. Në RVB, në dokumentacionin e paraqitur në platformën e Ascal pasqyrohen marrëveshjet me institucione, organizata dhe kompani biznesi.</p> <p>Gjatë takimit me drejtuesit e njësisë kryesore/bazë, pedagogët dhe përfaqësuesit e Zyrës që mbulon Karrierën, evidentuam që bashkëpunimi ekziston, madje shumë nga aktivitetet si konkurset, Panairi i punës, vizitat në biznes, praktikat mësimore, etj mbështeten nga biznesi, ndërkohë që universiteti duhet të parashikojë buxhete në këtë drejtim, dhe për më tepër të delegojë në njësitë kryesore administrimin e këtyre buxheteve.</p> <p>Ndërsa duket që bashkëpunimi me biznesin është në rrugën e duhur në drejtim të diversifikimit të ofertës akademike dhe punësimit të studentëve, bashkëpunimi në projekte dhe kërkime të përbashkta mbetet ende larg, duke e bërë universitetin të qaset kryesisht në misionin tradicional të tij, e duke kërkuar shumë punë e vizion drejt misionit të trete.</p> <p><i>Dokumenti 1,22: Marrëveshje bashkëpunimi</i></p> <p><i>Dokumenti Marrëveshje ndër-institucionale bashkëpunimi</i></p> <p><i>Dokumentet Marrëveshje bashkëpunimi mes FE dhe disa institucioneve (gjenden në platformën e Ascal, të pa kodifikuar, por emërtohen "marrëveshje bashkëpunimi...")</i></p> <p><i>Dokumenti 1.51 1.5.1: Panairi I Punës</i></p> <p><i>Dokumenti 1.26: Përshkrimi i praktikës</i></p> <p><i>Dokumenti 1: RVB programi administrim biznes</i></p>

<p><b>Kriteri 4.</b> Në mënyrë periodike, njësia përgjegjëse për programin e studimit harton raporte analitike të përfitimeve nga marrëveshjet e bashkëpunimit në funksion të realizimit të programit të studimit.</p>	<p>Gjatë takimit me drejtuesit e njësisë kryesore dhe bazë, pedagogët dhe GVB, diskutuam për mënyrën si merret dhe analizohet feedback-u i bashkëpunimit. U dakordësua që tradita dhe përvoja e fituar, duhet dokumentuar dhe analizuar, jo thjesht në raportet dhe mbledhjet rutinë e shumë statike që formulohen çdo vit akademik.</p> <p><i>Në nivel universiteti kërkohet një qasje tjetër, shumë më proaktive drejt misionit të tretë të tij, e kjo më shumë se buxhete dhe organike kërkon vizion dhe lidërsip.</i></p> <p><i>UNISHK, FE dhe departamenti duhet të kthehen në një pikë të rëndësishme referimi për institucionet dhe bizneset lokale, të aplikojnë së bashku në projekte, brenda dhe jashtë Shqipërisë.</i></p> <p><i>UNISHK do të duhet që të përqaset ndryshe strategjikisht për t'u kthyer në qendrën e inovacionit të Veriut të Shqipërisë, por dhe një pol të rëndësishëm për Ballkanin Perëndimor.</i></p>			
<p><b>Konkluzione</b></p>	<p><i>GVJ vlerëson që UNISHK ka ngritur marrëdhënie bashkëpunimi me shumë institucione, por ato mbeten kryesisht të fokusuara në pasurimin e veprimtarive të mësimdhënies, praktikës, punësimit të studentëve. Kërkohet një përqasje dhe vizion shumë më proaktive në drejtim të projekteve të përbashkta.</i></p>			
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>		<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p> <p style="text-align: center;"><b>X</b></p>

<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës I</b></p>		<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p> <p style="text-align: center;"><b>X</b></p>
--	--	------------------------------	-----------------------------	--

## II. ORGANIZIMI, DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI I PROGRAMIT TË STUDIMIT TË CIKLIT TË PARË BACHELOR

<p><b>Standardi II.1</b></p> <p><b>Programi i studimit organizohet në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore kombëtare në fuqi.</b></p>	
<p><b>Kriteret</b></p>	<p><b>Vlerësimi i ekspertëve</b></p>
<p><b>Kriteri 1.</b> Programet e studimit janë të organizuara në lëndë e module.</p>	<p>Programi i Studimit Bachelor në Administrim Biznesi i ofruar nga Departamenti i Administrim Biznesit është i strukturuar në</p>



<p>Elementet që përbëjnë strukturën e programit të studimit, janë përcaktuar qartë në përputhje me legjislacionin vendas në fuqi dhe me Sistemin Evropian të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS).</p>	<p>3 vite studime, 6 semestra të rregullt me 180 ECTS, 60 kredite në vit, 30 kredite në çdo semestër.</p> <p>Ky program studimi u përshtat nga programi fillestar 4 vjeçar, në përputhje me Sistemin e Bolonjës. Programi dhe Plani mësimor i programit të studimit BA në AB ka të gjithë elementët në përputhje me Statutin dhe Rregulloren e UNISHK dhe udhëzimet e MAS në këtë drejtim.</p> <p>Elementet që përbëjnë strukturën e programit të studimit, janë përcaktuar qartë në përputhje me legjislacionin vendas në fuqi dhe me Sistemin Evropian të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS).</p> <p>Lëndët janë me 4, 5, 6, 7 dhe 8 ECTS, duke patur ndryshime në numrin e orëve mësimore, ndonëse <i>mbetej pak e paqartë nga ndryshonin midis tyre lëndët me 7 dhe ECTS, apo lëndët me 5 dhe 6 ECTS</i>. Programi i studimit është i ndërtuar sipas Rregullores së Programit. Programi është i detajuar sipas planit mësimor i cili zbërthen çdo modul në orë dhe kredite. Mbështetur në Tabelat Përmbledhëse të RVB, programi BA në AB është organizuar si më poshtë vijon:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- 3 vite akademike/6 semestra;</li> <li>- kredite për semester 30/ për vit akademik 60;</li> <li>- numri i moduleve 30, përfshirë praktikën dhe diplomën;</li> <li>- ngarkesa mësimore 4300 orë: 1515 orë në auditor; 2537 orë jashtë tij, 248 orë praktikë</li> <li>- ngarkesa mësimore javore 21-22 orë;</li> <li>- forma e mësimdhënies: Leksione / seminare / ushtrime / projekte / detyra kursi.</li> </ul> <p><i>Dokumenti 1.1. Statuti i UNISHK</i></p> <p><i>Dokumenti 1.17: Rregullore e programit të studimit BA në AB</i></p> <p><i>Dokumenti 1.18 dhe 1.15.5.: Plani Mësimor</i></p> <p><i>Dokumentet 1.16: Programi BA në AB sipas viteve</i></p> <p><i>Dokumenti Viti I, Viti II dhe Viti III: Silabuset sipas viteve dhe lëndëve</i></p> <p><i>Dokumenti 6.15: Tabelat përmbledhëse të RVB</i></p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Programi i studimit synon formimin e shprehive të veçanta në larmi të gjerë profesionale dhe specialitetesh, jep njohuri të</p>	<p>Ky program studimi ka formën dhe strukturën e një programi tradicional bachelor në administrim biznes. Lëndët që e përbëjnë programin mundësojnë dhënien e njohurive dhe aftësimin e studentëve në një spektër të gjerë fushash dhe</p>

<p>përparuara në një fushë studimi ose punësimi, ku përfshihet të kuptuarit kritik të teorive dhe parimeve akademike të fushës, zhvillon njohuri, aftësi dhe kompetenca të përparuara në një fushë akademike ose profesionale, të nevojshme për zgjidhjen e problemeve komplekse dhe të paparashikueshme në një fushë të specializuar studimi ose profesionale.</p>	<p>disiplinash të lidhura me botën e biznesit dhe funksionet që zhvillohen brenda tij. Programi është ndërtuar në përputhje me VKM 41/2018 përsa i përket përmbajtjes sipas kategorive: Lëndë bazë, Lëndë karakterizuese, Lëndë plotësuese. Lëndë ndërdisiplinore dhe Detyrime përmbyllesë.</p> <p><i>Ajo që evidentohet nga pikëpamja e përmbajtjes është një peshë pak më e madhe e lëndëve të natyrës financë dhe kontabilitet, gjithashtu evidentohet që disa lëndë që në një pjesë të shkollave të biznesit bëhen në master, këtu zhvillohen në BA. Vihet re që <u>mungojnë</u> disa lëndë si psikologjia, sjellja konsumatore, shkrimi akademik, metodat e kërkimit, sipërmarrja, media sociale dhe marketingu digjital. Gjithashtu ka dhe lëndë si Hyrja në Shkencat e Menaxhimit, Biznesi ndërkombëtar, Drejtimi financiar, Menaxhimi i Cilësisë të cilat mund të ishin më të përshtatshme për nivelin master.</i></p> <p><i>Programi në kohë ka pësuar ndryshime të vogla, të cilat mund të vijnë, ndërkohë që brenda silabuseve, literaturës, metodologjive ka hapësirë për përmirësime e ndryshime nga viti në vit.</i></p> <p><i>Dokumenti 1.17: Rregullore e programit të studimit BA në AB</i>  <i>Dokumenti 1.18 dhe 15.5.5.: Plani Mësimor</i>  <i>Dokumentet 1.16: Programi BA në AB sipas viteve</i>  <i>Dokumenti Viti 1, Viti 2 dhe Viti 3 me numrat përkatës (silabuset e lëndëve)</i></p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Programet e studimit kanë të përcaktuar qartë veprimtaritë formuese duke grupuar lëndët/modulet sipas kategoritë të përcaktuara dhe me ngarkesën përkatëse në kredite.</p>	<p>Mbështetur në VKM 41/2018 dhe në Rregulloren e Programit të studimit BA në AB, programi është organizuar si më poshtë:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Kategoria A – Lëndë Bazë – përgatitje metodologjike dhe kulturë e përgjithshme 32 ECTS ose 17.78%, <b>standardi (13-20%)</b></li> <li>- Kategoria B – Lëndë Karakterizuese – përgatitje për disiplinën shkencore, kategoria 96 ECTS ose 53.33%, <b>standardi (50-55%)</b></li> <li>- Kategoria C–Lëndë ndërdisiplinore/integruese– nëndisiplina, profile dhe grup-lënde me zgjedhje 25 ECTS ose 13.39%, <b>standardi (12-15%)</b></li> <li>- Kategoria D – Lëndë plotësuese–gjuhë të huaja, njohuri informatike, praktika profesionale, 21 ECTS ose 11.67%, <b>standardi (10-15%)</b></li> </ul>



	<p>- Kategoria E - Detyrimet përmbyllëse, 6 ECTS ose 3.33%, <i>standardi (3-5%)</i></p> <p>Studentët e programit Bachelor në Administrim Biznesi marrin 9 lëndë gjatë vitit të parë, një nga lëndët ka dy module, 8 lëndë në vitin e dytë, nga të cilat dy lëndë kanë dy module, dhe në vitin e tretë 8 lëndë, plus Praktikën Mësimore dhe Projektin e Diplomës.</p> <p><i>Dokumenti 1.17: Rregullore e programit të studimit BA në AB</i> <i>Dokumenti 1.22.2 dhe 1.16: Programi Mësimor sipas viteve</i></p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Programi i studimit ka të përcaktuara ngarkesën në kredite për realizimin e praktikës profesionale dhe të detyrimeve përmbyllëse.</p>	<p>Praktika profesionale është 10 ECTS në programin e studimit BA në AB. Gjatë vizitës në institucion, diskutuam për mënyrën si organizohet praktika. Departamenti cakton një grup pedagogësh për organizimin dhe ndjekjen e saj, si rregull shtrihet në dy semestra të vitit të tretë, përkatësisht nga 5 javë mësimore dhe zhvillohet pranë organizatave me të cilat FE ka marrëveshje. Në fund të saj, studentët përgatisin dosjen, të cilën e mbrojnë përpara një komisioni dhe vlerësohen me notë. Organizimi praktikës mbështetet në Rregulloren e Programit të Studimit dhe në silabus.</p> <p>Në lidhje me Detyrimet Përmbyllëse, ato organizohen në formën e një provimi përfundimtar dhe për studentët me mesatare mbi 8 punim diplome. Detyrimet përmbyllëse janë 6 ECTS pesha në kurrikul është 3.33%, standardi (3-5%) sipas VKM 41/2018</p> <p><i>Dokumenti 1.10: Marrëveshje me institucionet për praktikën</i> <i>Dokumenti 1.17: Rregullore e programit të studimit BA në AB</i> <i>Dokumenti 1.22.2 dhe 1.16: Programi Mësimor sipas viteve</i> <i>Dokumenti Viti III. 9: Praktika mësimore (silabusi)</i> <i>Dokumenti 1.19.1: Hapja e sezonit të Praktikës</i> <i>Dokumenti 2.9: Shembull praktika mësimore 2022</i> <i>Dokumenti 2.9.1: Raport mbi praktikën mësimore</i> <i>Dokumenti 2.14: Procedurë dhe dokumentat mbi praktikën mësimore</i> <i>Dokumenti Kërkesë për Realizimin e praktikës mësimore,</i> <i>Dokumenti Referencë për praktikën mësimore</i> <i>Dokumenti 3.2: Komisione provimi</i> <i>Dokumenti 3.24: udhëheqje diplome</i></p>

	<p><i>Dokumenti 3.8 dhe 3.8.1: Komisione diplome</i></p> <p><i>Dokumenti 3.2.1: ndarja e udhëheqjeve të diplomës</i></p>
<p><b>Kriteri 5.</b> Forma e organizimit të studimeve, pranimi i studentëve dhe financimi në institucionet e arsimit të lartë me status të veçantë realizohen në përputhje me ligjin e arsimit të lartë dhe specifikat përkatëse, të përcaktuara me udhëzim të ministrisë përgjegjëse për arsimin.</p>	<p>N/A</p>
<p><b>Kriteri 6.</b> Programet e studimit Bachelor, që ofrohen në të njëjtën fushë studimi, cikël si dhe me të njëjtën emërtesë, duhet të kenë përmbajtje të ngjashme në nivel, së paku 70 për qind.</p>	<p>Programi studimit BA në AB i ofruar nga Departamenti i AB në FE të UNISHK, ka ngjashmëri më programet e AB të ofruara nga universitetet shqiptare.</p> <p><i>Ajo që e karakterizon programin është mungesa e një numri lëndësh të domosdoshme për formimin e studentit në BA dhe disa lëndë të cilat po hyjnë si një domosdoshmëri në këto programe.</i></p> <p><i>Gjithashtu, disa lëndë janë tipike të programit master, theksuar dhe më lart, kështu që departamentit do t'i duhet të reflektojë dhe pas këtij procesi akreditimi të bëjë përshtatjet e duhura deri në 20% që ligji e lejon.</i></p>
<p><b>Kriteri 7.</b> Programi i studimit shoqërohet me kodin përkatës, sipas fushës së studimit dhe klasifikimeve të bëra publike nga ministria përgjegjëse për arsimin. Më tej kryhet kodifikimi i lëndëve të programit.</p>	<p>Bazuar në VKM Nr. 310, dt 11.05.2022 për specifikimet dhe kodifikimet e programeve të studimit të ofruara nga IAL-të, si dhe në udhëzimet e MAS, kodifikimi i fundit për këtë program studimi është bërë në Mars të vitit 2023, nga Drejtoria e Kurrikulave dhe Sigurimit të Cilësisë.</p> <p><i>Dokumenti 2.18: Kodifikimi i programit të studimit</i></p>
<p><b>Kriteri 8.</b> Programet e studimit mund të jenë edhe programe të përbashkëta midis dy ose më shumë institucioneve të arsimit të lartë, vendas dhe të huaj, në përputhje me legjislacionin në fuqi.</p>	<p>N/A</p>
<p><b>Konkluzione</b></p>	<p><i>GVJ vlerëson që organizimi i programit bëhet në përputhje me ligjin nga pikëpamja e formës. Nevojiten përmirësime në strukturën e lëndëve që e përbëjnë këtë program, të cilat janë</i></p>

*(KRA)*

*[Signature]*

	<i>pasojë dhe e përshtatjes së tij nga sistemi 4 vjeçar në atë 3 vjeçar, gjithashtu dhe rishikimi i planit mësimor për të plotësuar 4500 orët dhe raportin e orëve në auditor dhe jashtë tij.</i>		
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
		X	

## Standardi II.2

**Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush kërkesat ligjore dhe standardet e cilësisë për këto njësi.**

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p><b>Kriteri 1.</b> Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush detyrimet e përcaktuara në legjislacionin në fuqi për organizimin dhe strukturën akademike, stafet akademike vlerësimin dhe akreditimin.</p> <p><b>Kriteri 2.</b> Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush detyrimet e përcaktuara në legjislacionin në fuqi, duke angazhuar personel ndihmës akademik /administrativ për realizimin e praktikave mësimore, laboratorike e klinike, etj.</p>	<p>UNISHK ka kaluar akreditimin e parë institucional me Vendim të Bordit të Akreditimit Nr. 70, datë 21.09.2017, riakreditimin institucional me Vendim BA Nr. 3, datë 24.01.2020, me kohëzgjatje 4 vite akademike, afati vlefshmërisë deri më 23.01.2024.</p> <p>Njësitë kryesore të UNISHK dhe në veçanti FE përmbushin detyrimet ligjore në lidhje me numrin e njësive bazë (gjithsej 3 Departamente), dhe numrin e pedagogëve dhe gradat/titujt në përputhje me nenin 23 të ligjit nr. 80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”. FE ka në përbërje njësitë bazë:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Departamentin e Administrim Biznesit;</li> <li>- Departamentin e Financës;</li> <li>- Departamentin e Turizmit;</li> </ul> <p>Stafi akademik sipas departamenteve për vitin akademik 2020-2021 është si më poshtë vijon:</p> <p><b><u>Departamenti i Administrim Biznesit:</u></b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- 10 PAE, ndër të cilët 8 me tituj / grada;</li> <li>- 19 PAK, ndër të cilët, 3 me tituj / grada;</li> </ul> <p><b><u>Departamenti i Financës:</u></b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- 12 PAE, ndër të cilët 11 me tituj / grada;</li> <li>- 13 PAK, ndër të cilët 4 me tituj / grada;</li> </ul> <p><b><u>Departamenti i Turizmit:</u></b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- 9 PAE, ndër të cilët 7 me tituj / grada;</li> <li>- 8 PAK, ndër të cilët 0 me tituj / grada;</li> </ul>

Gjithashtu, në mbështetje të veprimtarisë së departamentit janë dy laborantë dhe sekretari mësimore me dy sekretare.

GVJ konstaton se Departamenti i Administrim Biznesit, në vitin aktual 2022-2023, ka 23 personel akademik gjithsej, 10 pedagogë me kohë të plotë dhe 13 pedagogë me kohë të pjesshme dhe dy laborantë, në total 25.

Njësia bazë, Departamenti i Administrim Biznesit përgjegjës për programin e studimit, përmbush detyrimet për numrin dhe shkallën e kualifikimit të personelit akademik, sipas viteve akademike që paraqiten si më poshtë për vitet akademike:

Tituj/ grada	2023-2022		2022-2021		2021-2020	
	PAE	PAK	PAE	PAK	PAE	PAK
Prof.Dr.						
Prof. Asoc.	2	4	2		2	
Dr./PhD.	8	9	8	4	8	5
Msc.				13		11
<b>Totali</b>	<b>10</b>	<b>13</b>	<b>10</b>	<b>17</b>	<b>10</b>	<b>16</b>

Struktura, detyrat dhe përgjegjësitë e njësive kryesore dhe asaj bazë që është përgjegjëse për programin e studimit, janë të përcaktuara në statutin e institucionit dhe janë në përputhje me Ligjin 80/2015 të Arsimit të Lartë. Dekani i Fakultetit mban titullin akademik “Profesor i Asociuar” ndërsa Përgjegjësi i Departamentit gradën akademik “Doktor”.

Për sa më sipër Njësia kryesore (FE) dhe njësia bazë përgjegjëse për programin, përmbushin detyrimet ligjore dhe nënligjore për:

- numrin dhe shkallën e kualifikimit të personelit akademik;
- organizimin dhe strukturën akademike;

Sugjerohet organizimin sipas grup-lëndëve në përputhje me ligjin dhe rregulloren e fakultetit.

*Dokumenti 1.23: Struktura organizative e FE*

*Dokumenti XXXVII: Struktura organizative e UNISHK*

*Dokumenti XXXVIII: Organika e UNISHK*

*Dokumenti 6.15: Tabelat përmbledhëse të RVB*



	<i>Dokumenti 6.11: PAE/PAK për FE</i>		
<b>Kriteri 3.</b> Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin për çdo program studimi cakton një person në rolin e koordinatorit të programit të studimit, i cili është përgjegjës për ecurinë dhe zhvillimin e programit dhe praktikave profesionale në përputhje me objektivat e tij.	<p>Bazuar në Ligjin 80/2015 për Arsimin e Lartë në Republikën e Shqipërisë, Rregullorja e UNISHK, Rregullorja e departamentit dhe Rregullorja e Programit duhet të parashikonin koordinatorin e programit që mund të jetë përgjegjësi i departamentit ose një anëtar i tij, të paktën me gradën "Doktor".</p> <p>Ndërkohë, përmes dy vendimeve janë caktuar koordinatorët e programeve, <u>Sugjerime</u> që të përfshihen në rregulloret e njësive kryesore/bazë, të programit detyrat dhe përgjegjësitë e koordinatorit të programit për të garantuar mbarëvajtjen e procesit mësimor, për të koordinuar aktivitetet për raportin vjetor të analizës së programit, rishikimin e programit, dhe sigurisht për të kontribuar në proceset e rekrutimit të studentëve në këtë program.</p> <p><i>Dokumenti 2. II: Rregullore e studimit në UNISHK</i></p> <p><i>Dokumenti 1.a: Rregullore e Fakultetit</i></p> <p><i>Dokumenti 1.17: Rregullore e departamentit të AB</i></p> <p><i>Dokumenti 1.17: Rregullore e programit të studimit BA në AB</i></p> <p><i>Dokumenti 2.7 dhe 2.7.1: Vendime të departamentit për koordinatorin e programit</i></p>		
<b>Konkluzione</b>	GVJ vlerëson që njësia kryesore- FE dhe njësia bazë – Departamenti i Administrim Biznesit, përmbushin kërkesat ligjore në lidhje me nr depart-amenteve dhe stafin akademik në to. Sugjerohet formimi grup- lëndëve		
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
			X

<b>Standardi II.3</b>	
<b>Programi i studimit është i detajuar, informues, i strukturuar dhe organizuar në përputhje me parashikimet dhe objektivat formuese të programit të ciklit të parë.</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Njësia kryesore/bazë, përgjegjëse për programet e studimit të ciklit të parë, disponojnë informacionet e nevojshme për organizimin, strukturën	Programi BA në AB e ka filluesën e tij në vitin 1992, mbështetur në përvojën e Universitetit të Illinoisit të Jugut dhe Universitetit të Nebraskës. Zvdekonia e Fakultetit gjatë vizitës në institucion u shpreh që janë përpjekur të ruajnë përmbajtjen e programit të studimit dhe të kenë konsistencë në sistem.

<p>dhe përmbajtjen e programeve të studimeve.</p>	<p>Sot dinamikat e punësimit të studentëve janë të tilla që ata synojnë formim dhe aftësim në nivel lokal dhe global dhe përmbajtja e programit duhet të përshtatet me trendet e reja sociale dhe ekonomike. Bazuar në dosjen e plotë të programit të studimit, në përmbajtjen e silabuseve, në mënyrën e konceptimit të orës së mësimi, kontrollit të njohurive, të fuqiarit në leksion, evidentohet që pedagogët përpiqen pikërisht të bashkojnë nevojat lokale me ato globale, por mbetet ende për t'u bërë në drejtim të teksteve, metodave të mësimdhënies dhe mbi të gjitha formalizimit në silabus të tyre, etj.</p> <p>Në përvojën e FE, siç stafi akademik dhe drejtuesit e fakultetit u shprehën gjatë vizitës, ka kontakte dhe eksperiencë me një sërë organizatash të rëndësishme në vend si dhe me institucione e bizneseve lokale që zhvillojnë aktivitet në Shkodër dhe në Veri të Shqipërisë, por nevojitet të kenë dhe suport me buxhete për një sërë aktivitete, siç janë psh vizitat në biznese apo aktivitete në fakultet.</p> <p>Në faqen zyrtare në internet të UNISHK, studentët e FE njihen mbi dokumentat kryesore, planet dhe programet mësimore dhe shumë informacione të tjera në funksion të rregjistrimeve dhe kalendarit akademik</p> <p><a href="https://unishk.edu.al/universiteti/fakultetet/fakulteti-ekonomik">https://unishk.edu.al/universiteti/fakultetet/fakulteti-ekonomik</a></p> <p><i>Dokumenti 1.15: Plani mësimor sipas viteve</i>  <i>Dokumenti Viti 1, Viti 2 dhe Viti 3 me numrat përkatës (silabuset e lëndëve)</i>  <i>Dokumenti 1.16: Programi mësimor në AB sipas viteve</i>  <i>Dokumenti 1.10: Marrëveshje me institucionet për praktikën</i>  <i>Dokumenti 1,22: Marrëveshje bashkëpunimi</i>  <i>Dokumenti Marrëveshje ndër-institucionale bashkëpunimi</i>  <i>Dokumentet Marrëveshje bashkëpunimi mes FE dhe disa institucioneve (gjenden në platformën e Ascal, të pa kodifikuar, por emërtohen "marrëveshje bashkëpunimi...")</i></p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Programi i studimit përmban planin mësimor, ku përfshihet informacioni i nevojshëm për ndarjen e lëndëve në semestra, ngarkesën mësimore të lëndëve/moduleve, orët në auditor/jashtë auditorit.</p>	<p>Mbështetur në VKM 41/2018 dhe në Rregulloren e Programit të studimit BA në AB, programi është organizuar si më poshtë:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Kategoria A – Lëndë Bazë – përgatitje metodologjike dhe kulturë e përgjithshme 32 ECTS ose 17.78%, <b>standardi (13-20%)</b></li> <li>- Kategoria B – Lëndë Karakterizuese – përgatitje për disiplinën shkencore, kategoria 96 ECTS ose 53.33%, <b>standardi (50-55%)</b></li> </ul>



<p><b>Kriteri 4.</b> Programi i studimit përmban informacionet e nevojshme për programet lëndore (syllabuset) për secilën lëndë për praktikat, seminarët apo orët e laboratorit, si dhe të gjithë komponentët formues të programit brenda dhe jashtë auditorit në përputhje me formatet e miratuara.</p>	<ul style="list-style-type: none"> <li>- Kategoria C–Lëndë ndërdisiplinore/integruese– nëndisiplina, profile dhe grup-lëndë me zgjedhje 25 ECTS ose 13.39%, <b>standardi (12-15%)</b></li> <li>- Kategoria D – Lëndë plotësuese–gjuhë të huaja, njohuri informatike, praktika profesionale, 21 ECTS ose 11.67%, <b>standardi (10-15%)</b></li> <li>- Kategoria E - Detyrimet përmbyllëse, 6 ECTS ose 3.33%, <b>standardi (3-5%)</b></li> </ul> <p>Mbështetur në Tabelat Përmbledhëse të RVB dhe në Planin e Programin mësimor sipas viteve, programi studimit BA në AB është organizuar:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- 3 vite akademike/6 semestra;</li> <li>- kredite për semester 30/ për vit akademik 60;</li> <li>- numri i moduleve 30, 10 module në vitin e parë dhe të dytë, 8 në vitin e tretë dhe praktikën plus diplomën;</li> <li>- <b>ngarkesa mësimore 4300 orë: 1515 orë në auditor; 2537 orë jashtë tij, 248 orë praktikë</b></li> <li>- ngarkesa mësimore javore 21-22 orë;</li> <li>- forma e mësimdhënies: Leksione / seminare / ushtrime / projekte / detyra kursi.</li> </ul> <p>Silabuset e lëndëve, përcaktojnë mënyrën e vlerësimit ku përgjithësisht është zgjedhur një sistemi vlerësimi që i jep provimit përfundimtar shumë peshë (mbi 70%) dhe që kufizon vlerësimin e vazhduar gjatë gjithë semestrit.</p> <p>Në silabus, qartësohet dhe frekuentimi/ndjekja e seminareve, që është e detyrueshme në masën 75%. Praktika mësimore, zhvillohet në përputhje me silabusin dhe dhe udhëzuesit mbi praktikat mësimore, që përmban dokumentacionin e nevojshëm për vlerësimin e praktikave mësimore.</p> <p><i>Rekomandimi kryesor në drejtim të vlerësimit të studentëve është ndryshimi i raporteve në vlerësim gjatë gjithë semestrit me vlerësimin në provimin përfundimtar. Të reflektohet në silabus hapësira që rregullorja e programit dhe e departamentit lejon në mënyra e vlerësimit, duke i dhënë peshë provimit të ndërmjetem, detyrës apo projektit dhe duke ulur peshën e provimit përfundimtar.</i></p> <p><i>Dokumenti 1.17: Rregullore e programit të studimit BA në AB</i></p>
--	--

	<p><i>Dokumenti 1.18 dhe 1.15.5.: Plani Mësimor</i></p> <p><i>Dokumentet 1.16: Programi BA në AB sipas viteve</i></p> <p><i>Dokumenti Viti I, Viti II dhe Viti III: Silabuset sipas viteve dhe lëndëve</i></p> <p><i>Dokumenti 6.15: Tabelat përmbledhëse të RVB</i></p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Programi i studimit përmban të gjitha informacionet e nevojshme për studentët që lidhen me kriteret e përgjithshme dhe specifike të pranimit, transferimit dhe ekuivalentimit të studimeve.</p>	<p>Kriteret e pranimit të studentëve në Programin BA në AB janë kriteret ligjore të përcaktuara nga MAS dhe udhëzimet që dalin për rregjistrimet në universitete çdo vit akademik.</p> <p>Në Rregulloren e UNISHK dhe të programit të studimit, qartësohen kushtet dhe procedurat e pranimit, transferimit dhe ekuivalentimit. Përgjithësisht universiteti dhe FE nuk përcaktojnë kriteret shtesë përpos kriterëve ligjore. Në dosjen e plotë të dokumentave në platformën e Ascal gjenden dhe shembuj të ekuivalentimit të studimeve.</p> <p><i>Dokumenti 1.17: Rregullore e programit të studimit BA në AB</i></p> <p><i>Dokumenti 2. II: Rregullore e studimit në UNISHK</i></p> <p><i>Dokumenti 2. 15 dhe 2.6: Shembuj ekuivalendimesh</i></p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Programi i studimit përmban informacionet e nevojshme për programet lëndore (syllabuset) për secilën lëndë për praktikën, seminarin apo orët e laboratorit, si dhe të gjithë komponentët formues të programit brenda dhe jashtë auditorit në përputhje me formatet e miratuara.</p>	<p>Gjatë vizitës në institucion dhe takimit me drejtueset, GVB, stafin akademik dhe Zyrën e Kurrikulave dhe Cilësisë, diskutimi kryesor u përqëndrua në formatin dhe përmbajtjen e silabuseve. Fakti që Senati ka miratuar një format silabusi, nuk justifikon formatin krejt shkurt të silabusit dhe jo në përputhje me VKM 41/2018.</p> <p>Silabuset aktuale përmbajnë një pjesë të informacioneve sipas strukturës ligjore, <u>por mungon detajimi i temave, metodologjive për çdo temë dhe seminar përkatës, faqet e literaturës, linqet, të ftuarit në auditor dhe forma të tjera të mësimdhënies.</u></p> <p><u>Përpos formës dhe përmbajtjes, literature duket të jetë në shumicën e rasteve e vjetër,</u> psh Lënda Komunikimi në biznes ka si literaturë bazë një libër të vitit 2012, ndërkohë që komunikimi në 5 vitet e fundit ka ndryshuar totalisht, lënda e Menaxhimit mund të përdorë librin e botuar nga AADF në 2021, i cili ishte dhe në bibliotekën e universitetit, e kështu me rradhë për lëndët Marketing, Biznesi i vogël, etj.</p> <p><u>Përshtatja e silabuseve në formatin ligjor të VKM41/2018 dhe rishikimi i literaturës është detyrë e parë e departamentit dhe Zyrës së Kurrikulave dhe Cilësisë si dhe hartimi i silabuseve në gjuhën angleze.</u></p>

	<i>Dokumenti Viti I, Viti II dhe Viti III: Silabuset sipas viteve dhe lëndëve</i>			
<b>Kriteri 5.</b> Përmbajtja e programit të studimit është në përmirësim dhe përditësim të vazhdueshëm dhe në fillim të çdo viti akademik miratohen ndryshimet eventuale dhe arkivohet dosja e plotë.	Gjatë vizitës në institucion, diskutuam që përtej ndryshimeve të vogla që programi pëson vit pas viti, nevojitet që Departamenti i Administrimit Biznesit, të bëjë një vlerësim nisur nga disa burime informacioni: - programeve të universiteteve perëndimore dhe ballkanike (jo të kryeqyteteve dhe qendrave metropolitane të mëdha) - nevojat e tregut të punës lokal dhe kombëtar - tryezave të rrumbullakta me alumni, ekspertë dhe kolegë - focus grupeve me studentë të BA dhe MA			
<b>Konkluzione</b>	<i>GVJ vlerëson dhe rekomandon rregullimin në numrin total të orëve të programit, përshtatjen e programit me nevojat e tregut, rishikimi i tërësisë së lëndëve që ofrohen, futja e disa lëndëve të reja që lidhen me zhvillimet e fundit teknologjike, zvogëlimi i peshës së lëndëve të financë –kontabilitetit, kalimi i disa lëndëve në MA dhe anasjelltas, formulimi i silabuseve në përputhje me VKM 41/2018 dhe në gjuhën angleze si dhe një mënyrë vlerësimi kah vlerësimin të vazhduar (pra më pak peshë provimit final), përditësimi i literaturës.</i>			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>	
		X		

#### Standardi II.4

**Struktura, organizimi dhe përmbajtja e programeve të studimit është në përputhje me objektivat formuese, nivelin e kualifikimit sipas Kuadrit Kombëtar dhe Evropian të Kualifikimeve, rezultateve të të nxënies dhe vazhdimin të studimeve, kompetencave në përputhje me kërkesat e tregut të punës.**

<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Emërtimi, përmbajtja e veprimtarive, shpërndarja e lëndëve dhe praktikave, mundësojnë, thellim të njohurive dhe aftësive për studime të mëtejshme dhe/ose punësimin e studentëve.	Programi BA në AB, bazuar në rregulloren dhe dosjen e plotë të tij, është organizuar si më poshtë vijon: - 3 vite akademike/6 semestra; - kredite për semester 30/ për vit akademik 60; - numri i moduleve 30, 10 module në vitin e parë dhe të dytë, 8 në vitin e tretë dhe praktika plus diplomën; - ngarkesa mësimore 4300 orë: 1515 orë në auditor; 2537 orë jashtë tij, 248 orë praktikë

**Kriteri 2.** Lëndët/modulet, shpërndarja në vite e semestra, vlerësimi në kredite e orë mësimore mundëson arritjen e objektivave formues të programit të studimit dhe rezultateve të pritshme të të nxënit.

**Kriteri 3.** Struktura e programit, lëndët, raporti teori praktikë është në përputhje me profilin e programit të studimit dhe e përafërt me programe të ngjashme ndërkombëtare.

**Kriteri 4.** Ndarja sipas veprimtarive formuese dhe raportet midis formimit teorik dhe praktik mundësojnë arritjen e objektivave formues, transferim të studimeve, mobilitet dhe punësim në përfundim të studimeve.

- forma e mësimdhënies: Leksione / seminare / ushtrime / projekte / detyra kursi.

- praktika mësimore ndahet në dy semestra, përkatësisht nga 5 javë.

- semestri 15 javë mësimore

Lëndët janë me 8, 7, 6, 5 dhe 4 ECTS dhe të organizuara në funksion të llojit të lëndës dhe lirisë akademike. Kështu gjejmë *lëndë me 8 ECTS dhe me 7 ECTS* me strukturën: 75 orë në auditor, nga të cilat: 45 orë leksione dhe 30 orë seminare. *Lëndët me 6 ECTS* kryesisht kanë strukturën: 60 orë në auditor nga të cilat: 30 orë leksione; 30 orë seminare, bën përjashtim një lëndë e cila ka 30 orë leksione dhe 45 orë seminare dhe një lëndë me 15 orë leksion dhe 45 orë seminare.

Lëndët me 5 ECTS kanë strukturën: 60 orë në auditor nga të cilat: 30 orë leksione; 30 seminare. *Lëndët me 4 ECTS* kanë strukturën: 40 orë në auditor nga të cilat: 30 orë leksione; 10 orë ushtrime/ seminare dhe 60 orë jashtë auditorit;

6 kreditet e provimit përfundimtar/diplomës janë 150 orë punë e pavarur. 10 ECTS e praktikës nënkuptojnë 248 orë praktikë profesionale pranë një organizatë dhe 2 orë punë të pavarur për të përgatitur prezantimin.

Mbështetur në VKM 41/2018, programi BA në AB është strukturuar në:

- Lëndë të formimit të përgjithshëm - 5 lëndë (32 ECTS ose 17.78%) standardi (13-20%)

- Lëndë Karakterizuese – 13 lëndë ( 96 ECTS ose 53.33%), standardi (50-55%)

- Lëndë ndërdisiplinore/integruese– 5 lëndë (25 ECTS ose 13.39%), standardi (12-15%)

- Lëndë plotësuese– 3 lëndë (21 ECTS ose 11.67%), standardi (10-15%)

- Detyrimet përmbyllëse, - Provimi përfundimtar/punimi diplomës (6 ECTS ose 3.33%), standardi (3-5%)

Programi BA në AB siç kemi theksuar dhe më lart në këtë raport, mbështetet në përvojën e hershme të Departamentit të AB që nis me programin 4 vjeçar në UNISHK nga viti 1992 në mbështetjen nga universitetet amerikane dhe vijon më tej me të gjithë eksperiencën e fituar në vite dhe me përshtatjen më pas me sistemin e Bolonjës.

	<p>Mbështetur në Rregulloren e Programit BA në AB, silabuset e lëndëve, mund të themi që lëndët dhe përmbajtja e tyre, shërbejnë për të krijuar njohurinë dhe aftësuar studentëve në fushat bazë të biznesit, u krijon mundësi që të përsosin të menduarin kritik dhe instrumenta të analizës, duke u përqsur si në funksion të nevojave që tregu lokal apo ndërkombëtar të punës. Ky program krijon një bazë të domosdoshme për studime të tjera e thelime në fusha më specifike të biznesit.</p> <p><i>Dokumenti 1.17: Rregullore e programit të studimit BA në AB</i>  <i>Dokumenti 1.18 dhe 1.15.5.: Plani Mësimor</i>  <i>Dokumentet 1.16: Programi BA në AB sipas viteve</i>  <i>Dokumenti Viti I, Viti II dhe Viti III: Silabuset sipas viteve dhe lëndëve</i>  <i>Dokumenti 6.15: Tabelat përmbledhëse të RVB</i></p>
<p><b>Kriteri 5.</b> Syllabuset (programet e lëndëve /moduleve) përditësohen në mënyrë të vazhdueshme për marrjen e kompetencave në përputhje me kërkesat e tregut të punës, duke përfshirë literaturën bazë dhe ndihmëse të viteve të fundit.</p>	<p>Në vijimësi të këtij raporti të ekspertëve të jashtëm, në lidhje me syllabuset mbetemi konstant të qëndrimit që formati i silabusit duhet përshtatur me VKM 41/2018. Format i përcaktuar me vendim të Senatit të UNISHK e respekton vetëm pjesërisht formatin ligjor, kështu që në mënyrë të përsëritur <u>GVJ rekomandon që:</u></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- të shtjellohen temat,</li> <li>- të përcaktohet metodologjia e përdorur në çdo seminar,</li> <li>- të vendoset literature bazë dhe e rekomanduar në çdo temë, të vendosen faqet apo linqet e literaturës, rasteve studimore, videove etj;</li> <li>- të paraqiten të ftuarit në auditor, vizitat në biznese, e forma të tjera të mësimdhënies e nxënies;</li> <li>- të ndryshojë mënyra e vlerësimit duke i dhënë peshë vlerësimit gjatë gjithë semestrit e duke ulur peshën e provimit përfundimtar.</li> <li>- të përditësohet literatura me literaturë të 5 viteve të fundit</li> <li>- të formulohen dhe në anglisht silabuset (ndoshta në variantin që janë aktualisht)</li> </ul> <p><i>Dokumenti Viti I, Viti II dhe Viti III: Silabuset sipas viteve dhe lëndëve</i></p>
<p><b>Kriteri 6.</b> Përmbajtja e programit të studimit</p>	<p>Qëllimi dhe objektivat e këtij programi studimi janë në përputhje të plotë me qëllimin që Ligji i Arsimit të Lartë i</p>



<p>garanton përfitim të dijeve, aftësi dhe kompetencave të synuara.</p> <p><b>Kriteri 7.</b> Përmbajtja e programit të studimit mundëson vijimin e mëtejshëm të studimeve dhe/ose punësimin e studentëve në përshtatje me pritshmëritë e kërkesat e tregut e punës.</p>	<p>atribuon programeve bachelor. Struktura dhe përmbajtja e programit, përmbajtja e silabuseve, raporti teori-praktikë synon të garantojë formimin të mirë të studentëve nga pikëpamja njohurive dhe aftësimi praktik, për t'ju përgjigjur dinamikave të tregut lokal dhe global. Element i rëndësishëm është fokusimi i studentëve në raporte ndërveprimi me tregun e punës përmes orëve të hapura, Panairit të Punës, vizitave në biznese dhe konkurseve të mbështetura nga biznesi.</p> <p>Mënyra si konceptohet dhe zhvillohet praktika mësimore, krijon hapësira për aftësimin, por dhe oportunitet për t'u punësuar. UNISHK dhe departamenti AB duhet të jenë shumë më proaktive në raportet me bizneset, në projektet e përbashkta dhe në përfshirjen e studentëve.</p> <p><i>Dokumenti 1.17: Rregullore e programit të studimit BA në AB</i>  <i>Dokumenti Viti I, Viti II dhe Viti III: Silabuset sipas viteve dhe lëndëve</i>  <i>Dokumenti 6.15: Tabelat përmbledhëse të RVB</i>  <i>Dokumenti 2.22: Student i punësuar pas praktikës</i>  <i>Dokumenti Viti III.9: Silabus i Praktikës</i>  <i>Dokumenti 1,22: Marrëveshje bashkëpunimi</i>  <i>Dokumenti Marrëveshje ndërinstitutionale bashkëpunimi</i>  <i>Dokumentet Marrëveshje bashkëpunimi mes FE dhe disa institucioneve (gjenden në platformën e Ascal, të pa kodifikuar, por emërtohen "marrëveshje bashkëpunimi...")</i>  <i>Dokumenti 1.51 1.5.1: Panairi i Punës</i></p>								
<p><b>Konkluzione</b></p>	<p><i>GVJ vlerëson që struktura dhe organizimi është në përputhje me objektivat, përmbajtja është dhe duhet të jetë në një proces përmirësim dhe përditësimi në përputhje me zhvillimet në tregun e punës dhe qasjet e reja të shoqërisë. Mendojmë e sugjerojmë më shumë dinamikë në program dhe departament.</i></p>								
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>	<table border="1"> <thead> <tr> <th></th> <th>Përmbushet pjesërisht</th> <th>Përmbushet kryesisht</th> <th>Përmbushet plotësisht</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td></td> <td></td> <td></td> <td>X</td> </tr> </tbody> </table>		Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht				X
	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht						
			X						

**Standardi II.5**

**Institucioni i arsimit të lartë nxit përfshirjen e studentëve dhe partnerëve, rrjeteve dhe organizmave të tjera në hartimin dhe përmirësimin e vazhdueshëm të programit të studimit dhe realizimin me sukses në përputhje me objektivat e tyre.**



Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p><b>Kriteri 1.</b> Për përmirësimin e përmbajtjes së programit të studimit dhe për përshtatjen sa më mirë me kërkesat e tregut të punës, gjatë hartimit dhe ecurisë së programit të studimit, njësitë përgjegjëse konsultohen dhe marrin parasysh propozimet e institucioneve partnere, të diplomuarve, dhe aktorëve të tjerë nga tregu i punës.</p> <p><b>Kriteri 3.</b> Njësia përgjegjëse përmirëson, përditëson, përshtat programin e studimit në përputhje me propozimet dhe zhvillimet e fundit në fusha të ndryshme në bashkëpunim me rrjete profesionistësh, shoqata, urdhra profesionale (veçanërisht në fushën e mjekësisë) dhe institucione publike e private.</p>	<p>Tregu i punës është në disa dinamika lokale dhe globale, të cilat kanë kapërcyer të gjitha projeksionet e ekspertëve të hartimit të programeve. Ekzistojnë praktika të mira të bashkëpunimit FEUNISHK- industri, por ato kanë nevojë të formalizohen dhe të bëhen më të qëndrueshme, madje dhe në nivel departamenti.</p> <p>FE vijon të ketë studentë, ndonëse shumë programe studimi në universitet e më gjerë, kanë filluar turrjen dhe ky avantazh do të duhet të shoqërohet me shumë dinamikë</p> <p>Pozitive janë raportet e pedagogëve me organizatat/bizneset, bashkëpunimi ndodh, thjeshtë në një pjesë të rasteve duhet formalizuar, ndërkohë <i>universiteti duhet të decentralizojë buxhetin dhe ta drejtojë për intensifikimin e këtyre bashkëpunimeve.</i></p> <p>Panairi i Punës, Konferencat dhe disa konkurse studentore, vizitat në biznes, praktikat mësimore, leksionet me të ftuar nga biznesi/institucionet përbëjnë një mundësi për ndërveprim, feedback dhe propozime konkrete. Pozitiv është fakti që një pjesë e pedagogëve të jashtëm vinin nga eksperiencia biznesi, drejtimi institucioneve dhe organizatash me peshë në qark, të cilët luajnë një rol të rëndësishëm në ndërveprimin universitet – biznes os departament- biznes.</p> <p><i>Dokumenti 1,22: Marrëveshje bashkëpunimi</i></p> <p><i>Dokumenti Marrëveshje ndërinstytucionale bashkëpunimi</i></p> <p><i>Dokumentet Marrëveshje bashkëpunimi mes FE dhe disa institucioneve (gjenden në platformën e Ascal, të pa kodifikuar, por emërtohen "marrëveshje bashkëpunimi...")</i></p> <p><i>Dokumenti 1.51 1.5.1: Panairi i Punës</i></p> <p><i>Dokumenti 3.10: Relacion mbi leksionet e hapura</i></p> <p><i>Dokumenti 3.10.1: Leksion i hapur</i></p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Institucioni nxit dhe përfshin në diskutime studentët dhe strukturat e tyre, mban kontakte dhe konsultohet vazhdimisht me studentët e diplomuar, për përmirësimin e programit të studimit, dhe reflektimin kur ato janë në ndihmë të përmirësimit të programit të studimit.</p>	<p>Përfshirja e studentëve në diskutimet e përmirësimit të programit bëhet përmes rrugëve formale dhe joformale. Drejtuesja e departamentit, pedagogët u shprehën gjatë takimeve në institucion që në mënyrë periodike takohet dhe diskuton me studentët për procesin mësimor, problematikat e ndeshura, përmbajtjen e lëndëve etj. Gjithashtu, në nivel institucioni, bazuar në Manualin e Sigurimit të Cilësisë bëhen pyetësorë për vlerësimin e programit dhe të mësimdhënies, rezultatet e të cilave shërbejnë për të diskutuar e marrë vendime të mëtejshme.</p>

	<p><i>Dokumenti 10.X. Manuali i Cilësisë</i></p> <p><i>Dokumenti 1.17: Rregullore e programit të studimit BA në AB</i></p> <p><i>Dokumenti 2.13: Raport përmbledhës I NJSBC</i></p> <p><i>Dokumenti 3.22.1; 3.22.3 dhe 4.3: Rezultatet e pyëtësorit për programin AB sipas viteve</i></p> <p><i>Dokumenti 2.12. Vlerësimi programit</i></p>			
<b>Konkluzione</b>	<p><i>GVJ vlerëson se në mënyrë formale dhe joformale, studentët bëhen pjesë e procesit të përmirësimit të vazhdueshëm. Gjithashtu, vlen të theksohet dhe mënyra se si bashkëpunojnë me institucione, biznese dhe organizata të tjera dhe si ndikonin veprimtaritë e tyre.</i></p>			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>		<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				<b>X</b>

<b>Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës II</b>		<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
			<b>X</b>	

### III.MËSIMDHËNIA, MËSIMNXËNIA, VLERËSIMI DHE KOMPETENCAT

<b>Standardi III.1</b>	
<b>Institucioni i arsimit të lartë garanton procesin e të nxënit, aftësimin profesional e shkencor me metodat dhe praktikat më të mira me në qendër studentin, që sigurojnë arritjen e rezultateve.</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Format e mësimdhënies, mësimnxënies dhe transmetimit të dijeve e njohurive janë leksionet, seminarët, punët laboratorike, detyrat e kursit/estetë, projektet, praktikat profesionale e klinike, orët e hapura dhe çdo formë tjetër e miratuar nga institucioni.	Si pjesë e Departmentit të Administrim Biznesi programi përpiqet të harmonizojë metodat bashkohore të mësimdhënies, mësimnxënies dhe transmetimit të njohurive. Kjo vihet re edhe në theksin që i vihet me dokumentat përkatës të UNISHK, si <i>Strategjia e Mësimdhënies 2017</i> dhe si <i>Strategjia e Mësimdhënies 2012</i> si dhe <i>Strategjia e Zhvillimit të Universitetit të Shkodrës 2022</i> . Kështu leksionet gërshetohen me diskutim aktiv, punë në projekte si individuale ashtu edhe në grupe por edhe zhvillimin dhe nxitjen e mendimit kritik për të nxjerrë në pah përmbushjen e objektivave mësimore nga ana e studentëve. Megjithëse, mënyra e kontrollit të dijeve e pasqyruar në syllabuset e lëndëve nuk e mbështet këtë lloj evidence, <u>GVJ eidenton mungesë të dokumentimit nga ana e</u>





	<p>stafit të të gjithë aktiviteteve formuese të studentëve në funksion të arritjes së objektivave të programit të studimit. Gjithashtu nga takimi me pedagogët e angazhuar në këtë program studimi u nënvizua përfshirja e studentëve në aktivitete me biznesin si dhe organizimi i praktikave në biznes për tema të veçanta që lidhen me biznesin.</p> <p>Studentët e regjistruar në këtë program studimi, u shprehën se ishin përfshirë në organizime të përvitshme të konkursit të ideve inovatore si dhe prezantimin e idesë në institucione private por edhe publike (si shembull Bashkia e Shkodrës). Ata u shprehen se kishin marrë pjesë në organizime të ndryshme me Universitete të tjera si Universiteti Epoka, në konferenca shkencore me punimet më të mira të diplomës si dhe Erasmus.</p> <p><i>Dokumenti 4-IV. STRATEGJIA E MËSIMDHENIES 2017</i>  <i>Dokumenti 4-IV. STRATEGJIA E MËSIMDHENIES 2022</i>  <i>Dokumenti 8-VIII.STRATEGJIA E ZHVILLIMIT 2022-2026</i></p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Personeli akademik respekton dhe u përgjigjet larmisë dhe nevojave të studentëve, duke ofruar forma, mënyra, metoda e mundësi alternative të mësimdhënies e mësimnxënies.</p>	<p>Pjesa më e madhe e personelit akademik vjen nga një eksperiencë e gjatë punësimi apo shkollimi, duke i lejuar programit që jo vetëm të vërë në zbatim eksperiencën e fituar në format bashkëkohore të mësimdhënies. Po kështu, angazhimi i stafit në aktivitete të ndryshme si mobilitete në universitete të huaja, konferenca, seminare, workshope, etj.), ka shërbyer si një bazë mjaft e mirë për përmirësimin e mësimdhënies dhe literaturës së përdorur, duke synuar përshtatjen me trendet e brendshme dhe globale sipas prioriteteve të përcaktuara në Strategjinë e FE-së.</p> <p><i>Dokument: Analiza e punes shkencore e Ad-Biz, 19-20</i>  <i>Dokument: Analiza e punes shkencore e Ad-Biz, 21-22</i>  <i>Dokument: Analiza e punes shkencore 2019-2020 e FE</i></p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Institucioni mbështet personelin akademik në përmirësimin e kompetencave didaktike dhe në përputhje me rezultatet e pritshme të të nxënit.</p>	<p>UNISHK dhe departamenti përkatës mbështesin përhapjen e metodave të suksesshme mësimore ndërmjet stafit akademik, duke synuar rritjen e vazhdueshme profesionale të pedagogëve dhe ofrimin e stimuljeve për përmirësimin profesional. Për këtë qëllim organizohen: a) aktivitete shkencore si në nivel kombëtar ashtu edhe ndërkombëtar, ku pedagogët nxiten që të paraqesin punimet e tyre shkencore; b) botimi i monografive apo artikujve shkencore; c) programet e bashkëpunimit me institucione ndërkombëtare. Më konkretisht stafi i angazhuar në këtë program studimi është angazhuar me organizimin dhe</p>

	<p>pjesëmarrjen në Konferencën Ndërkombëtare me temë "Dynamics of Sustainable Economic and Social Development, DySESD 2019, organizuar nga Fakulteti Ekonomik i Universitetit të Shkodrës, në vitin 2019. Po kështu, disa anëtarë të departamentit të Administrim Biznesi kanë qënë pjesë e komitetit organizativ, komitetit shkencor etj. Në analizën e departamentit të AB 2019-2020, theksohet që "Njësia bazë Administrim Biznes, ka si politikë të nxisë dhe të mbështesë integrimin e kërkimit shkencor në programet mësimore me qëllim krijimin e mundësive që nxisin të mësuarit, por mbi të gjitha pasqyrojnë ndikimin jetësor të kërkimit si dhe rezultatet e kërkimit shkencor kanë përmirësuar ndjeshëm pedagogjinë e mësimdhënies duke e bërë atraktiv për studentin këtë proces. <i>Megjithatë ky aspekt mbetet i vështirë për tu evidentuar duke qënë se në syllabuset e lëndëve nuk vëmë re përfshirje punimeve shkencore të pedagogëve në literaturën e rekomanduar apo në rastet studimore të mbështetura.</i> GVJ, vlerëson që një pasqyrim i kërkimit shkencor të stafit të angazhuar në programin e studimit në syllabuse do ishte një praktikë e mirë për të evidentuar këtë aspekt që u përmend edhe gjatë takimeve në IAL.</p> <p><i>Dokument: Analiza e punes shkencore e Ad-Biz, 19-20</i></p> <p><i>Dokument: Analiza e punes shkencore e Ad-Biz, 21-22</i></p> <p><i>Dokument: Analiza e punes shkencore 2019-2020 e FE</i></p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Personeli akademik i angazhuar në mësimdhënien në program është kompetent në shpjegimin e njohurive dhe koncepteve, përdor metoda të ndryshme të mësimdhënies interaktive dhe diskutime me në qendër studentin, nxit te student mendimin krijues, atë kritik si dhe autonominë e përgjegjshmërinë</p> <p>Në të njëjtën kohë siguron udhëheqjen, mbështetjen dhe ndërtimin e marrëdhënieve të respektit të ndërsjellë mes tyre.</p>	<p>Eksperiencia ndërkombëtare e pedagogëve të departamentit ku bën pjesë programi i studimit Administrim Biznes, natyrisht që ndihmon jo vetëm cilësinë profesionale të tyre, por edhe lejon programin që të përfitojë nga metodat bashkëkohore të mësimdhënies që ata sjellin (<i>Dokument: Analiza e punes shkencore 2019-2020 e FE</i>). NetWork-u që këta pedagogë sjellin nga këto eksperiencia ndërkombëtare favorizon edhe bashkëpunimin e mëtejshëm si në kuadër të programeve specifike si psh, Projekti Interreg Balkan Mediterranean HELIX 1 i cili synon nxitjen dhe mbështetjen e bzneseve start-up dhe atyre ekzistuese. Ky projekt zhvillohet me partnerë si: Department of Planning and Regional Development (DPRD), University of Thessaly, Volos, Greqi, Universiteti i Manaxhimit i Varnes "Varna University of Managament etj. Stafi është angazhuar edhe në projekte të tjera në kuadër të Erasmus+Capacity building si, FINAC, FOST INNO, MARDS+ etj. Pedagogët përpiqen që të ndërtojnë marrëdhënie</p>



	<p>bashkëpunimi me studentët duke organizuar aktivitete shkencore me ta (<i>Takim me Stafin Akademik</i>).</p> <p>Një mënyrë tjetër e lidhjes së mësimdhënies me kërkimin shkencor është edhe organizimi në rang njësie kryesore, i workshop-it të përvitshëm "Sfidat e Zhvillimit Rajonal 8", organizuar nga Fakulteti Ekonomik, si dhe pjesëmarrja në Buletinin Shkencor i USH-së, Seria e Shkencave Ekonomike.</p> <p><i>Dokument 3.20 Mobilitetet 2017-2020</i>  <i>Dokument Mobilitete stafi 2020-2023.</i>  <i>Dokument 4.4 Curriculum Vitae Pedagoget</i>  <i>Dokument Cv e pedagogeve.pdf</i>  <i>Dokument: Analiza e punes shkencore e Ad-Biz, 19-20</i>  <i>Dokument: Analiza e punes shkencore e Ad-Biz, 21-22</i>  <i>Dokument: Analiza e punes shkencore 2019-2020 e FE</i>  <i>Dokument: 17-XVII. ANALIZA MESIMORE- SHKENCORE 2022</i></p>
<p><b>Kriteri 5.</b> Njësia përgjegjëse për ofrimin e programit të studimit, vlerëson dhe përmirëson format e metodat e mësimdhënies në mënyrë periodike, duke përfshirë studentët në këtë proces dhe duke reflektuar mendimet e këshillat e tyre.</p>	<p>Departamenti Administrim Biznesi përdor mënyra periodike vlerësimi për përmirësimin e mësimdhënies nga instanca të ndryshme të cilat mund të përmbliidhen në vlerësimin nga:</p> <p>a) Drejtuesi i Departamentit, përgjegjës për organizimin e punës didaktike dhe zhillimin strategjik të departamentit nëpërmjet analizave vjetore. Ky proces kryhet nëpërmjet analizave periodike të personelit akademik, kontrollit të cilësisë së syllabuseve, harmonizimit të ngarkesës së stafit akademik, ndihmës që i ofrohet stafit të ri, trainimit për përgatitjen e kurrikulave akademik, vlerësimin të performancës së stafit akademik, etj. Po kështu në nivel institucional në nenin 14 dhe 15 Dokumenti Manuali i Cilësisë paraqiten aspekte të vlerësimin të cilësisë së programit të studimit si dhe aspekteve të tjera që lidhen me punën mësimore dhe kërkimore të stafit si dhe indikatorët përkatës. Megjithatë nga takimi me përfaqësues të zyrës u vu re se kjo njësi duhet të përmirësojë punën e kryer nëpërmjet krijimit të një plani aktiviteteve të cilat duhet të shkojnë më në brendësi të elementëve mbështetës të programit të studimit. Për shembull nga takimi u vu re që specialistët realizonin nëse syllabuset ishin konform VKM-së por pa reflektuar një plan masash nëse ato nuk ishin në përputhje. Syllabuset veçanërisht paraqiten problematike sa i përket formatit si dhe literaturës të vjetëruar në shumicën e rasteve. NJSBC mund të kërkojë argumenta për kreditet e lëndëve të</p>

	<p>caktuara, formën e kontrollit të vazhduar e cila duhet të përditësohet në funksion të lëndës por edhe nevojave të studentëve.</p> <p><i>Dokument: 10-X. MANUALI I CILËSISË</i></p> <p><i>Dokumenti :Kopertina 2.3 NJSBC.png</i></p> <p><i>Dokumenti: Miratimi i perfaqesuesit te departamentit NJSBC e FE</i></p> <p><i>Dokumenti :Miratimi i rregullores NJSBC FE</i></p> <p><i>Dokumenti: Raport permbledhes mbi NJSBC fakulteti 2023</i></p>
<p><b>Kriteri 6.</b> Institucioni organizon struktura/ njësi në nivel institucional që promovojnë përmirësimin e vazhdueshëm të mësimdhënies, koordinojnë dhe bashkërendojnë me njësitë kryesore/bazë aktivitetet në kuadër të përmirësimit të cilësisë së mësimdhënies. Strukturat dhe njësitë përgjegjëse mbështesin eksperimentimin dhe zhvillimin e metodave të reja inovative të mësimdhënies, trajnojnë vazhdimisht personelin akademik për përmirësimin e aftësive të mësimdhënies dhe zbatimit të metodave të reja.</p>	<p>IAL ka dy struktura bazë për kontrollin dhe vlerësimin e cilësisë së mësimdhënies: Komisionin e Sigurimit të Cilësisë dhe Njësinë e Sigurimit të Cilësisë (<i>Statuti USH, neni 24 dhe 25</i>)</p> <p>Zyra e Sigurimit të Cilësisë është përgjegjëse për sigurimin e cilësisë dhe përmirësimin e këtij niveli duke përdorur një sërë mekanizmash si: - hartimit të politikave dhe procedurave për sigurimin e brendshëm të cilësisë, të cilat miratohen në Senatin Akademik;-- vlerëson, periodikisht, rezultatet e veprimtarive mësimore dhe kërkimore-shkencore; -në fund të semestrit, para sezonit të provimeve, organizon pyetësin studentor për cilësinë e mësimdhënies për lëndët e çdo programi studimi; realizon studime gjurmuese për të vlerësuar ecurinë e punësimit të studentëve dhe efikasitetin e programeve të ofruara nga institucioni i arsimit të lartë;-- harton dhe i propozon Senatit standardet për sigurimin e cilësisë në përputhje me Kodin e Cilësisë;--prezanton raportin vjetor të vlerësimit të brendshëm të cilësisë së USH-së në Senatin Akademik, i cili miraton raportin vjetor përfundimtar të vlerësimit të brendshëm të cilësisë në USH. Vlerësimet periodike të studentëve për pedagogun, të cilat kryhen nëpërmjet plotësimit të një formulari në formë anonime. Duke ofruar sugjerime, studentët ndihmojnë jo vetëm në vlerësimin e cilësisë së punës së pedagogut, por edhe përfshihen në përmirësimin e programit të studimit. Vlerësimet e lartpërmendura të pedagogëve i dërgohen drejtuesit të departamentit, i cili ia dërgon Dekanit dhe me pas Rektoratit. GVJ vlerëson që pavarësisht ekzistencës së kornizës institucionale të NJSBC-së më shumë përpjekje duhen bërë nga kjo njësi për të operacionalizuar objektivat që i ka vendosur vetes, të paraqitura në Statut USH por edhe në rregulloren e NJSBC-së. Raporti Dokumenti: Raport permbledhes mbi NJSBC fakulteti 2023 ofron vetëm një përgjigje të reduktuar</p>



	<p>të gjetjeve të pyetësorit të studentëve pa një narrative konkrete në lidhje me masa të tjera për sigurimin e cilësisë.</p> <p>GVJ vlerëson që kjo zyrë duhet të bëjë më shumë përpjekje për të krijuar instrumenta të vlerësimit 360 gradë të programit të studimit, të shtrihet në aktorë të tjerë që lidhen direkt ose indirekt me programin e studimit. Paketa e përbërë nga 1. ANALIZA SWOT (Analiza realizohet nga pedagogu i cili bën një vetvlerësim në lidhje me leksionet, seminarët, detyrimet e studentit), 2. Pyetësor për studentët për programin e studimit, 3. Pyetësori për studentet që kanë perfunduar studimet në UNISH në lidhje me programin e studimit dhe mësimdhënien, 4. Pyetësori për punëdhënësit, 5. Formular vlerësimi nga personeli akademik i cili zhvillohet në fund të çdo viti akademik nga personeli akademik, duhet të shërbejë për të krijuar një plan konkret monitorimi dhe vlerësimi si dhe një plan vjetor aktiviteteve.</p> <p><i>Dokument 1-I.STATUTI USH.pdf</i>  <i>Dokument:10-X. MANUALI I CILËSISË</i>  <i>Dokumenti :Kopertina 2.3 NJSBC</i>  <i>Dokumenti: Miratimi i perfaqesuesit te departamentit NJSBC e FE</i>  <i>Dokumenti :Miratimi i rregullores NJSBC FE</i>  <i>Dokumenti: Raport permbledhes mbi NJSBC fakulteti 2023</i></p>						
<p><b>Konkluzione</b></p>	<p><i>GVJ vlerëson që IAL harmonizon një sërë formash të mësimdhënies dhe mësimxënies falë ekperiencës së pedagogëve dhe punës që bëhet për evidentimin dhe zbatimin e formave sa më të mira të përmirësimit të punës së pedagogëve <u>megjithatë më shumë përpjekje duhen bërë për vlerësimin e nga studentët, kolegët apo edhe vetëvlerësimi për të matur progresin e bërë në drejtim të formave sa më të përshtatshme të mësimdhënies dhe mësimxënies.</u></i></p>						
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>	<table border="1"> <thead> <tr> <th data-bbox="584 1509 762 1608">Përmbushet pjesërisht</th> <th data-bbox="762 1509 941 1608">Përmbushet kryesisht</th> <th data-bbox="941 1509 1139 1608">Përmbushet plotësisht</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td data-bbox="584 1608 762 1662"></td> <td data-bbox="762 1608 941 1662"></td> <td data-bbox="941 1608 1139 1662" style="text-align: center;"><b>X</b></td> </tr> </tbody> </table>	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht			<b>X</b>
Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht					
		<b>X</b>					

<p><b>Standardi III.2</b></p>	
<p><b>Institucioni harton rregullore dhe procedura të posaçme të testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale dhe garanton zbatimin e tyre.</b></p>	
<p><b>Kriteret</b></p>	<p><b>Vlerësimi i ekspertëve</b></p>

*Ekold*

*[Signature]*

<p><b>Kriteri 1.</b> Kriteret dhe mënyra e testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale përcaktohen në Rregulloren e programit të studimit/Rregulloren e Institucionit/rregullore të posaçme, bëhen publike dhe njihen nga studentët.</p>	<p>Mënyra e vlerësimit të studentëve pasqyrohet në syllabuset e çdo lënde, ku në një seksion të veçantë paraqiten kriteret e vlerësimit për lëndën. Institucioni ka një formë të miratuar me karakteristikat kryesore të vlerësimit për programet bachelor/master por pedagogu i lëndës ka të drejtën e përshtatjes së tyre për një vlerësim sa më efikas të lëndës. Në përgjithësi lëndët vlerësohen sipas shpërndarjes së mëposhtme: a) provim përfundimtar 70%; b) detyrë kursi ose prezantim 20%; c) pjesmarrje aktive gjatë periudhës së zhvillimit të lëndës 10%. Kriteri i fundit i shërben pedagogut për të kontrolluar në mënyrë të vazhdueshme progresin e studentit, si nëpërmjet diskutimeve ashtu edhe detyrave të kursit në klasë. <i>(Takim me Stafin Akademik).</i></p> <p>Nga evidencat vihet re që ka edhe kontroll të vazhduar në masën 20% dhe pjesa tjetër provim përfundimtar.</p> <p><i>GVJ vlerëson që kjo formë kontrolli e vazhduar nuk nxit debatin dhe dhe pjesmarrjen e studenteve në tematikat mesimore prandaj nevojitet më shumë fleksibilitet në këtë drejtim dhe një ndryshim të raportit në favor të kontrollit të vazhduar dhe jo atij përfundimtar.</i></p> <p><i>Dokument 1.24 Shembull Syllabus viti 2022-2023.pdf</i></p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Në fillim të çdo lënde/moduli studentët informohen me metodologjinë e testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore të parashikuara në syllabuset e lëndëve/moduleve nga titullari i lëndës/modulit.</p>	<p>Studentët e programit njihen me syllabusin dhe të gjithë elementët e tjerë të kursit, gjatë orës së parë të zhvillimit të lëndës apo modulit. Këtu përfshihen edhe informacionet lidhur me mënyrën e testimit si edhe kriteret e transparencës për një vlerësim sa me objektiv. (Takimi me stafin, Studentët dhe Rregullorja e Departamentit të AB).</p> <p><i>Dokument 1.24 Shembull Syllabus viti 2022-2023.pdf</i> <i>Dokument 2-II. RREGULLORE E STUDIMEVE NË USH</i></p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore realizohet në forma dhe mënyra të ndryshme, duke i dhënë mundësi studentit të demonstrojë njohuritë dhe kompetencat e fituara.</p>	<p>Në përgatitjen e formave të testimit dhe vlerësimit të njohurive të studentit harmonizohen karakteristikat e lëndës dhe zgjedhja që pedagogu konsideron si më të përshtatshmen për këtë qëllim. Vlerësimi i studentit bëhet në dy pjesë: vlerësimi i vazhduar gjatë vitit për elementet e përcaktuara në programin e disiplinës/modulit dhe vlerësimi në provim. Vlerësimi i vazhduar gjatë vitit për lëndët/modulet e cilësuara provim në planin mësimor përfaqëson 20-40% të vlerësimit përfundimtar. Përcaktimi i raporteve në mes të vlerësimit të vazhduar gjatë vitit dhe vlerësimit përfundimtar bëhet nga çdo pedagog dhe paraqitet për miratim pranë departamentit për sistemin</p>

	<p>Bachelor (kordinatorit te programit master, per nivelin master) në fillim të vitit akademik. Megjithëse në Rregulloren e USH, neni 22 paraqitet një raport vlerësimi vjetor 20-40%.</p> <p><i>GVJ vlerëson që pjesa më e madhe e silabuseve i ka alokuar vlerësimin të vazhduar deri në 25%. Ky raport nuk mundëson angazhim aktiv të studentit gjatë vitit.</i></p> <p><i>Dokument 1.24 Shembull Syllabus viti 2022-2023.pdf</i>  <i>Dokument 2-II. RREGULLORE E STUDIMEVE NË USH</i></p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Njësia bazë/Personeli akademik vlerëson dhe përmirëson format e metodat e mësimdhënies në mënyrë periodike, duke përfshirë studentët në këtë proces dhe duke reflektuar mendimet e sugjerimet e tyre.</p>	<p>Si u përmend edhe më sipër personeli akademik vlerëson dhe përmirëson format e metodat e mësimdhënies në mënyrë periodike duke përdorur edhe eksperiencat nga mobilitetet e ndryshme të zhvilluara dhe pjesëmarrja në projekte (Takimi me stafin) po kështu nëpërmjet pyetësorit të realizuar në fund të çdo viti, merret feedback në lidhje me mësimdhënien dhe metodat.</p> <p>Megjithatë numri i ulët i studentëve që angazhohen në plotësimin e pyetësorit e bën marrjen e feedback-ut në lidhje me përmirësimin e metodave të mësimdhënies jo efektiv. Megjithëse nga takimi me studentët u konstatua së këta të fundit kishin kërkuar ndryshime në formën e kontrollit, kërkesë e cila ishte pranuar nga pedagogu përkatës.</p> <p><i>GVJ vlerëson që për të rritur efektivitetin e feedback, IAL duhet të integrojë përdorimin e instrumentave të tjerë për të mbledhur mendimin e studentëve si psh fokus grupet. Kjo do të bëjë të mundur përfshirjen e sa më shumë studentëve në këtë proces duke reflektuar mendimet e sugjerimet e tyre.</i></p> <p><i>Dokumenti 6.4 nr. XVI. Paketa e instrumentave matës të cilësisë në USH</i></p>
<p><b>Kriteri 5.</b> Institucioni mundëson përdorimin e metodave të shumëllojshme dhe fleksible pedagogjike, të përshtatshme e në përputhje me rezultatet e pritshme të të nxënit, objektivat formues dhe kërkesat e punëdhënësve. Format dhe metodat e mësimdhënies inkurajojnë sensin e autonomisë te studenti, duke siguruar në të njëjtën kohë udhëzimin dhe mbështetjen</p>	<p>Realizimi i lëndëve dhe programeve në Departamentin e Administrim Biznesi realizohet duke u bazuar në dy kompetenca kryesore: teorike dhe praktike. Në aspektin teorik studentët përfitojnë nga leksionet si dhe materialet shtesë sic është literatura e rekomanduar. Ndërsa në aspektin praktik realizohen në koordinimin e pedagogut zhvillohen diskutime në grupe ku studentët paraqesin pikpamjet e tyre lidhur me temën që trajtohet dhe interpretimin e tyre mbi njohuritë e marra por edhe ekskursione praktike pranë bizneseve (Takimi me stafin). Një aspekt i veçantë i programit lidhet edhe me zhvillimin e praktikave mësimore pranë institucioneve partnere si publike ashtu edhe privatë në rajonin e Shkodrës për ti mundësuar studentëve zbatimin praktik të njohurive të marra.</p>

nga mësime dhe ndërtimin e marrëdhënieve të respektit të ndërsjellë mes tyre.	<p><i>Megjithatë nga shqyrtimi i syllabuseve në pjesën më të madhe të lëndëve që lidhen direkt me emrin e diplomës, nuk paraqiten në mënyrë specifike/eksplicite objektivat e secilës lëndë dhe kompetencat (hard dhe soft skills) që fiton studenti në përfundimin e saj. <u>GVJ sugjeron</u> që të bëhet më shumë përpjekje në këtë drejtim sepse ndihmon jo vetëm studentin në vend por edhe nëse ky i fundit zhvendos studimet në një IAL tjetër jashtë apo benda vendit.</i></p> <p><i>Dokument 1.24 Shembull Syllabus viti 2022-2023</i></p>			
<b>Konkluzione</b>	<p><i>GVJ vlerëson qasjen proaktive të stafit në drejtim të metodave të përdorura për të arritur objektivat formues të programit të studimit megjithatë më shumë përpjekje duhet të bëhet në formalizimin e tyre dhe përdorimin e instrumentave të tjerë në marrjen e feedback nga student si dhe përmirësimin e raportit të kontrollit të njohurive gjatë vitit dhe në fund të tij.</i></p>			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>	<b>X</b>

<b>Standardi III.3</b>	
<p><b>Institucioni siguron vlerësim të drejtë dhe transparent, bazuar në meritën e çdo studenti duke përfshirë dhe procesin e ankimimit.</b></p>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<p><b>Kriteri 1.</b> Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale realizohet gjatë gjithë vitit akademik dhe reflektohet në vlerësimin përfundimtar, të parashikuara në syllabuset e lëndëve/ moduleve nga titullari i lëndës/modulit.</p>	<p>Institucioni ka një formë të miratuar me karakteristikat kryesore të vlerësimit për programet bachelor/master por pedagogu i lëndës ka të drejtën e përshtatjes së tyre për një vlerësim sa më efikas të lëndës. Mënyra e vlerësimit të studentëve paraqitet në nenin 22 të <i>Regullores së FE/SHU</i>, gjithashtu pasqyrohet në syllabuset e çdo lënde. Vlerësimi i studentit bëhet në dy pjesë: vlerësimi i vazhduar gjatë vitit për elementet e përcaktuara në programin e disiplinës/modulit dhe vlerësimi në provim. Vlerësimi i vazhduar gjatë vitit për lëndët/modulet e cilësuara në programin e studimit nën vlerësim përfaqëson 20-40% të vlerësimit përfundimtar. Ndërsa provimi përfundimtar përbën 60-80% të vlerësimit total. Përcaktimi i raporteve në mes të vlerësimit të vazhduar gjatë vitit dhe vlerësimit përfundimtar bëhet nga çdo pedagog dhe paraqitet për miratim pranë departamentit. Si është theksuar në mënyrë të vazhdueshme më sipër, në shumicën e syllabuseve, pikët e provimit përfundimtar zënë një peshë të</p>






	<p>konsiderueshme në raport me vlerësimin gjatë vitit, për të cilin GVJ ka dhënë rekomandimet përkatëse.</p> <p><i>Dokument 2-II. RREGULLORE E STUDIMEVE NË USH</i></p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Institucioni vë në zbatim sisteme elektronike të testimit dhe vlerësimit, të cilat shmangin forma të ndryshme abuzimi dhe rrisin transparencën.</p>	<p>USH ka adoptuar sistemin e menaxhimit të studentëve "ESSE3" më pas Pitagora që nga viti akademik 2013, i cili kryen funksionin e informimit të studentit në formë elektronike, krahas asaj të shkruar. Platforma Pitagora për menaxhimin e studentëve, garanton një menaxhim efikas të të dhënave të studentit gjatë gjithë qëndrimit të tij në universitet si dhe pas përfundimit të studimeve. Përmirësimi i informatizimit në drejtim të informimit dhe rritjes së transparencës është e reflektuar në nivel institucional edhe nëpërmjet Strategjisë së Zhvillimit të USH 2022-2026, e shprehur konkretisht në objektivin specifik 4 mbi Integritetin dhe Transparencën si dhe objektivi 7 Shërbimet Digjitale.</p> <p><i>Dokument 8-VIII.STRATEGJIA E ZHVILLIMIT 2022</i></p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Vlerësimi përfundimtar i lëndës bëhet në përputhje me syllabusin dhe bazën ligjore në fuqi.</p>	<p>Vlerësimi përfundimtar bëhet duke zbatuar rregulloret dhe kërkesat e syllabuseve përkatës për çdo lëndë dhe duke marrë parasysh përqindjet në vlerësimin përfundimtar të secilit element të testimit të lëndës si u përmend më sipër. Për një transparencë sa më të plotë, përqindjet e vlerësimit për çdo element vendosen në një rubrikë të veçantë të syllabus, si edhe u shpjegohet studentëve në fillim të çdo lënde</p> <p><i>Dokument 1.17.1,Rregullore programit bachelor administrim-biznes)</i></p> <p><i>Dokument 1.17.1 Rregullore departamentit Ad. Biznes</i></p> <p><i>Dokument 1.17.1Rregullore per funksionimin e departamentit bachelor ADM BIZNES</i></p> <p><i>Dokument 1.17.1Rregullore programit bachelor adm-biz</i></p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale shoqërohet me komente/feedback (nëse është i nevojshëm) dhe lidhet me këshilla mbi procesin e të nxënit për të ndihmuar studentin të përmirësohet në të ardhmen.</p>	<p>Vlerësimit të studentit i bashkëngjitet feedback i pedagogut i përcjellë përmes email apo komunikimit direkt të secilit student me pedagogun për të sqaruar arsyet e vlerësimit, ndërsa studentët inkurajohen që të shprehin ankesat e tyre për vlerësimin (<i>Takim me Studentët e Programit</i>). Si është përmendur më sipër pedagogët e programit marrin parasysh edhe ndryshime në numrin e kapitujve të përfshirë në kontrollin gjatë vitit dhe inkurajohen studentët për sugjerime.</p>
<p><b>Kriteri 5.</b> Njësitë përgjegjëse dhe personeli akademik shmangin/nuk lejojnë plagjiaturën,</p>	<p>Nga takimi me stafin përgjegjës për programin e studimit u konstatua se Sistemit Turnitin kundër plagjaturës sigurohet nga netëork-i vet pedagogëve. Në nivel institucional, vihet re që</p>



<p>kopjimin në provime dhe detyra.</p>	<p>IAL po planifikon të pajiset me sistemin e antiplagjiaturës duke e konsideruar si pjesë me rëndësi në Strategjinë e Zhvillimit të USH 2022-2026, konkretisht me Objektivin II. <i>Monitorimi i performancës dhe promovimi i integritetit akademik.</i></p> <p>Ndër aktivitetet kryesore të parashikuara në këtë objektiv janë: 1)Përdorimi i softit antiplagjiaturë për botimet në buletinet shkencore të USH-së, 2)Përdorimi i softuerit nga pedagogët si dhe 3)Përdorimi i softuerit antiplagjiaturë për temat diplomave. Në strategji paraqitet pajisja me këtë soft për 5 vitet që vijojnë. Gjithashtu, edhe ne strategjinë e kërkimit shkencor 2022, ku janë paraqitur si objektiva specifike 4 dhe 5, respektivisht, Përfshirjen e studentëve në kërkim shkencor dhe sigurimi i Integritetit dhe Transparencës, plagjiatura është pjese. Plagjiatura sqarohet nga pedagogët për studentët edhe gjatë kursit.</p> <p>Përveç kësaj, në USH ekziston Kodi i Etikës, të cilit duhet ti përmbahet çdo student duke u përpjekur që të mos bëjë asnjë veprim që bie ndesh me etiken akademike siç janë plagjiatura apo kopjet në provime.</p> <p><i>Dokument 8-VIII.STRATEGJIA E ZHVILLIMIT 2022</i> <i>Dokument 5-V. STRATEGJIA E KËRKIMIT SHKENCOR 2022</i> <i>Dokument 12-XII. KODI I ETIKES SE USH</i></p>
<p><b>Kriteri 6.</b> Rezultatet e kontrollit të dijeve dhe aftësive profesionale bazohen në meritë dhe jepen në kohë sipas përcaktimeve në rregulloret përkatëse.</p>	<p>Rregullorja përcakton afatet e dorëzimit të notave në sekretarinë mësimore, pasi më parë sekretaria ka informuar pedagogët lidhur me këto data, që në fillim të vitit akademik. Ky informacion pasqyrohet në kalendarin akademik, i cili publikohet edhe në faqen e IAL. Kalendarin siguron një zbatim në kohë të të gjitha proceseve të vlerësimit si nota, dhënia e feedback, kontrolli i notave, si edhe kohën procedurale për ankimitimin e notes. N <i>Dokument 2-II. RREGULLORE E STUDIMEVE NË USH paraqitet se:</i> Në përfundim të korigjimit te provimeve bëhet çsekretimi. Rezultatet u bëhen të njohura studentëve 7 ditë pas zhvillimit të provimit me njoftim ne posten elektronike te tij ose nje date te tuar nga pedagogu i lëndës e cila i behet e njohur edhe drejtorit të departamentit. Pas këtij ballafaqimi pedagogu plotëson notat në sistem, gjeneron procesverbalin. Ne rastin kur studentet nuk janë dakort me vlerësimin e bërë, në ditën e marrjes se rezultatit mund të bëjnë kërkesë me shkrim pranë Dekanit te fakultetit përkatës për rivlerësim, kërkesë e cila i dergohet departamentit përkatës. Departamenti krijon një komision add-hoc për rivlerësimin e studentit dhe vë në dijeni pedagogun e lëndës. Pas këtij afati</p>
<p><b>Kriteri 7.</b> Institucioni garanton të drejtat e studentëve për t'u njohur me vlerësimin, kërkesën për rishikim të vlerësimit në përputhje me rregullat që përfshihen në statut, rregulloret dhe procedurat e vlerësimit.</p> <p><b>Kriteri 8.</b> Çdo kërkesë, ankimitim, shqyrtohet nga komisioni i vlerësimit dhe më pas nga komisioni i posaçëm. Procedura e ndjekur duhet të jetë</p>	<p>Në përfundim të korigjimit te provimeve bëhet çsekretimi. Rezultatet u bëhen të njohura studentëve 7 ditë pas zhvillimit të provimit me njoftim ne posten elektronike te tij ose nje date te tuar nga pedagogu i lëndës e cila i behet e njohur edhe drejtorit të departamentit. Pas këtij ballafaqimi pedagogu plotëson notat në sistem, gjeneron procesverbalin. Ne rastin kur studentet nuk janë dakort me vlerësimin e bërë, në ditën e marrjes se rezultatit mund të bëjnë kërkesë me shkrim pranë Dekanit te fakultetit përkatës për rivlerësim, kërkesë e cila i dergohet departamentit përkatës. Departamenti krijon një komision add-hoc për rivlerësimin e studentit dhe vë në dijeni pedagogun e lëndës. Pas këtij afati</p>

<p>transparente për palët e përfshira, dokumentohet dhe arkivohet.</p>	<p>procesi i vlerësimit të provimit quhet i përfunduar dhe generohet procesverbali, dhe askush nuk ka të drejtë të ndërhyjë më në sistem për ndryshim rezultatesh. N rregulloret e mposhtme paraqiten dhe sezonet e ndryshme t riprovimit, përmirimit t notave, feedback-ut etj.</p> <p><i>Dokument 2-II. RREGULLORE E STUDIMEVE NË USH</i>  <i>Dokument 1.17.1 Rregullore departamentit Ad. Biznes</i>  <i>Dokument 1.17.1Rregullore per funksionimin e departamentit bachelor ADM BIZNES</i>  <i>Dokument 1.17.1Rregullore programit bachelor adm-bizneset (16-29)</i>  <i>1.17.8 NR. II. RREGULLORE E STUDIMIT</i></p>			
<p><b>Konkluzione</b></p>	<p><i>GVJ vlerëson që Institucioni siguron vlerësim të drejtë dhe transparent, bazuar në meritën e çdo studenti duke përfshirë dhe procesin e ankimimit të cilat I bën publike edhe nëpërmjet rregulloreve që ka në fuqi.</i></p>			
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>	<p>X</p>

<p><b>Stándardi III.4</b>  <b>Institucioni ngre struktura të posaçme në nivel institucional, të cilat promovojnë rritjen e vetëdijes për përmirësimin e cilësisë së mësimdhënies dhe mësimnxënies në programet e studimit.</b></p>	
<p><b>Kriteret</b></p>	<p><b>Vlerësimi i ekspertëve</b></p>
<p><b>Kriteri 1.</b> Programi i studimit duhet të garantojë thellimin e njohurive, të zhvillojë aftësitë profesionale dhe të veçanta të studentëve.</p>	<p>Programi i studimit ka formën dhe strukturën e një programi tradicional bachelor në AB, duke qenë se në krijimin e tij kanë kontribuar know-how i sfafi që ka përfunduar studimet në FE-UT. Lëndët që e përbëjnë programin mundësojnë dhënien e njohurive dhe aftësimin e studentëve në një spektër të gjerë fushash dhe disiplinash të lidhura me botën e biznesit dhe funksionet që zhvillohen brenda tij dhe krijojnë mundësinë e thellimi në nivele të tjera të studimeve të ciklit të dytë dhe të tretë. Megjithatë GVJ, vlerëson që IAL duhet të bëjë më shumë përpjekje për të reflektuar në program ndryshimet e fundit në teknologji dhe më gjerë. Në ditët që bëhet ky vlerësim janë duke u diskutuar praktika të digjitalizimit të theksuar të bizneseve dhe në programin e studimit nuk ofrohen lëndë që lidhen me të. Jo vetë në drejtim të marketingut por edhe</p>

	<p>menaxhimit. Po kështu si është përmendur më sipër, që të mund të thellohen njohuritë në vazhdimësi duhet të paraqiten njohuritë bazë si psh në sjelljen organizative, në sjelljen konsumatore të cilat nuk mund të kuptohen nëse me parë studentët nuk janë njohur më aspekte të sociologjisë dhe psikologjisë në biznes. <i>Prandaj GVJ rekomandon që programi i studimit duhet freskuar me lëndë të reja sugjerimet për të cilat janë përmendur edhe më sipër, si inovacion, psikologji, sociologji, digjitalizimi në biznesin e vogël etj.</i></p> <p><i>Dokumenti 1.17: Rregullore e programit të studimit BA në AB</i>  <i>Dokumenti 1.18 dhe 15.5.5.: Plani Mësimor</i>  <i>Dokumentet 1.16: Programi BA në AB sipas viteve</i>  <i>Dokumenti Viti 1, Viti 2 dhe Viti 3 me numrat përkatës (silabuset e lëndëve)</i></p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Programi i studimit garanton zhvillimin e aftësive të veçanta në fushën e teknologjisë së informacionit, humane, sociale, komunikimit dhe ndërveprimit.</p>	<p>Në lidhje me kriterin, “<i>Programi i studimit garanton zhvillimin e aftësive të veçanta në fushën e teknologjisë së informacionit, humane, sociale, komunikimit dhe ndërveprimit</i>” vlerësojmë që duhet të bëhen përpjekje për të reflektuar ndryshimet në botën e sotme të biznesit. Aktualisht, lëndët që garantojnë arritjen e këtij kriteri janë, Gjuhët e huaja, Komunikimi në Biznes, Sisteme informacioni menaxheriale (për periudhën 2021-2024).</p> <p>GVJ vlerëson që ka një vakum sa i përket lëndëve që do të kontribuonin në arritjen e këtij kriteri si: Sjellje organizative, Etika në biznes (nevojë e kohës për shkak të informacioneve personale që përdor sot biznesi), Shitje dhe Negocim të cilat mund të zhvillohen më pas edhe në master, Metoda Kërkimi në Biznes, Metoda Kërkimi në Marketing si dhe integrimi i Data Analytics në shumicën e lëndëve të orientuara nga administrimi i biznesit. Programi ka pësuar ndryshime shumë të vogla dhe këto ndryshime nuk bëhen më evidente kur në shkollat e biznesit sot në shkollat perëndimore po futen module të ndërthurura me fjalën më të fundit të teknologjisë si :</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Strategjitë e biznesit dhe Zbatimi i AI: Eksplorimi se si bizneset mund të zhvillojnë dhe ekzekutojnë strategji të AI për të fituar një avantazh konkurrues.</li> <li>• Etika dhe qeverisja e AI: Diskutimi i konsideratave etike që rrethojnë IA,</li> <li>• Analiza parashikuese dhe Përdorimi i Machine learning deep learning në Bines: që trajtojnë se si të</li> </ul>

	<p>shfrytëzohen algoritmet e AI për analiza parashikuese dhe vendimmarrje në biznes,</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• AI në Marketing dhe Shitje: Studimi se si AI përdoret në segmentimin e klientëve, marketingun e personalizuar dhe parashikimin e shitjeve.</li> <li>• Inovacioni i drejtuar nga AI: Kuptimi se si AI mund të nxisë inovacionin në zhvillimin e produktit dhe proceset e biznesit.</li> <li>• AI dhe Modelet e reja të Biznesit, se si AI mund të çojë në modele të reja biznesi</li> <li>• Sipërmarrja e drejtuar nga AI: Eksplorimi sesi startup-et përdorin AI për ide inovative biznesi.</li> <li>• AI dhe Përvoja e Klientit: Studimi se si AI përmirëson ndërveprimet me klientët, nga chatbot-et deri te rekomandimet e personalizuara. Etj.</li> </ul> <p>Ndryshimet mund të realizohen brenda syllabuseve dhe në literaturë pasi ka hapësirë për ndryshime nga viti në vit.</p> <p><i>Dokumenti 1.18 dhe 15.5.5.: Plani Mësimor</i></p> <p><i>Dokumentet 1.16: Programi BA në AB sipas viteve</i></p> <p><i>Dokumenti Viti 1, Viti 2 dhe Viti 3 me numrat përkatës (syllabuset e lëndëve)</i></p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Kompetencat dhe aftësitë që fiton studenti, të paraqitura në programin e studimit dhe syllabuset e çdo lënde, analizohen e shqyrtohen në përfundim të lëndës. Personeli akademik vë në pah çështjet më të rëndësishme dhe orienton studentët për zbatimin e tyre dhe për detyrimet përmbyllëse.</p>	<p>Nga takimi me stafin dhe studentët e programit të studimit Ba në Admnistrim Biznes u evidentua komunikimi i syllabuseve dhe aftësitë që fiton studenti. Gjithashtu nga vlerësimi i syllabuseve u evidentua vënia në pah e çështjeve më të rëndësishme për të orientuar studentët. Por nga ana formale vlerësojmë që duhet më shumë pëpjekje për të strukturuar syllabuset. <i>GVJ rekomandon që në seksionin e syllabusit që lidhet me Përmbledhje dhe rezultate të të nxënit, të paraqiten në mënyrë të detajuar përveç rezultateve të pritura edhe dy elementët e mëposhtëm:</i></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Objektivat e lëndës</li> <li>• Kompetencat që do të fitohen me përfundimin e lëndës</li> </ul> <p><i>Aspektet e tjera që duhen përmirësuar në syllabus janë përmendur në standartin 2</i></p> <p><i>Dokumenti Viti 1, Viti 2 dhe Viti 3 me numrat përkatës (syllabuset e lëndëve)</i></p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Mësimdhënia realizohet mbi bazë kompetencash që t'u japë studentëve mundësi të zhvillojnë njohuritë e marra</p>	<p>Realizimi i lëndëve dhe programeve në DA-FE-USH realizohet duke u bazuar në dy kompetenca kryesore: teorike dhe praktike. Në aspektin teorik studentët përfitojnë nga leksionet, materiali shtesë si edhe literatura e rekomanduar. Në aspektin praktik realizohen në koordinimin e pedagogut zhvillohen diskutime</p>



<p>në laboratorë dhe praktikat profesionale. Personeli akademik mbështet diskutimet dhe punën në grup në interpretimin dhe zgjidhjen e problemeve/çështjeve të caktuara; krijon klimë të përshtatshme për zhvillimin e ideve inovative, studime të përparuara kërkimore e shkencore dhe i mbështet ato; ndërthur format e mësimdhënies me institucionet bashkëpunuese për të mundësuar dhe rritur mobilitetin e studentëve.</p>	<p>ku studentët paraqesin pikpamjet e tyre lidhur me temën që trajtohet dhe interpretimin e tyre mbi njohuritë e marra. Pedagogu sigurohet që diskutimi të jetë gjithëpërfshirës dhe sa më shumë studentë të marrin pjesë. Një aspekt i vecantë i programit lidhet edhe me zhvillimin e praktikave mësimore pranë institucioneve partnere si publike ashtu edhe private apo të shoqërisë civile për ti mundësuar studentëve zbatimin praktik të njohurive të marra.</p> <p><i>Dokument 1.10 Marreveshjet me institucionet per praktiken</i></p>			
<p><b>Kriteri 5.</b> Personeli akademik, efektiv dhe me kontratë, realizon orë të hapura dhe seminare mbi zhvillime të reja të shkencës dhe teknologjisë brenda/jashtë strukturës së programit të studimit.</p>	<p>Personeli akademik organizon orë të hapura me guest-lectures por edhe inkurajon studentët që të marrin pjesë në seminarët akademike të organizuara nga FE-USH apo institucione të tjera duke paraqitur edhe punimet e përgatitura nga studentët në bashkëpunim edhe me pedagogët. Gjatë vitit 2022, departamenti i AB ka zhvilluar Edicionin e 5të të Workshop-it "Përditësim me Metodat e Kërkimit Cilesore &amp; Sasiore". Tema e trajtuar është: "Si të Shkruajmë një Artikull Shkencor të Mirë"- si dhe Udhëzime Editoriale rreth Publikimit në Journal-e Shkencore. Lektor i ftuar, Profesor i Assocuar Endrit Kromidha Departamenti i Menaxhimit, Universiteti i Birmingham-it, Mbretëria e Bashkuar, është bërë pjesë si rezultat i zhvillimit të netëork të pedagogëve të departamentit (Ph.D. Elvisa Drishti).</p> <p><i>Dokument 1.14 Workshop Metoda Kerkimi</i></p>			
<p><b>Konkluzione</b></p>	<p><i>GVJ vlerëson që IAL-USH ngre struktura të posaçme në nivel institucional, të cilat promovojnë rritjen e vetëdijes për përmirësimin e cilësisë së mësimdhënies dhe mësimnxënies në programet e studimit megjithatë si është referuar edhe më lart cilësia e mësimnxënies është pashmangshërisht e lidhur me përmbajtjen e programit të studimit i cili sugjerojmë të përditësohet dhe balancohet në drejtim horizontal, në lidhje me raportin lëndë biznesi/finance por edhe vertikal lëndë të ciklit të parë me ato të ciklit të dytë në AB. .</i></p>			
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>	<p>X</p>

*Elvis*

*Jan*



**Standardi III.5**

**Institucioni ndjek një procedurë të qartë të detyrimeve përmbyllëse të studentit në programin e studimit dhe e pajis atë me dokumentacionin përkatës.**

<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<p><b>Kriteri 1.</b> Institucioni harton rregullore të posaçme për provimin i përgjithshëm përfundimtar ose punimin e diplomës. Në rregulloren e programit të studimit përcaktohet pragu i notës mesatare që i jep të drejtën studentit për punim diplome dhe e bën atë publike.</p>	<p>Rregullorja e programit të studimit të ciklit të parë Bachelor në Administrim Biznes (<i>Kreu V, Diplomimi, neni 30-33</i>) përcakton procedurat që duhet të ndjekin studentët lidhur me detyrimet përmbyllëse dhe projektin e diplomimit. Në rregulloren e sipërmendur trajtohet Neni 31: Mbrojtja e diplomës me provim përfundimtar si dhe Neni 32: Mbrojtja e diplomës me punim diplome. 1. Diplomimi me punim diplome bëhet nga studentët që kanë notën mesatare jo më pak se 8.5 (tetë pikë pesë) për sistemin Bachelor. 2. Njësia bazë Administrim-Biznes përcakton fushat e punimit të diplomës në fillim të semestrit të parë të vitit të fundit të studimeve.</p> <p><i>Dokument 2-II. RREGULLORE E STUDIMEVE NË USH</i> <i>Dokument 1.17.1 Rregullore departamentit Ad. Biznes</i> <i>Dokument 1.17.1 Rregullore per funksionimin e departamentit bachelor ADM BIZNES</i> <i>Dokument 1.17.1 Rregullore programit bachelor adm-biz nenet (30-33)</i> <i>1.17.8 NR. II. RREGULLORE E STUDIMIT</i></p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Strukturat përgjegjëse dhe personeli akademik asistojnë studentët, duke vënë në dispozicion informacione, udhëzime dhe materialet e nevojshme në funksion të detyrimeve përmbyllëse.</p>	<p>Pedagogët por edhe sekretaria mësimore i ndihmojnë studentët me informacionin e nevojshëm lidhur me detyrimet afatet kohore dhe procedurat e realizimit të detyrimeve përmbyllëse. Ky informacion përfshin si detyrimet akademike ashtu edhe ato financiare që studentët kanë për përmbylljen e programit.</p> <p><i>Dokument 1.17.1 Rregullore programit bachelor adm-biz nenet</i> <i>1.17.8 NR. II. RREGULLORE E STUDIMIT</i></p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Komisioni i posaçëm për administrimin e provimit final bazohet në testimin e njohuritë e dhëna gjatë gjithë viteve akademike, duke përfshirë të gjitha lëndët/ modulet në bazë të rëndësisë dhe peshës specifike.</p>	<p>Rregullorja e departamentit dhe e programit të studimit përcakton procedurat që duhet të ndjekin studentët lidhur me detyrimet përmbyllëse dhe projektin e diplomimit. Kur mbrojtja e diplomës bëhet me provim përfundimtar rregullorja e programit të studimit përcakton si më poshtë:</p>

	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Njësia bazë Administrim Biznes përcakton dhe miraton programin e mbrojtjes së diplomës dhe ua bën të njohur studentëve;</li> <li>• Komisioni i mbrojtjes me provim përfundimtar përbëhet nga pedagogët titullarë të fushave përkatëse të përfshira në program. Komisioni propozohet nga drejtuesi i njësisë bazë dhe miratohet nga drejtuesi i njësisë kryesore;</li> <li>• Komisioni përgatit tezat e provimit (jo më pak se 5) të cilat duhet të përfshijnë të gjitha fushat që janë të përfshira në program;</li> <li>• Procedurat e realizimit të provimit përfundimtar janë të njëjta me ato të provimeve me shkrim të kursit;</li> </ul> <p><i>Dokument 1.17.1 Rregullore programit bachelor adm-biz neni 31</i></p> <p><i>Dokument 3.30 Formatet dhe udhezuesit per temat</i></p> <p><i>Dokumen 3.31 Miratim i Senatit per Formatin e Diplomes Bachelor</i></p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Personeli akademik/ Udhëheqësi i diplomës orienton dhe ndihmon studentët në përcaktimin e temave të punimit të diplomës. Udhëheqësi asiston studentin në nxjerrjen e rezultateve, përpunimin e tyre, si dhe në punimin e diplomës sipas udhëzuesve të miratuar. Ai garanton cilësinë e rezultateve dhe miraton ose jo nëse punimi është i plotë për t'u paraqitur para komisionit.</p>	<p>Nga takimi me stafin e programit të studimit si dhe me studentët u evidentua se Udhëheqësi i diplomës orienton dhe ndihmon studentët në përcaktimin e temave të punimit të diplomës. Udhëheqësi asiston studentin në nxjerrjen e rezultateve, përpunimin e tyre, si dhe në punimin e diplomës sipas udhëzuesve të miratuar. Studentët mund të zgjedhin ndërmjet pedagogëve të programit udhëheqësin për temën e diplomës duke patur parasysh përputhshmërinë e fushës së kompetencave akademike të pedagogut me temën që ata mendojnë. Më pas së bashku me udhëheqësin kristalizohet më tej dhe i hap rrugën aprovimit të procedurës nga ana e drejtuesit të departamentit. Studenti punon në temën e dizertacionit duke u konsultuar dhe orientuar në çdo hap nga udhëheqësi duke filluar nga gërshetimi i metodologjisë me kërkimin shkencor, rezultatet, përpunimin e tyre dhe hartimin e konkluzioneve. Studenti paraqet drafte të punës dhe merr vazhdimisht feedback nga udhëheqësi. Ky i fundit vendos kur punimi është i gatshëm për tu dorëzuar në komisionin e vlerësimit duke garantuar cilësinë shkencore të temës së diplomës. Punimet më të mira të temave të diplomave publikohen në buletin dhe kishin gjithashtu një vend të veçantë në bibliotekën e fakultetit.</p> <p><i>Dokument 3.30 Formatet dhe udhezuesit per temat</i></p>

*Kolb*

*[Signature]*

	<i>Dokumen 3.31 Miratim i Senatit per Formatin e Diplomes Bachelor</i>
<b>Kriteri 5.</b> Njësia bazë asiston studentët për kryerjen e matjeve, analizave, testeve në mjediset e institucionit apo jashtë tij në bazë të temave dhe fushës së studimit.	Udhëheqësit i asistojnë studentët në të gjitha hapat e përgatitjes dhe punimit të diplomës. Përveç vendosjes në dispozicion të studentit të të gjithë bazës së nevojshme materiale brenda IAL, udhëheqësi ofron, kur është e nevojshme ndihmë shtesë nëpërmjet përdorimit të sofëare statistikore si SPSS në laboratorët e FE-USH.  <i>(Takimi me stafin dhe studentët e programit të studimit)</i>
<b>Kriteri 6.</b> Në përfundim të provimit të përgjithshëm përfundimtar ose të mbrojtjes së diplomës, studenti vlerësohet me notë.	Tema e Diplomës dhe provimi përfundimtar i diplomës vlerësohen nga komisioni i ngritur për këtë qëllim duke patur parasysh cilësinë shkencore të punimit. Komisioni jep feedback mbi vlerësimin e bërë me shkrim. Si minimum i notës kaluese konsiderohet pragu i 45 pikëve.  <i>Format udhëzuesi teme diplome bachelor (1). Lendet dhe temat e prov te diplomave 2022-2023. Temat dhe lendet qe perfshihen ne prov te mbrojtjes. Udheheqje diplome 20-21. Udheheqje diplome 21-22. Udheheqje diplome.pdf</i>
<b>Kriteri 7.</b> Në përfundim të studimeve, studenti pajiset me diplomën dhe suplementin e diplomës, të miratuara nga ministria përgjegjëse për arsimin. Në përfundim të studimeve, studentit i vihet në dispozicion kopje e plotë zyrtare e programit të studimit të zhvilluar.	USH në rregulloren e institucionit ofron udhëzime të qarta për pajisjen e studentit me diplomë. Në përfundimin e suksesshëm të programit të gjithë studentët pajisen me diplomën dhe suplementin e diplomës ( <i>Rregullore e studimeve USH, neni 39</i> ).  Forma dhe përmbajtja e këtyre dokumentave janë të miratuara nga Ministria e Arsimit dhe Qendra Kombëtare e Shërbimit të Studentëve (QSHA), ndërsa dorëzimi i tyre bëhet në një ceremoni të veçantë. Për studentët që kanë përfunduar studimet me të gjitha notat 10, jepet medalje e artë dhe certifikata përkatëse. Medalja e arit dhe emri i tij/saj regjistrohen në Librin e Universitetit. Për studentët që kanë përfunduar studimet me notën mesatare të ponderuar mbi 9.00, jepet certifikata "Student ekselent".  <i>Dokument 1.17.8 NR. II. RREGULLORE E STUDIMIT</i>
<b>Kriteri 8.</b> Institucioni ruan në përputhje me legjislacionin në fuqi kopje të dokumentacionit të studentit dhe paraqet rast pas	Sekretaria Mësimore ka si detyrë mbajtjen e regjistrit themeltar me të dhënat e studentëve, si në formën fizike ashtu edhe në atë elektronike ( <i>Rregullore e studimeve USH</i> ). Sekretaria ngarkohet edhe me mbajtjen e kartelës së studentit

rasti informacione për studentin nëse kërkohen.	ku pasqyrohen kreditet e akumuluar. Dosjet personale të studentëve pas diplomimit ruhen në arkivin qendror të universitetit duke respektuar normat në fuqi për privatësinë por edhe rregulloren e këtij arkivi (Vizita e GVJ në IAL).			
<b>Konkluzione</b>	<i>Institucioni ndjek një procedurë të qartë dhe transparente të detyrimeve përmbyllëse të studentit në programin e studimit. Ky hap ndërmerret vetëm pasi studenti ka shlyer të gjitha detyrimet akademike. USH e përgatit atë me dokumentacionin e nevojshëm duke përfshirë si diplomën, ashtu edhe diploma suplement.</i>			
<b>Shkalla e përmbylljes së standardit</b>		Përmbylljet pjesërisht	Përmbylljet kryesisht	Përmbylljet plotësisht
				X

<b>Shkalla e përmbylljes së standardeve të fushës III</b>		Përmbylljet pjesërisht	Përmbylljet kryesisht	Përmbylljet plotësisht
				X

#### IV .BURIMET NJERËZORE, FINANCIARE, INFRASTRUKTURA, LOGJISTIKA PËR REALIZIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT

<b>Standardi IV.1</b>	
<b>Personeli akademik që mbulon programin e studimit, përmbyll standardet sasiore dhe ka kualifikimin e duhur e të posaçëm akademik në përputhje me fushën e programit për garantimin e standardeve të mësimdhënies të programit të studimit.</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Personeli akademik dhe ndihmës akademik, që angazhohet në realizimin e programit të studimit, përmbyllin kërkesat ligjore në fuqi, për nivelin e kualifikimit akademik, për drejtimin e programit, drejtimin dhe angazhimin në mbulimin e lëndëve/moduleve të programit, për fushën kërkimore ose eksperiencën praktike në përputhje me programin e studimit,	GVJ konstaton se Departamenti i Administrim Biznesit, në vitin aktual 2022-2023, ka 23 personel akademik gjithsej, 10 pedagogë me kohë të plotë dhe 13 pedagogë me kohë të pjesshme. Nga shyrtimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion, referuar listës së stafit akademik të angazhuar në këtë program ( <i>Dokument 6.15 Tabelat përmbledhese të RVB, tab 6.1-6.3</i> )  1. Për vitin akademik 2020- 2021 kanë dhënë mësim në këtë program studimi 14 pedagogë nga të cilët 9 PAE dhe 5 PAK (65 % /35 %);



natyrën dhe veçorinë e moduleve të tij.

2. Për vitin akademik 2021- 2022 kanë dhënë mësim në këtë program studimi 17 pedagogë nga të cilët 10 PAE dhe 7 PAK (60 % / 40 %);

3. Për vitin akademik 2022- 2023 kanë dhënë mësim në këtë program studimi 16 pedagogë nga të cilët 10 PAE dhe 6 PAK (62.5 % / 37.5 %);

Tituj/grada	2020 - 2021		2021 - 2022		2022 - 2023	
	PAE	PAK	PAE:	PAK:	PAE:	PAK:
Prof.Dr	1	-	-	-	1	-
Prof.As.Dr	1	-	2	-	2	-
Dr/PhD	5	-	7	3	7	1
Msc	2	5	1	4	-	5
Në total	9	5	10	7	10	6

Nga vlerësimi i CV-ve të stafit të angazhuar në këtë program studimi vihet re cilësia e stafit akademik në tregues si :

1. Pjesëmarrja në konferenca kombëtare dhe ndërkombëtare,
2. Pjesëmarrja në projekte ndërkombëtare si FINAC, EUREQA, TEMPUS, CEPUS, INTERREG, JUNIOR ACHIEVEMENT, HELIX,
3. Pjesëmarrja në mobilitete kërkimore në Evropë dhe Shtetet e Bashkuara të Amerikës
4. Pjesëmarrja në mobilitete teaching në, Itali, Spanjë, Gjermani, Austri, Çeki, Kroaci, Hungari, Poloni, Rumani, Bullgari etj.
5. Pjesëmarrja në trajnime të ndryshme që lidhen me tematikat që mbulojnë në këtë program studimi për organizata të ndryshme në zonën e Shkodrës por edhe me gjerë,
6. Pjesëmarrja në projekte Erasmus Capacity Building (ju mundëson përmirësim të vazhdueshëm të metodologjive mësimdhënëse,
7. Pjesëmarrja në shkolla verore dhe workshope për metodat e analizës së të dhënave.
8. Prania e pjesës më të madhe të stafit të angazhuar në outlete si google scholar, research gate dhe scopus, si dhe publikime me faktor impakti me citime të konsiderueshme (psh Përgjegjësi i dep Ylvije Kraja)



	<p>9. Eksperiencia jashtë auditorit për vite me rradhë në organizatat e biznesit mundëson përçim të elementëve praktikë te studentët.</p> <p>Gjithashtu kryerja e një cikli studimesh jashtë vendit për një pjesë të stafit është një element shtesë për përmbushjen e cilësisë së stafit të angazhuar në këtë program studimi. GVJ vlerëson që të gjithë këto tregues influencojnë pozitivisht në cilësinë e mësimdhënies dhe kërkimit shkencor në departamentin përgjegjës për ofrimin e programit të studimit.</p> <p><i>Dokument 3.20 Mobilitetet 2017-2020</i>  <i>Dokument Mobilitete stafi 2020-2023.</i>  <i>Dokument 4.4 Curriculum Vitae Pedagoget</i>  <i>Dokument Cv e pedagogeve.pdf</i>  <i>Dokument: Analiza e punes shkencore e Ad-Biz, 19-20</i>  <i>Dokument: Analiza e punes shkencore e Ad-Biz, 21-22</i>  <i>Dokument: Analiza e punes shkencore 2019-2020 e FE</i>  <i>Dokument: 17-XVII. ANALIZA MESIMORE- SHKENCORE 2022</i></p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Personeli akademik efektiv duhet të mbulojë ngarkesën mësimore për programin e studimit në përputhje me kornizën ligjore në fuqi.</p>	<p>Personeli akademik efektiv mbulon ngarkesën mësimore për programin e studimit në përputhje me kornizën ligjore në fuqi. Kështu bazuar në tabelat përmbledhëse lidhur me orët te paraqitur nga IAL vlerësohet që:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Për vitin e parë akademik në analizë, 2020-2021, orët në total të zhvilluara janë 645, nga të cilat 81% mbulohet nga stafi PAE dhe 19% nga stafi PAK;</li> <li>• Për vitin akademik 2021-2022, orët e zhvilluara janë 630 nga të cilat 59% mbulohen nga stafi PAE dhe 49% nga PAK;</li> <li>• Për vitin 2022-2023, orët në total janë 690, nga të cilat 88% janë mbuluar nga stafi PAE dhe 12 % nga PAK;</li> </ul> <p>Si përfundim kriteri ligjor plotësohet pasi në 1965 orë në total, 76,8% mbulohen nga stafi PAE dhe 23,2% nga stafi PAK.</p> <p><i>Dokument 6.15 Tabelat permbledhese</i>  <i>Dokument 1.21.2 Analiza e punes shkencore e Ad-Biz, 21-22</i>  <i>Dokument 6.11 PAE-PAK te dhena</i></p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Institucioni duhet të garantojë dhe të dëshmojë qëndrueshmërinë e personelit akademik efektiv</p>	<p>Institucioni ka angazhuar staf akademik PAE dhe PAK për të plotësuar kërkesat e programit, të cilët kanë pregatitjen profesionale në fusha të ndryshme dhe të angazhuar në mënidhënie të lëndëve që përputhen me fushat e tyre të kërkimit</p>

*Handwritten signature*

*Handwritten signature*

<p>të angazhuar në programin e studimit, për të gjithë periudhën e akreditimit, duke përfshirë kontratat e punësimit dhe mbulimin me sigurime shoqërore dhe shëndetësore.</p>	<p>shkencor. Nga analiza e CV të stafit, tabelave të ngarkesës si dhe mosha e personelit të angazhuar, GVJ vlerëson që ky kriter plotësohet. Nga takimi me stafin u evidentua ndjesia e përkatësisë me institucionin e cila lidhet dhe me angazhimin në punë dhe për rrjedhojë cilësinë. Një pjesë e stafit përmendi që është rritur profesionalisht në atë IAL.</p> <p><i>Dokument 4.5 Kontratat e Pedagoqeve Brendshem e Jashtem</i>  <i>Dokument 4.4 Curriculum Vitae Pedagoget</i>  <i>Dokument Cv e pedagoqeve.pdf</i>  <i>Dokument: Analiza e punes shkencore e Ad-Biz, 19-20</i>  <i>Dokument: Analiza e punes shkencore e Ad-Biz, 21-22</i>  <i>Dokument: Analiza e punes shkencore 2019-2020 e FE</i>  <i>Dokument: 17-XVII. ANALIZA MESIMORE- SHKENCORE 2022</i></p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Institucioni ndjek procedura rekrutimi dhe vlerësimi, mbështetur në kriteret të përgjithshme dhe specifike të publikuara e që garantojnë përzgjedhjen e personelit me nivelin e duhur të kualifikimit dhe në përputhje me natyrën, strukturën, modulet dhe përmbajtjen e programit të studimit.</p>	<p>UNSHK në përputhje me aktet e veta rregullatore (<i>Dokumenti 1. Statuti i USH, Neni 43, Punësimi i Personelit Akademik</i>) si dhe <i>Dokument 11-XI. RREGULLORE E PUNESIMIT Neni 6-12 për PAE, Neni 15-21 për PAK dhe Neni 23-32 personel ndihmës akademik</i>) ka të përcaktuara procedurat e rekrutimit të personelit akademik, jo akademik si dhe personelit ndihmës akademik. Në bazë të dokumentacionit si edhe në vizitën që GVJ pati në IAL evidentohet rruga dhe procedurat që ndiqen për punësimin e stafit akademik dhe ndihmës akademik. Departamenti bën planifikimin për staf akademik bazuar në nevojën dhe mbingarkesën e stafit aktual, dhe kjo kërkesë kalohet për miratim tek Rektori i USH, pasi është miratuar nga Dekani i FE. Pasi kërkesa miratohet, nga Fakulteti ajo publikohet në faqen e internetit të institucionit. Çdo kandidaturë për pozicionet e hapura vlerësohet nga një Komision ad-hoc, i cili përbëhet nga drejtues të Rektoratit, fakultetit dhe departamentit të gjithë me gradën “Profesor”. Komisionet propozohen nga shefi i departamentit dhe miratohen nga dekani i fakultetit. Në to marrin pjesë stafi më i kualifikuar dhe me eksperiencë më të gjatë në fakultet. Ky komision kryesohet nga përgjegjësi i departamentit.</p> <p><i>Dokumenti 1. Statuti i USH, Neni 43, Punësimi i Personelit Akademik Dokument 11-XI. RREGULLORE E PUNESIMIT</i></p>
<p><b>Kriteri 5.</b> Institucioni siguron dhe garanton angazhimin e personelit ndihmës akademik të përshtatshëm dhe të mjaftueshëm për realizimin</p>	<p>Për programin e studimit AB, departamenti angazhon staf ndihmës për menaxhimin e sallave kompjuterike. Nga vizita në IAL u evidentuan dy laboratore me poste kompjuterike (25 secila) të realizuara me ndihmën e projekteve të cilat janë në dispozicion të studentëve dhe stafit të programit të studimit.</p>

<p>e orëve laboratorike dhe për mirëmbajtjen e laboratorëve e mjediseve të tjera mësimore, sipas natyrës specifike të programit të studimit.</p>	<p>Stafi I angazhuar ka kualifikimin e nevojshme për vendin e punës dhe wshtwë në dispozicion tw nevojave të studentëve.</p> <p><i>Dokument 1.23 Struktura Organizative FE</i></p> <p><i>Dokument 4. RVB Bachelor AB 2020-2023 e skanuar</i></p>
<p><b>Kriteri 6.</b> Institucioni mbledh, ruan dhe përditëson çdo vit akademik të dhënat e personelit të angazhuar në programin e studimit, në përputhje me legjislacionin në fuqi për mbrojtjen e të dhënave personale. Këto të dhëna përfshijnë anëtarët e personelit akademik të përfshirë në program dhe të personit përgjegjës për organizimin e programit të studimit, angazhimin e çdo anëtari në çdo semestër dhe vit akademik, si dhe atë të personelit ndihmës dhe administrativ.</p>	<p>Sipas organigramës së fundit të UNISHK të paraqitur në listën e dokumentacionit, Burimet njerëzore janë të vendosur nën Drejtorinë Juridike dhe të Burimeve Njerëzore. Kjo drejtori përbëhet nga tre sektorë: Sektori Juridik, Sektori i protokoll/arkivës i cili përbëhet nga një Specialist protokolli, një Specialist arkive. Ndërsa, Sektori Burimeve Njerëzore përbëhet nga një përgjegjës dhe një specialist, në këtë sektor punon gjithashtu dhe një nëpunës informacioni. Sektori i Burimeve Njerëzore dhe Protokoll-Arkivës funksionojnë në nivel IAL-je. Zyra e Burimeve njerëzore, mbledh, ruan dhe përditëson të dhënat e personelit akademik dhe ndihmës akademik pranë UNISHK. Nga intervistimi i personelit të Degës së Burimeve njerëzore por edhe nga dokumentacioni i vendosur në dispozicion, kjo zyrë është përgjegjëse për të ruajtur të gjithë dokumentacionin procedural lidhur me stafin që angazhohet në fakultet, ruajtjen dhe përditësimin në çdo vit akademik të të dhënave të personelit efektiv dhe atij me kontratë</p> <p>Kjo zyrë ka ndjekur procedurat për rekrutimin e personelit, ku kriteret i përcaktonte njësia bazë përkatëse, në vijim pritëshin aplikimet, kontrolloheshin nga personeli përgjegjës, dhe procedoheshin për intervistim (<i>Takimi me specialistin e Burimeve Njerëzore</i>). Zyra e personelit ishte pjesë e të gjitha hallkave të procesit duke siguruar transparencën dhe përmbushjen e kërkesave ligjore dhe institucionale (<i>Dokument 40. XL. RREGULLORE E ADMINISTRATES USH Kreu III, Struktura dhe Organigrama, Neni 23-24-25</i>). Nga investigimi i dy dosjeve të rastësishme (një PAE dhe një PAK) nuk u vërejtën mangësi në dokumentacion.</p> <p><i>(Dokumenti 1. Statuti i USH, Neni 43, Punësimi i Personelit Akademik, (Dokument 40. XL. RREGULLORE E ADMINISTRATES USH Kreu III, Struktura dhe Organigrama, Neni 23-24-25).</i></p> <p><i>Dokumenti 37-XXXVII. ORGANIKA USH</i></p> <p><i>Dokument 40. XL. RREGULLORE E ADMINISTRATES USH Kreu III, Struktura dhe Organigrama</i></p>
<p><b>Kriteri 7.</b> Institucioni, në marrëveshje e bashkëpunim</p>	<p>UNISHK-FE-DAB ka vendosur marrëveshje e bashkëpunimi me institucione të arsimit të lartë, si dhe përfaqësues të biznesit</p>

<p>me institucione të tjera të arsimit të lartë, përfaqësues biznesi e kompani, vë në dispozicion personelin e mjaftueshëm, të duhur e të kualifikuar për instruktimin, udhëheqjen dhe mbikëqyrjen e studentëve në praktikën profesionale, punimin e diplomës dhe veprimtari të tjera specifike sipas natyrës së programit të studimit.</p>	<p>etj. Përsa i përket tutorëve për mbikëqyrjen, udhëheqjen dhe keshillimin e studentëve në praktikën profesionale, departamenti i Administrim-Biznesit vë në dispozicion pedagogë, të brendshëm apo jashtëm, me ekspertizën përkatëse për t'i ardhur në ndihmë studentëve. Në paketën e dokumentave të praktikës evidentohet me vendosjen e pedagogëve në raportin e praktikës i hartuar nga studenti në përfundim të saj. Po kështu IAL ka vënë në dispozicion edhe një vlerësim të udhëheqësit të praktikantit në institucion.</p> <p><i>Dokument 3.29 Marreveshje bashkepunimi me kompani IT</i>  <i>Dokument Marreveshje FE + FAMIKO</i>  <i>Dokument Marreveshje Fe + GO2.</i>  <i>Dokument Marreveshje Fe + RTM</i>  <i>Dokument Marreveshje Fe+AKPA</i>  <i>Dokument Marreveshje midis FE+palet e interesit</i>  <i>Dokument Marreveshje nder instuticionale bashkepunimi</i>  <i>Dokument Marreveshjet me institucionet</i>  <i>Dokument 1.19.1 Hapje e sezonit te praktikës per Bachelor &amp; Mastera ne A-B, 2020 )</i>  <i>Dokument 2.9 Shembull Praktika Mesimore viti 2022</i>  <i>Dokument 2.22 Shembull Student e punesuar pas praktikës A-B</i>  <i>Dokument Kerkese per realizimin e praktikës mesimore</i>  <i>Dokument Kerkese per zhvillimin e praktikës drejtuar Melgushi SHPK</i>  <i>Dokument Reference per praktiken</i>  <i>Dokument Shembull praktike E.Talani</i></p>
<p><b>Kriter 8.</b> Personeli mbikëqyrës në ambientin pritis që angazhohet në realizimin e praktikave profesionale në bazë të marrëveshjeve, duhet të ndihmojë studentët në përmbushjen e detyrimeve /raportin përfundimtar të praktikës si dhe të marrë pjesë në procesin e vlerësimit të tyre për praktikën profesionale.</p>	<p>Marrëveshja me punëdhënësit pranë të cilëve studenti ndjek praktikën, parashikon që punëdhënësi të bëjë një vlerësim të ndjekjes dhe angazhimit së studentit në aktivitetet operacionale të biznesit. Ai vlerëson nëse studenti ka përmbushur objektivat e synuar gjatë periudhës së praktikës mësimore. Vlerësimi i studentit gjatë praktikës është objekt analize edhe nga pedagogët përgjegjës të caktuar nga departamenti. Në fund të praktikës profesionale, studenti përgatit një raport ku paraqet arritjet dhe njohuritë e fituara gjatë praktikës. Në paketën e dokumentave të praktikës evidentohet me vendosjen e pedagogëve në raportin e praktikës i hartuar nga studenti në</p>



	<p>përfundim të saj. Po kështu IAL ka vënë në dispozicion edhe një vlerësim të udhëheqësit të praktikantit në institucion.</p> <p><i>Dokument 1.19.1 Hapje e sezonit te praktikës per Bachelor &amp; Mastera ne A-B, 2020 )</i></p> <p><i>Dokument 2.9 Shembull Praktika Mesimore viti 2022</i></p> <p><i>Dokument 2.22 Shembull Student e punesuar pas praktikës A-B</i></p> <p><i>Dokument Kerkese per realizimin e praktikës mesimore</i></p> <p><i>Dokument Kerkese per zhvillimin e praktikës drejtuar Melgushi SHPK</i></p> <p><i>Dokument Reference per praktiken</i></p> <p><i>Dokument Shembull praktike E. Talani</i></p>			
<b>Konkluzione</b>	<p><i>GVJ vlerëson se personeli akademik që mbulon programin e studimit, përmbush standardet sasiore dhe ka kualifikimin e duhur e të posaçëm akademik në përputhje me fushën e programit për garantimin e standardeve të mësimdhënies të programit të studimit. Ky vlerësim është bazuar në një sërë indikatorësh të evidentuar si sa i përket mbulimit PAE/PAK por edhe indikatorët cilësorë të analizuar mbi bazën e CV dhe angazhimit të stafit në aktivitete përpos mësimdhënies.</i></p>			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>	<b>X</b>

#### Standardi IV.2

**Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion mjedise mësimore dhe infrastrukturën e përshtatshme për realizimin e procesit mësimdhënës të programit të studimit dhe për formimin praktik, të posaçme sipas natyrës dhe fushës së programit të studimit.**

<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<p><b>Kriteri 1.</b> Institucioni siguron mjediset e mjaftueshme dhe të përshtatshme për zhvillimin e veprimtarisë mësimore, në varësi të numrit të studentëve, grupeve mësimore, në përputhje me natyrën specifike të programit të studimit dhe moduleve përkatëse.</p>	<p>Referuar vizitës në institucion dhe të dhënave në sistemin AMS për infrastrukturën e UNISHK-FE, GVJ konstaton se institucioni disponon salla leksionesh dhe auditorë për seminare. Sallat e leksioneve dhe të seminareve janë të pajisur me kompjutera e projektorë. Programi i studimit disponon për zhvillimin normal të tij, tre salla leksionesh me sipërfaqje 125.2m<sup>2</sup> me kapacitet total 210 studentë. Ndërkohë, IAL disponon 14 klasa për zhvillimin e seminareve me një sipërfaqje totale 865.2 m<sup>2</sup>. Kapaciteti në numër studentësh i klasave të seminareve është si vijon, 10 klasa me nga 24 studentë, 5 klasa</p>



	<p>me nga 36 studentë. FE disponon dhe një sallë konferencash me sipërfaqje 260m<sup>2</sup></p> <p>Zyrat që kryejnë funksionet mbështetëse, të tilla si: Burimet Njerezore, Financa, Biblioteka, etj janë të akomoduar në ambjentet e tyre përkatëse të pajisura me infrastrukturën e nevojshme për një funksionim normal të aktiviteteve të tyre.</p> <p><i>Dokument 3.5.1. Informacion Infrastruktura dhe Ambjentet</i></p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Mjediset mësimore si klasa, laboratorë, studio e mjedise të tjera, janë të pajisura me mjete elektronike dhe të teknologjisë së informacionit, që garantojnë realizimin e procesit mësimor teorik e praktik, përmes përdorimit të metodologjive e teknologjive bashkëkohore të mësimdhënies-mësimnxënies.</p>	<p>Në ambjentet e FE ndodhen dy 2 laboratorë informatike me 25 poste secili. Këto laboratorë përdoren në aplikimin praktik të metodave kërkimore dhe programeve informative të kontabilitetit. Në këto laboratore janë të instaluar programet SPSS dhe ALFA, në mënyrë që studentët t'i aplikojnë direkt njohuritë teorike të marra në orët përkatëse mësimore.</p> <p><i>GVJ rekomandon pajisjen me softëare të tjerë më të përditësuar duke pasur parasysh evolucionin e teknologjisë si dhe tematikat e reja të studimit që lidhen me Inteligjencën artificiale të paraqitura më sipër.</i></p> <p><i>Dokument 3.2 .Godina dhe lab (photo 1 dhe 2)</i></p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Laboratorët, studiot, atelietë apo mjediset e tjera, sipas natyrës specifike të programit, përmbajnë aparaturat dhe mjetet e nevojshme e të përshtatshme për plotësimin e kërkesave të moduleve, aftësimin teorik e praktik dhe të objektivave formues të programit të studimit në tërësi.</p>	<p>Nga takimi me stafin e angazhuar në programin e studimit por edhe vizita në IAL, u evidentua që laboratorët janë të pajisur me programet e nevojshme për arritjen e objektivave mësimorë të studentëve. Por si u theksua dhe më sipër <i>GVJ rekomandon pajisjen me softëare të tjerë më të përditësuar duke pasur parasysh evolucionin e teknologjisë si dhe tematikat e reja të studimit që lidhen me Inteligjencën artificiale dhe ndryshimet e fundit në teknologjitë e analizës së biznesit.</i></p> <p><i>Dokument 3.2 .Godina dhe lab (photo 1 dhe 2)</i></p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Institucioni i arsimit të lartë siguron së paku një laborator të teknologjisë së informacionit, të pajisur me programe profesionale sipas natyrës së programit të studimit që ofron.</p>	<p>Në ambjentet e FE ku zhvillohet mësimi për programin e studimit në ciklin e parë në Administrim Biznes ndodhen dy 2 laboratorë informatike me 25 poste secili. Këto laboratorë përdoren për aplikimin praktik të metodave kërkimore për nevojat e programit të studimit. GVJ vlerëson që IAL ofron për programin e studimit mjaftueshëm kapacitete laboratorike për arritjen e objektivave të tij dhe pse ka nevojë për një përditësim të softeve të përdorura.</p> <p><i>Dokument 3.2 .Godina dhe lab (photo 1 dhe 2)</i></p>
<p><b>Konkluzione</b></p>	<p><i>GVJ vlerëson që UNISHK-FE ka vënë në dispozicion mjedise mësimore dhe infrastrukturën e përshtatshme për realizimin e</i></p>

	<i>procesit mësimdhënës të programit të studimit dhe për formimin praktik dhe rekomandon përditësimin me softëare të fundit në analizat e nevojitura për biznesin</i>		
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
			<b>X</b>

### Standardi IV.3

**IV.3 Programi i studimit duhet të përmbajë literaturën e nevojshme dhe të përditësuar në mbështetje të mësimdhënies dhe mjediset mbështetëse të mësimnxënies, (bibliotekën, mjedise të posaçme).**

<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<p><b>Kriteri 1.</b> Literatura bazë dhe ndihmëse e vënë në dispozicion të studentëve në gjuhën e programit të studimit (fizike dhe digjitale) garanton marrjen e dijeve dhe njohurive të nevojshme, të parashikuara në programin e studimit.</p>	<p>GVJ pasi vlerësoi syllabuset dhe kreu vizitën në IAL evidentoi dy elemente:</p> <p>Së pari 1. Literatura bazë dhe ndihmëse e vënë në dispozicion të studentëve në gjuhën e programit të studimit (fizike dhe digjitale) garanton marrjen e dijeve dhe njohurive të nevojshme, të parashikuara në programin e studimit por ajo nuk është në të gjitha raste e 5 viteve të fundit;</p> <p>Së dyti, IAL është pjesë e U.Librari.Rash (<a href="https://ulibrary.rash.al/">https://ulibrary.rash.al/</a>) si dhe ka një bibliotekë më një numër të konsiderueshëm numrash që lidhen direkt me programin e studimit në fjalë <a href="http://bush.unishk.edu.al/">http://bush.unishk.edu.al/</a> . Pra IAL disponon të gjitha mundësitë për të ofruar literaturën e nevojshme që mbështet arritjen e objektivave të programit të studimit.</p> <p><i>Dokument Fondi i librave ekonomik ne BUSH - azhornimi nga Albana.</i></p> <p><i>Dokument Fondi i librave ne BUSH e perditësuar</i></p> <p><i>Dokument Librat e dhuruara nga Sandhill Community College</i></p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Njësia përgjegjëse duhet të raportojë përditësimet të literaturës me botime të viteve të fundit.</p>	<p>GVJ vlerëson se njësia bazë paraqet nëpërmjet raportimit të saj në RVB së Syllabuset (programet e lëndëve) përditësohen çdo vit duke u bazuar në literaturë të detyruar dhe ndihmëse të viteve të fundit. Megjithatë kjo nuk evidentohet, pasi si theksua më sipër, <u><i>në shumicën e rasteve syllabuset duhet të rifreskojnë literaturën.</i></u> GVJ është gjithashtu e të njëjti mendim se lidhjet akademike me pedagogë të universitetve të tjera si dhe pjesëmarrja aktive e stafit në projekte Capacity Building në Universitet bëjnë të mundur pajisjen me libra të formatit hard-</p>

	<p>copy dhe online version të tyre. Përveç kësaj gjatë takimit me stafin u sugjerua që stafi të anëtarësohet në shtëpi botuese të njohura si PEARSON dhe MC GrawHill sepse këto të fundit ofrojnë literaturën më të fundit që lidhet me Administrimin e Biznesit (Takimi me stafin).</p> <p>Syllabuset e lëndëve</p> <p><i>Dokument Viti II - 8. SID.</i></p> <p><i>Dokument Viti III - 1.1 Tregj financ.</i></p> <p><i>Dokument Viti III - 1.3 Ekonomiks i treg te punes.</i></p> <p><i>Dokument Viti III - 4. HSHM.</i></p> <p><i>Dokument Viti III - 5. Drejtim operac.</i></p> <p><i>Dokument Viti III - 6. Menaxh strat.</i></p> <p><i>Dokument Viti III - 7. Biznes Nderkombetar.</i></p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Institucioni vë në dispozicion të studentëve bibliotekën mësimore, duke garantuar mundësinë e shfrytëzimit në mënyrë të barabartë nga studentët e programit të studimit.</p>	<p>Institucioni vë në dispozicion të studentëve bibliotekën mësimore, duke garantuar mundësinë e shfrytëzimit në mënyrë të barabartë nga studentët e programit të studimit. Ajo funksionon nëpërputhje me Ligjin Nr. 8576, datë 03.02.2000, Neni 30 “Për bibliotekat në Republikën e Shqipërisë”. Ajo kryen dixhitalizimin e skedarëve dhe ka në fondin e saj rreth 111.000 libra në gjuhën shqipe dhe të huaj, në formatin letër dhe elektronik. Godina e bibliotekës ka në përbërjen e saj edhe sallën e konferencave “Hoeflechner”, me një kapacitet 120 vende, e cila mundëson zhvillimin e një sërë aktiviteteve të karakterit akademik, mësimdhënës apo promovues. Gjithashtu, ofron mundësi kërkimi të informacionit on-line, në sallën e leximit, mundësi shfletimi të literaturës elektronike, pranë kompjuterave të sallës, si edhe lehtësi në kërkimin bibliografik të informacionit. Biblioteka ofron për përdoruesit e saj një sërë shërbimesh si: shërbimin e informacionit dhe të huazimit, vë në dispozicion të tyre mediatekën, me 26 vende multimedia, si dhe tri salla leximi me 300 vende leximi në total.</p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Biblioteka duhet të jetë e pajisur me fond fizik, si: tekste mësimore bazë, literaturë ndihmëse, e mjaftueshme në gjuhën shqipe dhe të huaja, libra apo revista shkencore të nevojshme, të mjaftueshme dhe e përshtatshme për mbulimin e të gjitha moduleve e veprimtarive mësimore sipas natyrës e</p>	<p>GVJ e vlerëson Bibliotekën e USH si një nga elementët më të fortë të këtij institucioni. Qasja e hapur e bibliotekës si një qëndër funksionale është karakteristikë e trashëgimisë qytetare dhe kapitalit social të këtij qyteti të dallueshëm në nivel kombëtar. GVJ e vlerëson Bibliotekën e USH si një best practice për t’u ndjekur edhe nga IAL-të e tjera në vend (Vizita e GVJ). Biblioteka është e pajisur me fond fizik, si: tekste mësimore bazë, literaturë ndihmëse, në gjuhën shqipe dhe të huaj, libra apo revista shkencore të nevojshme. Këto info gjenden edhe në websiten e Bibliotekës si dhe vihet re numri i konsiderueshëm I aktiviteteve me ndikim në komunitet.</p>

<p>specifikës së programit të studimit.</p>	<p><i>Vizita e GVJ në IAL</i></p>
<p><b>Kriteri 5.</b> Institucioni duhet të krijojë kushte për shfrytëzim të barabartë e pa pagesë për studentët në bibliotekat online të fushës së programit të studimit.</p>	<p>Studentët kanë akses të plotë në shfrytëzimin e kapaciteteve të bibliotekës, pa pagesë duke ofruar edhe platforma online. Biblioteka u ofron shërbim pedagogëve dhe studentëve përmes sportelit të huazimit, sportelit të informacionit, mediatekës, e cila është e pajisur me 30 vende multimedia (kompjuterat e kësaj salle janë dhuratë e Qeverisë Austriake dhe e Universitetit të Firences (përmes projektit Tempus Phare) si dhe tri sallave të leximit afërsisht me 300 vende leximi ku lexuesit e studiuesit mund të lexojnë e shfletojnë literaturë në qetësi të plotë. <a href="http://bush.unishk.edu.al/sherbimet/">http://bush.unishk.edu.al/sherbimet/</a></p> <p><i>(Vizita e GVJ në IAL , RVB dhe konsultimi i website)</i></p>
<p><b>Kriteri 6.</b> Biblioteka duhet të jetë e pajisur me programe kompjuterike dhe pajisje të tjera teknike, që mundësojnë shfrytëzimin pa kufizim për të gjithë studentët.</p>	<p>Nga vizita e GVJ në Bibliotekë dhe biseda me stafin e Bibliotekës, orari i shfrytëzimit të bibliotekës është i përshtatshëm për studentët në përputhje me orarin e tyre të mësimit. Studentet mund të aksesojnë online çdo kohë në platformat:</p> <p><a href="http://bush.unishk.edu.al/sherbimet/">http://bush.unishk.edu.al/sherbimet/</a></p> <p><a href="https://ulibrary.rash.al/">https://ulibrary.rash.al/</a></p> <p><a href="http://bush.unishk.edu.al/instrumente/kataloge-online/">http://bush.unishk.edu.al/instrumente/kataloge-online/</a></p>
<p><b>Kriteri 7.</b> Biblioteka duhet të vihet në dispozicion të studentëve në orare shërbimi që janë në përshtatje me oraret e zhvillimit të procesit mësimor dhe përtej tyre, në përgjigje edhe të nevojave, numrit të studentëve dhe kapacitetit të saj.</p>	<p>Orari i punës në bibliotekë shpallet në mjediset e institucionit dhe në Web-in e universitetit, nga e hëna në të premte: 08.00-19.00, ndërsa të shtunën 08.00-13.00. Çdo student/pedagog ka të drejtën e anëtarësimit falas në bibliotekë. Studenti disponon një kartelë regjistrimi me të dhënat personale dhe pajiset me librezë anëtarësie. Ai ka të drejtë të përdorë kompjuterat e sallave për përdorimin e katalogut elektronik. Kapaciteti i stafit të bibliotekës është i tillë që përballon nevojat e studentëve për shërbim, apo edhe shfrytëzim të mjediseve për punë në grup apo prezantime. Numri i punonjësve të bibliotekës është 13 anëtarë si përgjegjës, klasifikator, bibliograf, bibliotekar.</p> <p><i>Dokument Raporti i Vlerësimit të Brendshëm</i></p> <p><i>Vizita e GVJ në IAL , RVB dhe konsultimi i website</i></p>
<p><b>Kriteri 8.</b> Biblioteka dhe njësitë përgjegjëse të programit ndjekin dhe raportojnë për cilësinë e fondit fizik të bibliotekës dhe fondit online (titujt kryesorë të pranishëm në shërbim të</p>	<p>Përpos burimeve fizike, biblioteka ofron dhe Burime ndërkombëtare elektronike me tekst të plotë për stafin e pedagogëve, studentëve dhe përdoruesve të tjerë të BUSH Biblioteka Universitare Shkencore përmes projektit ERA 2012 (Elektronik Resources for Albania) siguron akses pa pagesë në burimet ndërkombëtare elektronike me tekst të plotë nga:</p>



programit), përditësimin, shkallën e shfrytëzimit të fondit fizik dhe fondit online nga personeli akademik dhe studentët e programit, shfrytëzimi i sallave të studimit, duke nxjerrë në pah sa të efektshme kanë qenë përpjekjet për pasurimin fondit fizik dhe atij online, cilat janë kërkesat për tituj, por edhe për performancën e personelit akademik.

BioOne Akses në baza të dhënash me tekst të plotë nga studime shkencore aktuale në biologji, ekologji dhe shkencat e mjedisit. Përfshin 71 revista shkencore me faktor të lartë ndikimi, botuar nga 129 shtëpi botuese jofitimprurëse.

Cambridge Journals Online Akses në një koleksion shumëdisiplinor të 280 revistave kryesore që mbulojnë tema që përfshijnë shkencën dhe teknologjinë, mjekësinë dhe shkencat humanitare e sociale.

ebrary Academic Complete Akses në një koleksion të plotë me mbi 70,000 libra elektronikë që mbulojnë një gamë të gjerë të fushave të studimit.

EBSCO Academic Search Complete Akses në tekst të plotë të një koleksioni shumëdisiplinor me mbi 9,700 revista, që përfshijnë 7,800 revista të recensionuara. Janë të disponueshëm skedarë të mëparshëm në formatin pdf të mbi 100 revistave që nga viti 1887 si edhe janë siguruar referenca të cituara dhe të kërkueshme rreth 1,500 tituj.

Emerald Engineering eJournal Collection Akses në mbi 10,000 artikuj nga 19 revista kryesore ndërkombëtare në inxhinieri, shkencën e materialeve dhe teknologji.

Emerald Management eJournal Collection Akses në 100,000 artikuj të recensionuar, me cilësi të lartë nga mbi 250 revista prestigjioze të fokusuara në një gamë të gjerë të fushave të studimit duke përfshirë studime mbi biznesin dhe menaxhimin, bibliotekat dhe informacionin.

OECD-iLibrary Akses në një bibliotekë të integruar online të librave, revistave, dokumenteve dhe statistikave që përfshijnë një hapësirë të plotë të fushave të studimit. Këtu gjenden mbi 5 000 libra, 500 numra revistash, 2 500 dokumente pune, 2 200 përmbledhje shumëgjuhëshe, 22 baza të dhënash statistikore dhe 5 000 tabela në formatin excel.

<http://bush.unishk.edu.al/instrumente/projekti-era-2012/>

**Konkluzione**

*GVJ vlerëson që IAL ka të gjitha kapacitetet për të ofruar literaturë fizike dhe online për nevojat e programit të studimit. Biblioteka ofron një shembull për t'u ndjekur. Ndërkohë, pedagogët e lëndëve duhet të përditësojnë literaturën në syllabuset përkatëse.*

**Shkalla e përmbushjes së standardit**

Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
		X

*Ercol*

*[Signature]*



**Standardi IV.4**

**Institucioni i arsimit të lartë disponon një sistem të brendshëm të menaxhimit institucional dhe e vë atë në dispozicion të administrimit, informimit dhe monitorimit të aktivitetit akademik, financiar e administrativ për programin e studimit.**

<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<p><b>Kriteri 1.</b> Institucioni disponon sistem të menaxhimit nëpërmjet të cilit administron të gjithë informacionin që lidhet me studentët dhe aktivitetin e tyre nga regjistrimi deri në diplomim në programin e studimit.</p>	<p>Institucioni disponon një sërë procedurash të cilat rregullojnë menaxhimin e informacionit që lidhet me studentin. Sekretaria mësimore disponon një sistem kompjuterik menaxhimi dhe administrimi të informacionit të studentit nga krijimi i kartelës dhe regjistrimi i parë deri në diplomim të tij (sekretaria online). Dokumentacioni themelor për studentët është: regjistri themeltar, që vërteton regjistrimin e studentit pajiset me numër matrikullimi, regjistri i arritjeve akademike të studentëve si dhe regjistri i lëshimit të diplomave. Këto regjistra pas diplomimit të studentëve arkivohen në arkivën e UNISHK në formë hardcopy dhe elektronike. Gjatë vizitës në institucion, GVJ verifikoi mbajtjen e regjistrave manual nga sekretaria mësimore në lidhje me studentët e programit. UNISHK ofron faqen elektronike online <a href="https://unishk.edu.al/">https://unishk.edu.al/</a> ku studentet vihen në dijeni të njoftimeve, eventeve, orareve, datave të provimeve, etj. Platforma elektronike <a href="https://ushk.pitagora.rash.al/login">https://ushk.pitagora.rash.al/login</a> krijon lehtësi në sistemin e menaxhimit të të dhënave për studentët dhe stafin mësimdhënës. Aty studentët kanë mundësi të regjistrojnë orarin, të shohin rezultatet etj. Pasi studenti fiton të drejtën e studimit, regjistrohet në sekretarinë mësimore dhe pajiset me nje llogari, e cila ka username dhe password personal për platformën online.</p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Sistemi i brendshëm i menaxhimit administron informacionin, dokumentacionin dhe aktivitetin e personelit akademik, personelit ndihmësakademik, personelit administrativ dhe partnerëve të angazhuar në realizimin e programit.</p> <p><b>Kriteri 3.</b> Sistemi i menaxhimit siguron akses të dedikuar në informacione e dokumente për të gjithë personelin dhe studentët e programit të studimit.</p>	<p>Si është përmendur edhe më lart, UNISHK ka adoptuar sistemin e menaxhimit të studentëve "ESSE3" më pas Pitagora që nga viti akademik 2013, i cili kryen funksionin në formë elektronike, krahas asaj të shkruar. Para këtij viti disponohet një regjistër i tillë vetëm në formë të shkruar. Platforma Pitagora për menaxhimin e studentëve, garanton një menaxhim efikas të të dhënave të studentit gjatë gjithë karrierës së tij dhe pas saj. Universiteti i Shkodrës disponon laboratorë të IT-së, Sektorin e Menaxhimit të Sistemit, serverat, telefoninë. USH publikon në faqen zyrtare të gjitha të dhënat statistikore për numrin e studentëve sipas programeve, ofertën akademike, ndërtimin dhe funksionimin e institucionit, si dhe statutin dhe rregulloret e funksionimit të tij. (<a href="http://www.unishk.edu.al">www.unishk.edu.al</a>) (<i>Dokument Strategjia e Zhvillimit USH 2022-2026, .</i>)</p>

<p><b>Kriteri 4.</b> Sistemi i menaxhimit ka të integruar platforma dhe module që mundësojnë forma të komunikimit interaktiv dhe shkëmbimit të informacionit ndërmjet personelit akademik dhe studentëve.</p>	<p>Në USH përdoret nga i gjithë stafi akademik aplikacioni SMAK si një softëare për menaxhimin akademik, i ndertuar si rezultat i domosdoshëm për informatizimin e menaxhimit akademik. Softi është i bazuar në teknologjinë web dhe si i tillë është i aksesueshëm nga çdo kompjuter i lidhur në internet. Të dhënat janë të ruajtura në një bazë të dhënash qendrore në një server, i cili ndodhet në ambientet e AKSHI-1. Softi përdoret nga disa kategori përdoruesish:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Dekanët e fakulteteve</li> <li>• Drejtorët e departamenteve</li> <li>• Drejtorja Juridike dhe e Burimeve njerëzore</li> <li>• Drejtorja ekonomike</li> <li>• Drejtorja Kurikulave, Kerkimit Shkencor dhe standardeve</li> <li>• Drejtorja IT</li> </ul> <p>Logimi dhe puna në soft mundësohet vetëm nëpërmjet një emri përdoruesi dhe fjalëkalimi. Drejtorja e Informacionit dhe Teknologjisë në USH, bashkërendon veprimtaritë në fushën e teknologjisë së informacionit, duke pasqyruar oraret e mësimit, datat e provimeve, strukturën organizative, organigramën, detyrimet e studentit, tarifrat e studimit, vlerësimet e studenteve, veprimtarinë akademike dhe sociale të USH-së (<a href="http://www.unishk.edu.al">www.unishk.edu.al</a>).</p> <p><i>Dokument 24 Platforma SMAK</i></p> <p><i>Dokument 1.1 Strategjia e Zhvillimit SHU 2022-2026, Objektiv specifik 7 Shwrbimet Digjitale</i></p> <p><i>Dokument 4 RVB Bachelor AB 2020-2023</i></p>
<p><b>Kriteri 5.</b> Sistemi i menaxhimit garanton monitorim në kohë reale të aktivitetit akademik e administrativ dhe mundëson raportime individuale dhe të dhëna në kohë reale për organet dhe autoritetet drejtuese.</p>	<p>Monitorimi në kohë reale i aktivitetit të personelit akademik dhe ndihmës akademik, në Departamentin e Administrim Biznesi, bëhet nga përgjegjësi i departamentit. Raportet e monitorimit në lidhje me orarin e mësimit, ngarkesën mësimore, etikën e komunikimit etj, përcillen në fakultet. Një praktikë e monitorimit të aktivitetit akademik është krijuar me raportimin vjetër të analizës mësimore kërkimore. Në këto të fundit monitorohen të gjitha aktivitetet që lidhen me programin e studimit nga këndvështrimi sasior dhe cilësor. GVJ e vlerëson këtë praktikë dhe informacionet shteruese që gjenden në të.</p> <p><i>Dokument: Analiza e punes shkencore e Ad-Biz, 19-20</i></p> <p><i>Dokument: Analiza e punes shkencore e Ad-Biz, 21-22</i></p> <p><i>Dokument: Analiza e punes shkencore 2019-2020 e FE</i></p>

<p><b>Kriteri 6.</b> Informacionet që lidhen me programin e studimit, personelin akademik, aktivitetet e ndryshme, publikohen në faqen e internetit në të paktën dy gjuhë, ku njëra prej tyre është gjuha shqipe.</p>	<p>Informacionet që lidhen me programet e studimit publikohen në faqen e internetit të USH, si dhe në rrjetet sociale zyrtare të USH. Gjithashtu, edhe aktivitetet që realizohen publikohen në faqen e internetit. Nga konstatimi i GVJ faqja Web zyrtare e UNISHK (<a href="https://unishk.edu.al/">https://unishk.edu.al/</a>) si edhe ajo e Fakultetit, ndër të tjera, përfshin informacion lidhur me programin dhe stafin dhe njoftime të ndryshme. Faqja Web është e ndërtuar në dy gjuhë: shqip dhe anglisht. Po kështu nga takimi me stafin e komunikimit u evidentua nevoja për më shumë komunikim në media sociale duke qënë se studentët potencialë gjenden pikërisht në këto outlets. Në takimin me stafin e kësaj drejtorie <u>GVJ sugjeroi edhe përmirësimet e duhura sa i përket content-it dhe llojit të mesazhit i cili paraqitet i vjetëruar.</u></p> <p>Fakulteti Ekonomik, UNISHK   Shkodër   Facebook.  <a href="https://al.linkedin.com/school/fakulteti-ekonomik-unishk/people">https://al.linkedin.com/school/fakulteti-ekonomik-unishk/people</a></p> <p>Dokument 4 RVB Bachelor AB 2020-2023  <a href="https://unishk.edu.al/">https://unishk.edu.al/</a></p>			
<p><b>Konkluzione</b></p>	<p>GVJ vlerëson që UNISHK disponon një sistem të brendshëm të menaxhimit institucional dhe e vë atë në dispozicion të administrimit, informimit dhe monitorimit të aktivitetit akademik, financiar e administrativ për programin e studimit, gjithashtu e ka si objektiv të strategjisë së zhvillimit përmirësimin e mëtejshëm të shërbimeve digjitale për të gjithë aktorët në ekosistemin e saj.</p>			
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>	<p>X</p>

<p><b>Standardi IV.5</b></p>	
<p><b>Institucioni i arsimit të lartë garanton financimin dhe mbështetjen financiare të nevojshme për realizimin e procesit mësimor-kërkimor, mbarëvajtjen e programit të studimit dhe mbështetjen e studentëve.</b></p>	
<p><b>Kriteret</b></p>	<p><b>Vlerësimi i ekspertëve</b></p>
<p><b>Kriteri 1.</b> Institucioni harton një raport financiar të kostove të njësisë bazë përgjegjëse për programin e studimit dhe planin për mbështetjen financiare të nevojshme për mbarëvajtjen</p>	<p>GVJ referuar RVB dhe dokumentacionit të vënë në dispozicion nga IAL, konstaton se Institucioni harton një raport financiar dhe planin për mbështetjen financiare konform legjislacionit në fuqi, që rregullon veprimtarinë e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë. Raporti financiar i hartuar nga Drejtoria e Financës detajohet dhe paraqitet me zërat e kostove</p>

<p>e programeve të studimit për të paktën një cikël të plotë studimi.</p>	<p>përkatëse për programet e cikleve të studimit Bachelor, Master Profesional dhe Master i Shkencave në rang fakulteti.</p> <p><i>Dokument 4 RVB Bachelor AB 2020-2023</i></p> <p><i>Dokument Rregullore e Administratës së Rektoratit 2023</i></p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Plani i financimit të njësisë bazë përgjegjëse për programin e studimit duhet të përmbajë financimin e burimeve njerëzore në shërbim të realizimit të programeve, shpenzimet operative për mirëmbajtjen e mjediseve dhe teknologjive mbështetëse të procesit mësimor, shpenzimet për bibliotekën dhe pasurimin e literaturës e aksesin në bibliotekat online, detyrimet financiare, grantet vendase apo të huaja të përfituara dhe kontratat e shërbimeve të lidhura në funksion të realizimit të programeve të studimit, projektet dhe zëra të tjerë.</p>	<p>GVJ referuar RVB dhe dokumentacionit të vënë në dispozicion nga Institucioni, konstaton se në planin financiar përfshihen:</p> <p>a) të ardhura: buxheti i shtetit, tarifat e shkollimit, tarifat e regjistrimit, të ardhura nga shërbime të ndryshme të kryera, donacione e burime të tjera etj;</p> <p>b) shpenzime: për pagat, shpenzime operative, sigurimin e cilësisë, pasurimin e bibliotekës etj;</p> <p>Të gjitha kategoritë e këtij kriteri janë të përfshira në këtë plan financiar</p> <p><i>Dokument 4 RVB Bachelor AB 2020-2023</i></p> <p><i>Dokument 27 Kuotat e Projekt Buxhetit</i></p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Institucioni kryen auditim periodik, vlerëson dhe dokumenton gjendjen e financimit dhe efektivitetin financiar të tij.</p>	<p>Institucioni, nëpërmjet Sektorit të Auditit të Brendshëm i cili është nën varësinë e Bordit të Administrimit të Institucionit, kryen audit të brendshëm të përvitshëm. Referuar RVB-së konstatohet se në mënyrë periodike Sektori i Auditit të Brendshëm pranë UNISHK, bën relacion mbi projekt buxhetin me qëllim që të kontrollojë mbarëvajtjen e programeve të studimit të të gjitha cikleve përgjatë kohës së shtrirjes së studimeve.</p> <p><i>Dokument 4 RVB Bachelor AB 2020-2023</i></p> <p><i>Dokument Rregullore e Administratës së Rektoratit 2023</i></p> <p><i>Dokument 3.37 Raport Auditimi model sekretaria</i></p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Institucioni raporton deri në nivelin e njësisë bazë përgjegjëse për programin e studimit mbi realizimin e buxhetit të miratuar të vitit paraardhës.</p>	<p>Institucioni harton raportin për tre vitet e kaluara për të evidentuar masën e realizimit të të ardhurave si dhe nivelin e shpenzimeve. Raporti financiar përmban informacion lidhur me tarifat e shkollimit dhe kontributet e tjera, si dhe ndarjen e burimeve financiare.</p> <p><i>Dokument 4 RVB Bachelor AB 2020-2023</i></p>



	<i>Dokument Rregullore e Administratës së Rektoratit 2023</i>			
<b>Kriteri 5.</b> Institucioni garanton qëndrueshmërinë financiare për zhvillimin e programeve të studimit të njësisë bazë dhe kapacitetet financiare të mjaftueshme për ecurinë normale të këtyre programeve. Në rastet e nevojave të përmirësimit të situatës financiare institucioni planifikon ndërhyrje të posaçme dhe diversifikimin eventual të financimit të programeve të studimeve.	<p>GVJ duke ju referuar RVB, evidenton se IAL dëshmon dhe garanton qëndrueshmërinë financiare përgjatë kohës së zhvillimit të programit të studimit dhe kjo duke ju referuar numrit në rritje të studentëve të regjistruar në programin e studimit AB (2020-2021 -86 studentë, për vitin 2021-2022, 101 studentë dhe për vitin 2022-2023, 104 studentë të regjistruar).</p> <p>Gjithashtu bazuar tek RVB, por edhe gjatë takimit që GVJ pati me Zv/Dekanan e Fakultetit Ekonomik, Institucioni dëshmon se ka kapacitete financiare të mjaftueshme. Dega e financës dhe buxhetit hartojnë relacionin për buxhetin afat-mesëm dhe afat-gjatë duke analizuar të gjithë programet e studimit. Në këtë mënyrë evidentohen problemet përkatëse dhe nevojat për investime dhe burimet e të ardhurave për realizimin e tyre.</p> <p><i>Dokument 18 Analiza financiare 2022</i> <i>Dokument 4 RVB Bachelor AB 2020-2023</i></p>			
<b>Konkluzione</b>	<i>GVJ vlereson se IAL-UNISHK garanton financimin dhe mbështetjen financiare të nevojshme për realizimin e procesit mësimor-kërkimor, mbarëvajtjen e programit të studimit dhe mbështetjen e studentëve, ecuria e qëndrueshme e studentëve të regjistruar në programin e studimit BA Administrim Biznes është një faktor i rëndësishëm që e mbështet realizimin e këtij kriteri.</i>			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>	
			<b>X</b>	

<b>Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës IV</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>	
			<b>X</b>	

## V. STUDENTËT DHE MBËSHTETJA E TYRE

### Standardi V.1

**Institucioni i arsimit të lartë harton, ndjek dhe zbaton politika dhe procedura për pranimin, përzgjedhjen, përparimin e studentëve, transferimin, njohjen, vlerësimin e dijeve dhe diplomimin në programin e studimit.**






Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p><b>Kriteri 1.</b> Institucioni harton dhe zbaton politika dhe procedura që mbulojnë ciklin e plotë akademik të studentëve nga hyrja në dalje, në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe aktet e veta rregullatore.</p> <p><b>Kriteri 2.</b> Politikat dhe procedurat nga hyrja në dalje garantojnë barazinë dhe të drejta të njëjta për të gjithë kandidatët për studentë dhe studentët e programit të studimit.</p>	<p>Programi i studimit BA në Administrim-Biznes 180 ECTS është konceptuar dhe zhvillon veprimtarinë e tij në përputhje të plotë me Ligjin e Arsimit të Lartë Nr 80/2015 dhe VKM Nr 41 dt 24.01.2018, për Elementët e Programit të Studimit të Ofruar nga ILA-të, si dhe një sërë dokumentash ligjorë dhe rregullatorë si:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Statuti UNISHK;</li> <li>- Rregullorja e Studimeve e UNISHK;</li> <li>- Rregullorja e FEUNISHK;</li> <li>- Rregullorja e Departamentit të Administrim Biznesit</li> <li>- Rregullorja e Programit të Studimit Bachelor në Administrim Biznes;</li> </ul> <p>Të gjitha këto akte mbulojnë të gjithë veprimtarinë e punës së njësisë kryesore dhe bazë nga hyrja e studentëve në programin BA, deri në diplomimin e tyre. Departamenti si rregull propozon tek Dekani kriteret e pranimit të studentëve në BA në AB, nisur nga kriteret ligjore, kritere shtesë nuk zbatohen.</p> <p>Studentët që nga momenti i hyrjes deri në dalje nga studimet gëzojnë të drejtën të trajtohen në mënyrë të njëjtë në të gjithë elementët dhe strukturat përgjegjëse të njësisë kryesore dhe bazë të programit BA në AB, të marrin pjesë në përputhje me Ligjin e Arsimit të Lartë, Statutin dhe Rregulloret në një sërë organesh kolegjiale nga Senati, në proceset e akreditimit përmes pjesëmarrjes në grupet e Vlerësimit të Brendshëm, në Këshillin e fakultetit, etj. Studentët janë pjesë e Bordit të Administrimit, gëzojnë të drejtën e votës në zgjedhjet për trupën drejtuese të departamenteve / fakulteteve dhe universitetit si dhe përzgjidhen përmes votës së shokëve të tyre në Këshillat Studentorë. Studentët gëzojnë gjithashtu të drejtën të përfitojnë bursa studimi, bursa Erasmus, të përfshihen në projekte, të marrin pjesë në aktivitete e seminare extracurriculare, etj.</p> <p><i>Dokumenti 146: VKM Nr 41, dt 24.01.2018, për Elementët e Programit të Studimit të Ofruar nga ILA-të</i></p> <p><i>Dokumenti 1.1. Statuti i UNISHK</i></p> <p><i>Dokumenti 2. II: Rregullore e studimit në UNISHK</i></p> <p><i>Dokumenti 1.a: Rregullore e Fakultetit</i></p> <p><i>Dokumenti 1.17: Rregullore e departamentit të AB</i></p> <p><i>Dokumenti 1.17: Rregullore e programit të studimit BA në AB</i></p>

**Kriteri 3.** Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kritere të veçanta për përzgjedhjen e kandidatëve për t'u pranuar në programin e studimeve. Institucioni bashkëpunon me strukturat e ngritura në zbatim të maturës shtetërore, sipas ligjit dhe udhëzimeve përkatëse. Kriteret parashikojnë edhe regjistrimin e studentëve të huaj.

**Kriteri 4.** Kriteret, procedurat e pranimit dhe përzgjedhjes së studentëve, përparimit përgjatë kursit të studimit, të transferimit, njohjes së studimeve të mëparshme ose të pjesshme, të vlerësimit të dijeve dhe të diplomimit janë lehtësisht të kuptueshme dhe të aksesueshme nga publiku.

**Kriteri 5.** Përpara fillimit të çdo viti akademik, institucioni informon publikun dhe të interesuarit në lidhje me kërkesat e kriteret e përgjithshme e të veçanta të programit të studimit.

Universiteti "Luigj Gurakuqi" i Shkodrës dhe Fakulteti Ekonomisë bëjnë të aksesueshme në faqet e tyre zyrtare në internet të gjithë informacionin që ndihmon të gjithë të interesuarit (aplikantët për studime dhe studentët aktuale) për të marrë vendime dhe kuptuar proceset. Krahas informacioneve që kanë të bëjnë me aspektet rregullatore të universitetit dhe fakultetit, që ndihmojnë studentët për të kuptuar gjithë procesin nga aplikimi, përzgjedhja, regjistrimi, transferimi dhe njohja e krediteve, diplomimi, në WWB gjenden programet e studimit, departamentet, stafi akademik dhe shumë informacione të tjera përfshirë dhe email e kontaktit të drejtuesve.

Në këtë link të WWB <https://unishk.edu.al/njoftime> studentët gjejnë të gjitha informacionet e nevojshme për jetën e tyre studentore, si dhe shumë nga procedurat, formularët për praktikën, diplomën dhe tarifat e shkollimit në linkun <https://unishk.edu.al/universiteti/tarifa-shkollimi>.

Programet e studimit i gjejnë në linkun pasues <https://unishk.edu.al/studimi-ne-unishk/cikli-i-pare-i-studimeve-bachelor/2021-2022>, në link tjetër silabuset <https://unishk.edu.al/studimi-ne-unishk/course-description>,

Dokumentat strategjike, ligjorë e rregullatorë i gjejnë në linkun <https://unishk.edu.al/universiteti/dokumentet/statuti-i-unishk-se>. Në lidhje me stafin e departamentit dhe fakultetit të interesuarit gjejnë të gjithë informacionin në linkun <https://unishk.edu.al/universiteti/fakultetet/fakulteti-ekonomik>.

Në orën e parë të mësimit të çdo lëndë apo moduli, qartësohen të gjithë elementët e vlerësimit të dijeve, ndërkohë sekretaria mësimore informon studentët për çështje procedurale. Ndërkohë përmes sistemit Pitagora të garantuar nga RASH, studentët kanë mundësi të informohen për ecurinë e tyre në procesin mësimor. Gjatë takimit në institucion me përfaqësuesit e njësisë së marketingut dhe PR, ato u shprehën se janë shumë aktivë në median sociale, duke informuar përmes disa postimeve në ditë, të cilat intensifikohen në periudhën e rekrutimit të studentëve të rinj. Një dokument tjetër i rëndësishëm për orientimin e kandidatëve që duan të studjojnë në UNISHK është Guida e Studentit. Gjithashtu, UNISHK bëhet pjesë çdo vit e Panairit "Work and Study", ndërkohë që FE organizon eventin "Mirësevjen maturant"

	<p><i>Ekspertët sugjerojnë gjatë takimeve në institucion, që për madhësinë dhe avantazhet që ende FE i ruan, të mendojnë për një zyrë të informimit dhe karrierës në fakultet si dhe zyrat në funksion të studentit (sekretaria përfshirë të vendosen në katin 1 apo të 2 të godinës së FE)</i></p> <p><i>Dokumenti 1.I. Statuti i UNISHK</i></p> <p><i>Dokumenti 2. II: Rregullore e studimit në UNISHK</i></p> <p><i>Dokumenti 1.a: Rregullore e Fakultetit</i></p> <p><i>Dokumenti 1.17: Rregullore e departamentit të AB</i></p> <p><i>Dokumenti 1.17: Rregullore e programit të studimit BA në AB</i></p> <p><i>Dokumenti 5.10: Guida e UNISHK</i></p> <p><i>Dokumenti 5.7: kuotat dhe kriteret e pranimit</i></p> <p><i>Dokumenti 5.12: Relacion për aktivitetin "Mirësevjen maturant"</i></p> <p><i>Dokumenti 5.13: Relacion Ditët e hapura ndër vite</i></p>
<p><b>Kriteri 6.</b> Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kriteret për përzgjedhjen e kandidatëve me aftësi të veçanta, të pakicave dhe shtresave të marginalizuara.</p> <p><b>Kriteri 7.</b> Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kriteret për përzgjedhjen e kandidatëve nga shtete të tjera.</p>	<p>Bazuar në udhëzimin Nr. 17 dt. 30.07.2019, si dhe në përvojën e krijuar në vite, departamenti përcakton kuotat për studentët me aftësi ndryshe, ata që vijnë nga pakicat dhe shtresat në vështirësi.</p> <p>Në lidhje me kriteret e pranimit të studentëve që vijnë nga shtresat vulnerabël të shoqërisë ato miratohen në Senat dhe më pas shkojnë për miratim të buxhetit që do vihet në dispozicion në Bordin e Administrimit Në përputhje me udhëzimet e MAS, por dhe traditën e krijuar me regjistrimet vit pas viti, departamenti vlerëson kuotat sipas kategorive të përcaktuara nga Matura Shtetërore, përfshirë dhe studentët që vijnë nga trojet shqiptarë, propozimet kalojnë në dekanat dhe miratohen nga senati akademik, për t'u përcjellë për fazën e fundit të miratimit tek Bordi Administrimit brnda IAL-së.</p> <p>Për tarifatat e shkollimit informacioni merret përmes linkut <a href="https://unishk.edu.al/universiteti/tarifa-shkollimi">https://unishk.edu.al/universiteti/tarifa-shkollimi</a>, ndërsa linku pasues shërben për informimin mbi bursat e akorduara nga UNISHK <a href="https://unishk.edu.al/universiteti/bursa">https://unishk.edu.al/universiteti/bursa</a>.</p> <p><i>Dokumenti 5.7: kuotat dhe kriteret e pranimit</i></p> <p><i>Dokumenti: Kuotat 22-23</i></p> <p><i>Dokumenti: Kuotat 23-24</i></p> <p><i>Dokumenti: kriteret e pranimit 22-23</i></p>

	<i>Dokumenti: Kriteret e pranimit 23-24</i>		
<b>Kriteri 8.</b> Institucioni harton politika të ndihmës/bursave për shtresa në nevojë dhe për të rritur cilësinë e pranimit në programe me përparësi për institucionin dhe për zhvillimin ekonomik të vendit.	<p>UNISHK në përputhje me udhëzimet që nxjerr çdo vit MAS në lidhje me pranimet në ciklin e parë të studimeve, si dhe dispozitat që burojnë nga Statuti përcakton dhe diapazonin e bursave për studentët ekselentë dhe ndihmës për studentët që vijnë nga shtresa të marxhinalizuara.</p> <p>Në faqen e internetit të UNISHK gjejmë formularin e aplikimit për bursë <a href="https://unishk.edu.al/Formular_aplikimi_Bursa_2022-2023.pdf">Formular aplikimi Bursa 2022-2023.pdf</a> (<a href="https://unishk.edu.al">unishk.edu.al</a>); siç shihet në formular janë 11 kriteret, nga fëmijet e prindërve që mbuloen nga ndihma sociale, jetimët, fëmijët e policëve të vrarë, studentët –prindër deri tek ekselentët. Me Urdhër të Administratorit ngrihet komisioni ad hoc i shqyrtimit dhe vlerësimit të aplikimeve për bursë dhe mbështetje, <a href="https://unishk.edu.al/urdher_nr_90_data_24.11.2022.pdf">urdher nr 90 data 24.11.2022.pdf</a> (<a href="https://unishk.edu.al">unishk.edu.al</a>)</p> <p>Vendimet e marra në lidhje bursat <a href="https://unishk.edu.al/universiteti/bursa">https://unishk.edu.al/universiteti/bursa</a>, sipas viteve akademike, publikohen në faqen e internetit.</p> <p><i>Dokumenti 1.1. Statuti i UNISHK</i></p>		
<b>Konkluzione</b>	<i>GVJ vlerëson që në lidhje me këtë standard, UNISHK vepron në përputhje me Ligjin e Arsimit të Lartë, dhe të gjitha VKM apo udhëzimet që vit pas viti përditësohen në përputhje me ndryshimet që bëhen në Maturën Shtetërore apo vendimeve në mbështetje të studentëve dhe shkollimit të tyre</i>		
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
			X

<b>Standardi V.2</b>	
<b>Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve të programit të studimit, informacion të plotë e të hollësishëm mbi përparimin akademik, njohjen, vlerësimin e dijeve deri në përfundim të studimeve dhe diplomimit në atë program.</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Institucioni vë në dispozicion informacion të plotë dhe të hollësishëm në lidhje me kriteret e procedurat e përparimit akademik të studentëve dhe	Në Rregulloren e UNISHK dhe në Rregulloren e Programit BA në AB pasqyrohen procedurat e përparimit akademik. Në nenin 22 të Rregullores së Universitetit përcaktohen elementët e vlerësimit të vazhduar të studentëve (20-40%) dhe pesha që zë provimi përfundimtar (60- 80%). Studenti është kalues nëse ai






<p>kalimit nga një vit akademik në tjetrin.</p> <p><b>Kriteri 3.</b> Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e vlerësimit të dijeve e aftësive të studentëve në programin e studimit.</p>	<p>ka mbledhur 45 pikë në vlerësimin e vazhduar dhe në provimin përfundimtar, sipas nenit 30 të Rregullores së Programit.</p> <p>Sezonet e provimit, sipas Nenit 31 të Rregullores së UNISHK janë në fund të semestrit të parë dhe të dytë, si dhe dy sezona riprovimi – sezoni vjeshtës në shtator dhe sezoni pranverës në Prill- Maj. Përmes sistemit Pitagora studentët informohen për ecurinë e tyre akademike, pas çdo sezoni provimi.</p> <p>Informimi studentëve për procedurat e përparimit akademik bëhet përmes disa formave: në klasë nga pedagogu në orën e parë të çdo lënde/moduli, në faqen e internetit ku gjen të gjitha rregulloret kryesore, përmes sekretarisë mësimore, medias sociale dhe faqes së internetit si dhe përmes sistemit të email të intranetit të UNISHK.</p> <p><i>Dokumenti 2. II: Rregullore e studimit në UNISHK</i>  <i>Dokumenti 1.17: Rregullore e programit të studimit BA në AB</i>  <i>Dokumenti Viti I, Viti II dhe Viti III: Silabuset sipas viteve dhe lëndëve</i></p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e njohjeve të kualifikimeve të mëparshme ose studimeve të pjesshme.</p>	<p>Një nga përfitimet më të rëndësishme të Procesit të Bolonjës, është mobiliteti studentëve brenda dhe jashtë vendit. UNISHK bazuar dhe në Ligjin Nr 80/2015 për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor, në Statutin e tij përkatësisht Neni 63 dhe 64 ka përcaktuar kriteret dhe procedurat e njohjes së krediteve dhe të transferimit të tyre nga një institucion i arsimit të lartë brenda dhe jashtë vendit.</p> <p>Në Rregulloren e Universitetit në nenin 20 të emërtuar “Transferimet” dhe në nenin 21 të emërtuar “Njohja e shlyerjes me ekuivalencë” përcaktohen dhe qartësohen: Ekuivalentimi; Lloji i transferimeve; Procedura e Kërkesës, Propozimi dhe Miratimi i Transferimit; Ekuivalentimi.</p> <p>Si rregull, Drejtuesi i departamentit përcakton komisionin e ekuivalentimit i cili shqyrton të gjitha kërkesat që vijnë qoftë për transferimet, programe të dytë studimi apo është një kërkesë ligjore në kuadër të njohjes së diplomave të huaja.</p> <p><i>Dokumenti 1.1. Statuti i UNISHK</i>  <i>Dokumenti 2. II: Rregullore e studimit në UNISHK</i>  <i>Dokumenti 1.17: Rregullore e programit të studimit BA në AB</i>  <i>Dokumenti 5.8: Ekuivalentime</i>  <i>Dokumenti 5.9: Ekuivalentime erasmus</i></p>

<p><b>Kriteri 4.</b> Institucioni i arsimit të lartë informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e punimit të diplomës dhe diplomimit në programin e studimit.</p>	<p>Bazuar në Statutin e UNISHK, Rregulloren e Universitetit, Rregulloren e Programit të Studimit përcaktohet procedura e realizimit të punimit të Diplomës dhe sezonet që student mund ta mbrojë atë. Si detyrim përmbyllës i programit mësimor - gjithsej 6 ECTS, alternativat janë përmes provimit përfundimtar dhe punimit të tezës së diplomës, kjo e fundit për studentët që kanë mesatare mbi 8. Për punimin e diplomës është miratuar një rregullore (udhëzues) dhe një format – template i tezës.</p> <p>Studenti ka të drejtë të propozojë udhëheqësin e tij, miratimi bëhet nga drejtuesi i departamentit. Vlerësimi i mikrotezës bëhet nga udhëheqësi dhe anëtarët e komisionit të diplomimit. Si rregull mbrotja e diplomës është e hapur dhe pas prezantimit anëtarët e Komisionit dhe të pranishëm të tjerë gëzojnë të drejtën e bërjes së pyetjeve. Si rregull, për studentët që bëjnë provim departamenti përgatiti një listë temash dhe pyetjesh përmes të cilave studentët përgatiten, Për të gjitha momentet kryesore të këtij detyrimi, studentët njoftohen në klasë, në rrjetet sociale dhe në faqen e internetit.</p> <p><i>Dokumenti 1.1. Statuti i UNISHK</i>  <i>Dokumenti 2. II: Rregullore e studimit në UNISHK</i>  <i>Dokumenti 1.17: Rregullore e programit të studimit BA në AB</i>  <i>Dokumenti 6.14: Udhëheqjet e diplomave 2022-2023</i>  <i>Dokumenti 3.30: Format teme dhe udhëzuesi diplomës</i>  <i>Dokumenti 3.31: Miratimi senatit për formatin e temës</i></p>
<p><b>Kriteri 5.</b> Përpara fillimit të çdo viti akademik dhe në mënyrë periodike, institucioni i arsimit të lartë publikon udhëzues të posaçëm dhe organizon takime të hapura për informimin e të interesuarve e studentëve të ardhshëm mbi programin e studimit.</p>	<p>Ka disa rrugë të informimit të aplikantëve për studimet BA në AB,:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- E para përmes WEB të UNISHK, medias sociale, bazuar në politika të caktuara të marketingut që universiteti ka dhe një plani të njësisë së marketingut dhe PR;</li> <li>- Së dyti, përmes Ditëve të hapura, pjesëmarrjes në Panairin “Work and Study”, eventit “Mirësevjen Maturant”;</li> <li>- Zyrës së Karrierës dhe Alumnit, e cila po strukturohet dhe ka marrë një vëmendje më të rritur në institucion pas pandemisë, por që duhet menduar si aktiviteti i saj të zhvillohet në FE;</li> <li>- Guidës së universitetit;</li> <li>- Word of mouth, takimeve me drejtues e pedagogë të fakultetit;</li> </ul>

	<p><i>Dokumenti 5.10 Guida për studentët</i></p> <p><i>Dokumenti 5.13 Relacion mbi ditet e hapura</i></p> <p><i>Dokumenti 5.12: Relacion mbi eventin "mirësevjen Maturant 2023"</i></p>			
<b>Konkluzione</b>	<p><i>GVJ vlerëson se UNISHK po intensivikon veprimtarinë e vet për të vënë në funksion të studentëve informacion mbi programin e studimit, përmes formave që sot aksesohen më shumë nga të rinjtë Gjithashtu dhe brenda FE janë ndërtuar mekanizmat që informacioni për çdo fazë të jetës akademike të shkojë në mënyrë sa më të shpejtë tek studentët. Media sociale, faqja e internetit dhe platforma Pitagora e mundësojnë këtë gjë.</i></p>			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>		<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				<b>X</b>

### Standardi V.3

**Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve informacion të plotë e të hollësishëm për objektivat formuese, strukturën, organizimin, përmbajtjen e programit të studimit, rezultatet e pritshme të të nxëniet dhe mundësitë e punësimit.**

<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<p><b>Kriteri 1.</b> Studentët informohen në mënyrë të hollësishme për strukturën, organizimin dhe kohëzgjatjen e programit të studimit.</p> <p><b>Kriteri 2.</b> Institucioni vë në dispozicion të studentëve informacion dhe dokumentacion/ udhëzues të posaçëm për lëndët/modulet, përmbajtjen dhe veprimtaritë formuese</p> <p><b>Kriteri 4.</b> Studentëve u vihet në dispozicion informacion i gjerë dhe i përditësuar për zhvillimin dhe organizimin e procesit mësimor, logjistikën, infrastrukturën dhe shërbimet</p>	<p>UNISHK ka bërë përpjekje për të ngritur sistemin për informimin e studentëve dhe të interesuarve për studentë dhe të familjarëve të tyre për programet e studimit, organizimin dhe rregullat bazë të funksionimit, si dhe të gjithë mundësinë që institucioni krijon për karrierën e tyre.</p> <p>Studentët aktualë dhe të ardhshëm informohen përmes disa mundësive:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Faqja zyrtare e UNISHK në internet (<a href="https://unyt.edu.al/">https://unyt.edu.al/</a>)</li> <li>- Media sociale e universitetit dhe fakultetit</li> <li>- Veprimtarisë së Njësisë së Marketingut e PR, karrierës dhe alumnit, Marrëdhënieve Ndërkombëtare</li> <li>- Materialeve promovuese guida e UNISHK fletëpalosje, etj</li> <li>- Ditëve të hapura – ku roli i Departamentit në qartësimin e strukturës së programit është shumë i rëndësishëm, por dhe zyrat administrative, përfshirë Sekretarinë Mësimore luajnë një rol rëndësishëm në plotësimin e të gjithë elementëve që studenti ka interes. Gjithashtu, qartësohen dhe të gjitha zyrat e tjera të cilat janë në shërbim të studentit, financa, IT, karriera, etj</li> </ul>

<p>në funksion të realizimit të tij.</p>	<ul style="list-style-type: none"> <li>- Javën e parë të mësimit nga çdo pedagog, i cili qartëson të gjithë elementët e silabusit;</li> <li>- Pitagora, platformës së menaxhimit të të dhënave për ecurinë akademike, të cilën studenti mund ta aksesojë dhe jashtë kampusit.</li> <li>- Email zyrtar të studentit në UNISHK, me të cilin pajiset në momentin e regjistrimit dhe të nëshkrimit të kontratës;</li> <li>- Stendave informative në ambjentet e FE</li> </ul> <p><i>Dokumenti 3.III. Strategjia e komunikimit dhe informimit publik</i></p> <p><i>Dokumenti 13-XIII dhe 5.10: Guida e UNISHK</i></p> <p><i>Dokumenti Viti I, Viti II dhe Viti III: Silabuset sipas viteve dhe lëndëve</i></p> <p><i>Dokumenti 5.12: Relacion për aktivitetin "Mirësevjen maturant"</i></p> <p><i>Dokumenti 5.13: Relacion Ditët e hapura ndër vite</i></p> <p><i>Dokumenti 7. VII. Strategjia e tregut të punës</i></p> <p><i>Dokumenti 23-XXIII. Platforma Pitagora</i></p> <p><i>Dokumenti 34-XXXIV: Programi I Transparencës</i></p> <p><i>Dokumenti 1.1.b: Strategjia sektoriale</i></p> <p><i>Dokumenti III: Strategjia e komunikimit</i></p> <p><i>Dokumenti 42. XL.II: Raport nga Zyra e Këshillimit të Karrierës dhe Alumnit</i></p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Institucioni informon studentët mbi mundësitë e punësimit, si dhe mbështetjen institucionale për orientimin drejt dhe në tregun e punës.</p>	<p>Nëse flitet për një nga pikat e forta të FE të UNISHK, në vite është kthyer në një pikë të rëndësishme referimi për punësimin e studentëve. Rekomadimi i pedagogëve mbetet rekomandimi më i rëndësishëm për organizatat/bizneset për punësimin e stafit të ri. Gjithashtu pedagogët për shkak të network-ut të tyre, luajnë një rol të rëndësishëm në ftesat në auditor të sipërmarrësve dhe ekspertëve të biznesit, në organizimin e praktikës mësimore, në organizimin e Panairit të punës dhe të një sërë eventesh në Fakultet.</p> <p>Gjatë vizitës në institucion dhe diskutimeve në lidhje me këtë kriter të standardit, veçuan një specifike interesante, një pjesë e pedagogëve të jashtëm kishin bizneset e tyre, apo punonin në pozicione menaxheriale në organizata/kompani të rëndësishme në qark. Zyra e Karrierës dhe Alumnit është në nivel Universiteti, ekzistojnë të gjitha premiset që ajo të rritet e bëhet më dinamike dhe të gjendet mundësia për një lidhje më organike me fakultetet dhe departamentet</p>



	<p>Gjithashtu në faqen e internetit, botohen një sërë publikimesh që kanë lidhje me konkurse, intershipe, punësime etj në ndihmë dhe në shërbim të studentëve. Aktive janë gjithashtu dhe mediat sociale.</p> <p><u>Në takimin me studentët perceptohej nevoja për një universitet më dinamik e më në qendër studentin.</u></p> <p><i>Dokumenti 1.5: Panairi I punës</i>  <i>Dokumenti 1.5.1: Panairi I punës</i>  <i>Dokumenti 1.10: Marrëveshje me institucionet për praktikën</i>  <i>Dokumenti 5.3: Marrëveshje midis FE dhe palëve të interes</i>  <i>Dokumenti 5.1: Zyra e karrierës</i>  <i>okumenti 42. XL.II: Raport nga Zyra e Këshillimit të Karrierës dhe Alumnit</i></p>			
<b>Kriteri 5.</b> Informacioni në lidhje me programin e studimit mundësohet përmes sistemit të menaxhimit të brendshëm të informacionit dhe duhet të jetë lehtësisht i arritshëm nga studentët edhe në distancë.	Në UNISHK ekziston sistemi i menaxhimit të të dhënave të studentit PITAGORA (të ecurisë akademike), por mungon Learning Management system.			
<b>Konkluzione</b>	GVJ vlerëson që aktualisht UNISHK ofron informacion të plotë mbi strukturën, përmbajtjen e programit të studimit, rezultatet e pritshme të të nxënësve dhe mundësitë e punësimit, ndërkohë që sfidat lokale dhe globale shtrojnë nevojën për rrugë e instrumenta të reja, në përputhje me gjeneratën Z dhe sfidat që tregu i punës po kalon. Gjithashtu, ndjehet nevoja për më shumë sinergji mes njësisë të rektoratit dhe FE dhe studentëve, me fokus studentin.			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>	<b>X</b>

<b>Standardi V.4</b>	
Institucioni i arsimit të lartë mbledh, administron, përditëson dhe ruan të dhëna të hollësishme në lidhje me numrin e profilit të studentëve që ndjekin programin e studimit, nga pranimi deri në diplomim, si dhe të dhëna të punësimit të tyre.	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>

**Kriteri 1.** Institucioni i arsimit të lartë disponon dhe mban statistika vjetore për numrin e studentëve e të diplomuarve, në programin e studimit.

**Kriteri 2.** Institucioni disponon statistika vjetore për numrin e studentëve të regjistruar në programin e studimit, deri në diplomimin e tyre, tërheqjet nga programi, si dhe largimet para përfundimit të programit apo mospërfundimin me sukses të vitit akademik në të cilin zhvillohet programi i studimeve

**Kriteri 5.** Njësia bazë duhet të hartojë raporte analitike, periodike mbi profilin dhe cilësinë në hyrje dhe dalje të studentëve, si dhe shkallën e cilësisë së punësimit të tyre, duke e shoqëruar me masat e duhura në drejtim të përmirësimit të këtyre treguesve.

Bazuar në Ligjin e Arsimit të Lartë Nr. 80/2015, Rregulloren e UNISHK çdo fakultet ka Sekretarinë Mësimore, e cila funksionon në bazë të të gjithë akteve ligjore dhe nënligjore, Statutit dhe Rregullores të UNISHK, sugjerojmë:

- së pari formulimin e rregullores së sekretarisë mësimore;
- së dyti, Kryesekretarja nuk duhet të ketë varësi nga Zyra e Kurrikulave dhe Cilësisë;

Në Sekretarinë Mësimore mbahen të gjitha statistikat në lidhje me numrin e studentëve: të regjistruar, të diplomuar, largimet, pezullimet, transferimet, ecuria e studentëve; proces-verbalet e provimeve, regjistri themeltar, dosjet e çdo studenti sipas udhëzimeve të MAS. Programi bachelor në administrim biznes me akreditohet për herë të parë, në tabelën më poshtë jepet një statistikë e numrit të studentëve, të regjistruar së bashku me ata të transferuar sipas viteve.

Viti akademik	Nr i të regjistruarve	Nr i të cregjistruarve	Nr i të diplomuarve	Nr aktual
2020-2021	86	6	53	80
2021-2022	103	2	57	101
2022-2023	104	0	0	104
<b>Totali</b>	<b>285</b>			

Gjatë vizitës në institucion, ekspertët e jashtëm kaluan një kohë dhe në sekretarinë e e Fakultetit të Ekonomisë. Dosjet e ecurisë së studentëve nga semestri në semestër dhe për çdo vit akademik, regjistri themeltar dhe çdo informacion tjetër që ju kërkua stafit u vendos në dispozicion. Gjithashtu, shqyrtoam dhe mbajtjen e të gjithë informacionit në mënyrë elektronike në Pitagora. Përmes të dhënave të marra nga sekretaria, si rregull drejtues e departamentit hartojnë një raport analitik të detajuar mbi procesin mësimor dhe statistikat e studentëve.

*Në fakt në dosjen e programit të studimit gjetëm vetëm një dokumenti të tillë të hartuar nga Dekani për vitin 2019-2020 dhe ky jo shumë analitik.*

*Dokumenti 1.I. Statuti i UNISHK*

*Dokumenti 2. II: Rregullore e studimit në UNISHK*



	<i>Dokumenti 1.17: Rregullore e programit të studimit BA në AB</i> <i>Dokumenti 4.6: Analiza e procesit mësimor</i>		
<b>Kriteri 3.</b> Të dhënat statistikore të studentëve duhet të menaxhohen përmes sistemit të brendshëm të informacionit dhe duhet të jenë të sigurt dhe lehtësisht të verifikueshme nga personat e autorizuar.	Sistemi i menaxhimit të të dhënave të studentëve, PITAGORA funksionon me akses vetën në marrjen e informacionit për studentët, ndërkohë pedagogët aksesojnë të dhënat e lëndëve të tyre, ndërkohë sekretaria mësimore hedh të dhënat, verifikon dhe prodhon proces verbale e material të tjera. Elementët e sigurisë përcaktojnë dhe aksesin e punonjësve të sekretarisë, pedagogëve dhe studentëve. Sistemi Pitagora menaxhohet nga RASH në bashkëpunim me universitetet.  <i>Dokumenti 23. XXIII – Platforma Pitagora</i>		
<b>Kriteri 4.</b> Institucioni mbështet me akte, kontrollin periodik të përvitshëm pranë gjithë njësive përgjegjëse për menaxhimin (sekretariatë mësimore, sistemin e menaxhimit të brendshëm të informacionit, etj.), vlerëson dhe dokumenton gjendjen dhe saktësinë e informacionit dhe të dokumentacionit që lidhet me studentët, dhe me veprimtarinë e tyre përkatëse.	Garantimi i cilësisë së menaxhimit të sistemit të administrimit të të dhënave, është konsideruar nga drejtimi i lartë si një nga elementët e procesit të auditimit. Për këtë arsye, bazuar dhe në legjislacionin në fuqi dhe në strukturat e brendshme, auditimi realizohet nga Drejtoria e Auditimit të Brendshëm. Në dosjen e dokumentave të paraqitur, gjejmë vetëm një raport auditimi për sekretarinë mësimore, por i vjetër në kohë.  <i>GVJ sugjeron një frekuencë të paktën vjetore, në drejtim të auditimit të sekretarisë.</i>  <i>Dokumenti 3.37: Raport auditimi i sekretarisë mësimore</i>		
<b>Konkluzione</b>	<i>GVJ vlerëson se ky standard plotësohet pjesërisht <u>sugjerohet</u> përpilimi i Rregullores së Sekretarisë Mësimore, shkëputja e varësisë nga drejtoria Kurrikulës dhe Cilësisë si dhe një periodicitet vjetor i auditimit të saj.</i>		
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
		X	

#### Standardi V.5

**Institucioni i arsimit të lartë përfshin dhe angazhon studentët në organet vendimmarrëse e këshilluese, në kuadër të hartimit, miratimit, rishikimit e përmirësimit të programeve të studimit, metodave të mësimdhënies dhe cilësisë së burimeve e shërbimeve ndaj tyre.**

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p><b>Kriteri 1.</b> Institucioni parashikon përfshirjen dhe angazhimin e studentëve dhe/ose përfaqësuesve të tyre në organet vendimmarrëse e këshilluese sipas akteve ligjore dhe atyre rregullatore të vetë institucionit.</p> <p><b>Kriteri 2.</b> Institucioni duhet të garantojë se përfshirja e studentëve dhe/ose përfaqësuesve të tyre në vendimmarrje, këshillim apo vlerësimin mbi procesin akademik, të jetë reale, konkrete, frutdhënëse dhe me rezultate lehtësisht të verifikueshme e të matshme.</p>	<p>Ligji për Arsimin e Lartë Nr 80/2015 përcakton të drejtën e studentëve për t'u përfaqësuar në një sërë organesh vendimmarrëse dhe me rol konsultativ brenda strukturave të universitetit. <i>Kreu XI</i> i Statutit të UNISHK i dedikohet studentëve, në Nenin 78- Të drejtat dhe detyrimet e studentëve- përcaktohet që studentët gjatë periudhës së studimeve kanë të drejtë të përfaqësohen në organet e UNISHK, në raportet që përcakton ligji, përfshirë këtu dhe pjesëmarrjen në Senatin Akademik ku përfaqësuesit e studentëve zgjidhen përmes votimit të studentëve.</p> <p>Gjithashtu, studentët janë pjesë e:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Bordit të Administrimit ;</li> <li>- Komisionit të sigurimit të standardeve të cilësisë;</li> <li>- Këshilli të Fakultetit;</li> <li>- Komisionit të mbarëvajtjes së veprimtarive dhe marrëdhënieve me studentët;</li> <li>- Komisionit të kurrikulave;</li> <li>- Grupeve të vlerësimit të brendshëm të programeve të studimit dhe grupeve të tjera ad hoc qe mund të ngrihen në nivel njësie kryesore apo bazë;</li> </ul> <p>Një veprimtari e rëndësishme e sanksionuar me Statut janë <i>Këshillat e Studentëve</i> të cilat mbrojnë dhe përfaqësojnë interesat e studentëve në të gjitha programet e studimit.</p> <p>Mbështetur në Statut, në disa nga rregulloret dhe organet e institucionit si: Rregullorja e UNISHK; Rregullore për Zgjedhjen e Këshillit Studentor; NJSBC në rang fakulteti, etj sanksionohet e drejta e studentëve për t'u përfaqësuar dhe patur rol në vendimmarrje.</p> <p>Pjesëmarrja e studentëve në komisione, në Senat në grupet e vlerësimit të brendshëm të programeve është mundësi e drejtpërdrejtë për të ndikuar në rishikimin e përmirësimin e programeve, programin BA në Ab përfshirë. Pjesë e rëndësishme e pjesëmarrjes së studentëve në vlerësimin e procesit akademik është dhe zhvillimi i procesit të vlerësimit të lëndës, që krijon mundësinë e analizave të mëtejshme në terma të përmbajtjes së lëndës, por dhe mënyrës së zhvillimit të saj nga pedagogu, si dhe në drejtim të përmirësimit të vazhdueshëm të kurrikulës.</p> <p><i>Dokumenti 1.1. Statuti i UNISHK</i></p> <p><i>Dokumenti 2. II: Rregullore e studimit në UNISHK</i></p> <p><i>Dokumenti 5.4: Këshillat studentore dhe përfaqësues në Bordin e Administrimit</i></p>



	<i>Dokumenti 2.25: Këshilli Fakultetit</i>			
	<i>Dokumenti 33.XXXIII: Rregullore e Këshillave Studentorë</i>			
<b>Kriteri 3.</b> Njësia përgjegjëse garanton përfshirjen e studentëve në procesin e hartimit, rishikimit dhe përmirësimit të programit të studimit mbi baza të rregullta dhe reflekton sugjerimet e kontributin e tyre në to, në mbledhje të përbashkëta në departament, me pyetësorë, grupe fokusimi, etj.	<p>Studentët përfshihen në mënyrë direkte dhe indirekte në procesin e përmirësimit të vazhdueshëm të procesit mësimor dhe programit të studimit. Kështu, ata bëjnë vlerësimin periodik të mësimdhënies së pedagogëve, ndërveprojnë gjatë gjithë periudhës së studimeve me drejtuesit e departamentit dhe fakultetit, ndërveprojnë dhe orientojnë pakënaqësitë apo sugjerimet e tyre përmes pjesëmarrjes në shumë komisione e organe, dhe natyrisht sjellin zërin e tyre përmes Këshillit Studentor.</p> <p><i>Dokumenti 2.13: Raport përmbledhës I NJSBC</i></p> <p><i>Dokumenti 5.5: Pyetësor i studentëve</i></p> <p><i>Dokumenti 2.12: Vlerësimi programit BA në AB për vitin 21-22</i></p> <p><i>Dokumenti 1.I. Statuti i UNISHK</i></p> <p><i>Dokumenti 2. II: Rregullore e studimit në UNISHK</i></p>			
<b>Kriteri 4.</b> Studentëve u mundësohet dhënia e mendimit mbi barazinë dhe ndershmërinë e kryerjes së procesit të vlerësimit dhe kontrollit të dijeve, përfshirë mundësinë e ankimimit të rezultatit, rishikimit dhe reflektimit nga ana e institucionit/ njësisë/pedagogut përgjegjës.	<p>Studentët kanë të drejtë të kërkojnë shpjegim për mënyrën e vlerësimit të dijeve në të gjitha format e kontrollit të dijeve, nga pedagogu i tyre. Në rastin kur shpjegimi i pedagogut nuk është shterues për arsyet që studenti mbron, ai gëzon të drejtën e ankimimit në departament. Gjatë takimit në institucion me studentët ata u shprehën që disa herë u kanë kërkuar pedagogëve një raport ndryshe të vlerësimit përfundimtar me vlerësimin gjatë semestrit. Disa nga pedagogët e kishin reflektuar, por sugjerimi GVI shkon për një peshë më të madhe të vlerësimit të vazhduar dhe kjo të unifkohet.</p> <p><i>Dokumenti 2. II: Rregullore e studimit në UNISHK</i></p> <p><i>Dokumenti 1.17: Rregullore e programit të studimit BA në AB</i></p>			
<b>Konkluzione</b>	<p><i>GVI vlerëson që nga pikëpamja e zbatimit të ligjeve dhe akteve rregullatore ky standard plotësohet, por ka shumë hapësirë dhe punë për t'u bërë për të vënë studentët në qendër, duke nisur nga pikëpamja logjistike, ku studentët nuk kanë një hapësirë të dedikuar për ta në hollin e institucionit, apo ngritjes së një HUB për studentët e AB dhe mbi të gjitha për një dinamikë që krijon sinergji dhe optimizëm në institucion.</i></p>			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>		Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

**Standardi V.6**

*Elcoht*

*gog*

**Institucioni i arsimit të lartë ka procedurë e njësi të posaçme për pritjen, orientimin, këshillimin e studentëve, menaxhimin e ankimimeve e problematikave, të cilat ushtrojnë veprimtarinë në mënyrë të përhershme e janë lehtësisht të arritshme nga studentët.**

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p><b>Kriteri 1.</b> Institucioni ka procedura e njësi të posaçme në shërbim të informimit e shërbimit të studentëve, në përputhje me parashikimet ligjore dhe aktet rregullatore të institucionit.</p> <p><b>Kriteri 2.</b> Institucioni ka ngritur dhe ka bërë funksional një sistem të posaçëm për informimin, këshillimin, ndjekjen e përparimit të studentëve dhe asistimin e tyre për çështje që kanë të bëjnë me procesin mësimor dhe programin e studimit.</p>	<p>UNISHK ka bërë një sërë përpjekjesh për të ecur me hapin e kohës në lidhje me informimin e studentëve në lidhje me procesin mësimor, aktivitetet dhe ngjarjet e ndryshme që ndodhin.</p> <p>Një nga mjetet më të rëndësishme të informimit është faqja e internetit <a href="https://unishk.edu.al/">https://unishk.edu.al/</a>. Gjithashtu në vitet e fundit rrjetet sociale të Fakultetit Ekonomik dhe të UNISHK po luajnë një rol aktiv për shkak të veçorive të gjeneratës Z. Në të njëjtën kohë, sistemi i email të intranetit, publikimet në stendat pranë departamenteve dhe dekanatit, komunikimet e pedagogëve verbale dhe përmes rrjeteve, përfshirë ehatsapp group janë mjetet që përdoren për informimin e studentëve.</p> <p>Për ndjekjen e ecurisë mësimore, në shërbim të studentëve është sistemi PITAGORA, por dhe shumë informacione që në mënyrë të vazhduar merren përmes komunikimit ditë pas pas dite me sekretarinë dhe departamentin. Gjatë vizitës në institucion, studentët, stafi, drejtuesit dhe zyrat e ndryshme vlerësonin efektivitetin e një kanali komunikimi.përkundrejt një tjetri.</p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Institucioni u ofron studentëve shërbimin e këshillimit të karrierës. Zyra/njësia për këshillimin e karrierës mirëpret studentët në mënyrë të vazhduar dhe periodike, duke ofruar informacion dhe orientim të posaçëm, në lidhje me kompletimin e procesit mësimor, zgjedhjen dhe orientimin për praktikën profesionale në institucione të tjera dhe orientimin në tregun e punës.</p> <p><b>Kriteri 4.</b> Zyra/njësia e karrierës ndjek studentët</p>	<p>Studenti në qendër dhe ofrimi i një sërë shërbimesh për studentët, si këshillimi i karrierës, mundësitë për intershipe dhe punësime, orientimi për mobilitetet Erasmus dhe përfshirja në projekte, konferencat shkencore, etj është sot në thelbin e veprimtarisë së universiteteve</p> <p>Prej disa vitesh në institucion janë ngritur si sektorë brenda një drejtorie Zyra e Karrierës dhe Alumnit, Zyra PR dhe Marketingut, Ndërkombëtarizimit dhe Projekteve të cilat funksionojnë pranë Rektoratit. Roli i kësaj drejtorie vjen dhe bëhet më i rëndësishëm në kushtet kur tregu arsimit të lartë ka problemet e veta, pasojë e zhvillimeve social-ekonomike në vend</p> <p>Është pozitive që tashmë këto struktura po bëjnë përpjekje për t'i shërbyer studentëve, po organizojnë në bashkëpunim me FE një sërë aktiviteteve, ku Panairi i Punës është më i rëndësishmi.</p> <p>Zyra e Këshillimit të Karrierës dhe Alumnit po në bashkëpunim me departamentin e AB gjurmon studentët pas diplomimit, por <u>GVJ</u></p>

*Ercor*

<p>pas diplomimit, mbledh, përpunon e mban të dhëna mbi shkallën dhe cilësinë e punësimit të studentëve të programit të studimit dhe ua vë ato në dispozicion studentëve dhe organeve e autoriteteve drejtuese përkatëse.</p>	<p><i>sugjeron që gjurmimi duhet të shërbejë për të iniciuar një bashkëpunim me interes të ndërsjellte.</i></p> <p><i>Ajo që evidentohej gjatë takimeve në institucion me stafin akademik dhe administrativ ishte një lloj diskrecioni, apo mungese sinergjie institucionale, e cila natyrisht në kushtet e reja kërkon një përjasje ndryshe kulturore dhe intitucionale, për të dhënë një sens optimizmi tek studentët.</i></p> <p><i>Gjithashtu, duhet menduar si këto zyra shtrijnë veprimtarinë në FE dhe bëhen të ndërveprueshme me studentin dhe të dukshme e arritshme për të.</i></p> <p><i>Dokumenti 1.5.1: Panairi i Punës</i></p> <p><i>Dokumenti 5.1: Zyra e karrierës</i></p> <p><i>Dokumenti 42. XL.II: Raport nga Zyra e Këshillimit të Karrierës dhe Alumnit</i></p> <p><i>Dokumenti 1.22: Marrëveshje me intitucione</i></p>			
<p><b>Konkluzione</b></p>	<p><i>GVJ vlerëson që ka përpjekje për plotësimin e këtij standadi, por kërkohet më shumë angazhim, përjasje kulturore e ndërveprim më studentin</i></p>			
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>	<p>X</p>

<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës V</b></p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>	<p>X</p>
--	------------------------------	-----------------------------	------------------------------	----------

## VI. SIGURIMI I CILËSISË SË PROGRAMIT TË STUDIMIT BACHELOR

<p><b>Standardi VI.1</b></p> <p><b>Institucioni i arsimit të lartë ndjek një politikë të qartë për garantimin dhe promovimin e cilësisë së mësimdhënies dhe harton udhëzues të posaçëm të zhvillimit të metodave dhe monitorimit.</b></p>	
<p><b>Kriteret</b></p>	<p><b>Vlerësimi i ekspertëve</b></p>
<p><b>Kriteri 1.</b> Institucioni harton udhëzues në nivel institucional për zhvillimin dhe përdorimin e metodave</p>	<p>Në lidhje me kriterin, institucioni harton udhëzues në nivel institucional për zhvillimin dhe përdorimin e metodave të ndryshme dhe inovative të mësimdhënies. UNISHK e targeton cilësinë në mësimdhënie si një tipar intrinsik të institucionit për</p>



<p>të ndryshme dhe inovative të mësimdhënies në bazë të fushës së studimeve, lëndëve/moduleve.</p>	<p>vet kohën dhe historikun që ka në metodat mësimdhënëse dhe pedagogjike (rreth 60 vite). IAL mbështetet në disa strategji si “<i>Strategjia institucionale e mësimdhënies, mësimnxënies dhe metodave të vlerësimit 2022-2026</i>, në këtë strategji përfshihen një sërë objektivash dhe plan aktivitetesh. Rishikimi i programeve mësimore, është një prej tyre, jo vetëm për të sanksionuar këto aktivitete por edhe për t’iu përgjigjur nevojave të tregut. Për aplikimin e këtyre strategjive, stafi institucionit merr pjesë në trainimet e organizuara nga NjSBC dhe ekspertët e jashtëm. Po kështu, përmirësimi i vazhdueshëm i cilësisë së mësimdhënies është një pjesë integrale edhe në: Strategjitë e Kërkimit, Strategjinë e Zhvillimit (Referenca më posht) etj. Punë e veçantë bëhet me pedagogët e rinj të cilët trajnohen përsa i takon mënyrës së përgatitjes së programeve, kurrikulave dhe shpjegimin e rregulloreve përkatëse. GVJ vlerëson pozitivisht këtë përpjekje të institucionit për të hartuar strategji të cilat do të orientojnë në arritjen e qëllimeve, megjithatë nga vizita në IAL vihet re që ka një hendek midis asaj që paraqitet si strategji dhe aplikimi konkret i instrumentave si dhe gjetjet apo monitorimi i këtyre aktiviteteve. Për shembull mos përditësimi i syllabuseve tregon që strukturat përgjegjëse për cilësinë duhet të jenë më proaktive dhe të kenë sinergji me zyrat e tjera për të siguruar arritjen e objektivave të paraqitur në strategjitë e ndryshme.</p> <p><i>Dokument 1.2 strategjia e USH-se</i>  <i>Dokument 1.20 Strategjia e FE-se 2018-2022</i>  <i>Dokument 2.25 Strategjia e FE-se 2018-2022</i>  <i>Dokument 4-IV. STRATEGJIA E MËSIMDHËNIES 2017-2021...</i>  <i>Dokument 4-IV. STRATEGJIA E MËSIMDHËNIES 2022-2026..</i>  <i>Dokument 5-V. STRATEGJIA E KËRKIMIT SHKENCOR</i>  <i>Dokument 6-VI. STRATEGJIA E NDËRKOMBËTARIZIMIT..</i>  <i>Dokument 7-VII. STRATEGJIA E TREGUT TË PUNËS 2</i>  <i>Dokument 8-VIII STRATEGJIA E ZHVILLIMIT 2022</i></p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Strukturat përgjegjëse zhvillojnë mekanizma të monitorimit dhe vlerësojnë në mënyrë periodike aftësitë mësimdhënëse dhe inovative</p>	<p>UNISHK ka dy struktura bazë për kontrollin dhe vlerësimin e cilësisë së mësimdhënies: Komisionin e Sigurimit të Cilësisë dhe Njësinë e Sigurimit të Cilësisë (<i>Statuti USH, neni 24 dhe 25</i>).</p> <p>Zyra e Sigurimit të Cilësisë është përgjegjëse për sigurimin e cilësisë dhe përmirësimin e këtij niveli duke përdorur një sërë</p>

*Ercoll*

*[Signature]*



të personelit akademik dhe ndihmësakademik.

mekanismash si: - hartimit të politikave dhe procedurave për sigurimin e brendshëm të cilësisë, të cilat miratohen në Senatin Akademik;-- vlerëson, periodikisht, rezultatet e veprimtarive mësimore dhe kërkimore-shkencore; -në fund të semestrit, para sezonit të provimeve, organizon pyetësin studentor për cilësinë e mësimdhënies për lëndët e çdo programi studimi; realizon studime gjurmuese për të vlerësuar ecurinë e punësimit të studentëve dhe efikasitetin e programeve të ofruara nga institucioni i arsimit të lartë;-- harton dhe i propozon Senatit standardet për sigurimin e cilësisë në përputhje me Kodin e Cilësisë;--prezanton raportin vjetor të vlerësimit të brendshëm të cilësisë së USH-së në Senatin Akademik, i cili miraton raportin vjetor përfundimtar të vlerësimit të brendshëm të cilësisë në USH.

Vlerësimet periodike të studentëve për pedagogun, të cilat kryhen nëpërmjet plotësimit të një formulari në formë anonime. Duke ofruar sugjerime, studentët ndihmojnë jo vetëm në vlerësimin e cilësisë së punës së pedagogut, por edhe përfshihen në përmirësimin e programit të studimit.

Vlerësimet e lartpërmendura të pedagogëve i dërgohen drejtuesit të departamentit, i cili ia dërgon Dekanit dhe me pas Rektoratit. GVJ vlerëson që pavarësisht ekzistencës së kornizës institucionale të NJSBC-së më shumë përpjekje duhen bërë nga kjo njësi për të operacionalizuar objektivat që i ka vendosur vetes, të paraqitura në Statut USH por edhe në rregulloren e NJSBC-së. Raporti Dokumenti: Raport përmbledhës mbi NJSBC fakulteti 2023 ofron vetëm një përgjigje të reduktuar të gjetjeve të pyetësorit të studentëve pa një narrative konkrete në lidhje me masa të tjera për sigurimin e cilësisë.

*GVJ rekomandon, që kjo zyrë duhet të bëjë më shumë përpjekje për të krijuar instrumenta të vlerësimit 360 gradë të programit të studimit, të shtrihet në aktorë të tjerë që lidhen direkt ose indirekt me programin e studimit.*

Paketa e vlerësimit të cilësisë e përbërë nga 1. ANALIZA SWOT (Analiza realizohet nga pedagogu i cili bën një vetvlerësim në lidhje me leksionet, seminarët, detyrimet e studentit), 2. Pyetësor për studentët për programin e studimit, 3. Pyetësori për studentet që kanë përfunduar studimet në Ush në lidhje me programin e studimit dhe mësimdhënien, 4. Pyetësori për punëdhënësit, 5. Formular vlerësimi nga personeli akademik i cili zhvillohet në fund të çdo viti akademik nga personeli akademik, duhet të shërbejë për të krijuar një plan

	<p>konkret monitorimi dhe vlerësimi si dhe një plan vjetor aktivitetesh.</p> <p><i>Dokument 1-I.STATUTI USH.pdf</i></p> <p><i>Dokument:10-X. MANUALI I CILËSISË</i></p> <p><i>Dokumenti :Kopertina 2.3 NJSBC</i></p> <p><i>Dokumenti: Miratimi i perfaqesuesit te departamentit NJSBC e FE</i></p> <p><i>Dokumenti :Miratimi i rregullores NJSBC FE</i></p> <p><i>Dokumenti: Raport permbledhes mbi NJSBC fakulteti 2023</i></p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Institucioni garanton përfshirjen e studentëve në vlerësimin periodik të formave e metodave të mësimdhënies, të vlerësimit të dijeve, përfshirë mundësinë e trajtimit të ankimimeve.</p>	<p>Mbështetur në Statut, në disa nga rregulloret dhe organet e institucionit si: Rregullorja e UNISHK; Rregullore për Zgjedhjen e Këshillit Studentor; NJSBC në rang fakulteti, etj sanksionohet e drejta e studentëve për t'u përfaqësuar dhe patur rol në vendimarrje. Pjesëmarrja e studentëve në komisione, në Senat në grupet e vlerësimit të brendshëm të programeve është mundësi e drejtpërdrejtë për të ndikuar në rishikimin e përmirësimin e programeve, programin BA në AB përfshirë. Pjesë e rëndësishme e pjesëmarrjes së studentëve në vlerësimin e procesit akademik është dhe zhvillimi i procesit të vlerësimit të lëndës, që krijon mundësinë e analizave të mëtejshme në terma të përmbajtjes së lëndës, por dhe mënyrës së zhvillimit të saj nga pedagogu, si dhe në drejtim të përmirësimit të vazhdueshëm të kurrikulës.</p> <p><i>Dokumenti 1.I. Statuti i UNISHK</i></p> <p><i>Dokumenti 2. II: Rregullore e studimit në UNISHK</i></p> <p><i>Dokumenti 5.4: Këshillat studentore dhe përfaqësues në Bordin e Administrimit</i></p> <p><i>Dokumenti 2.25: Këshilli Fakultetit</i></p> <p><i>Dokumenti 33.XXXIII: Rregullore e Këshillave Studentorë</i></p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Strukturat përgjegjëse për monitorimin dhe sigurimin e cilësisë në mësimdhënie bëjnë publike rezultatet e vlerësimit.</p>	<p>Departamenti Administrim Biznesi përdor mënyra periodike vlerësimi për përmirësimin e mësimdhënies nga instanca të ndryshme të cilat mund të përmbledhen në vlerësimin nga:</p> <p>Drejtuesi i Departamentit, përgjegjës për organizmin e punës didaktike dhe zhillimin strategjik të departamentit nëpërmjet analizave vjetore. Ky proces kryhet nëpërmjet analizave periodike të personelit akademik, kontrollit të cilësisë së syllabuseve, harmonizimit të ngarkesës së stafit akademik, ndihmës që i ofrohet stafit të ri, trainimit për përgatitjen e kurrikulave akademik, vlerësimit të performancës së stafit akademik, etj. Po kështu në nivel institucional në nenin 14 dhe</p>

	<p>15 Dokumenti Manuali i Cilësisë paraqiten aspekte të vlerësimit të cilësisë së programit të studimit si dhe aspekteve të tjera që lidhen me punën mësimore dhe kërkimore të stafit si dhe indikatorët përkatës. Analizat bëhen publike në të gjithë pjesëtarët e departamentit dhe dorëzohen më pas në Dekanat, ky i fundit bën analizën përmbledhëse për të gjitha programet e studimit që ofrohen nga njësia kryesore. Po kështu, NJSBC dërgon vlerësimet e instrumentave të përdorur të njësia bazë e cila më pas ia komunikon stafit në mënyrë individuale.</p> <p><i>Dokument 1-I.STATUTI USH.pdf</i></p> <p><i>Dokument:10-X. MANUALI I CILËSISË</i></p> <p><i>Dokumenti: Miratimi i perfaqesuesit te departamentit NJSBC e FE</i></p> <p><i>Dokumenti :Miratimi i rregullores NJSBC FE</i></p> <p><i>Dokumenti: Raport permbledhes mbi NJSBC fakulteti 2023</i></p>						
<p><b>Kriteri 5.</b> Institucioni, nëpërmjet mekanizmave të vlerësimit dhe rezultateve të marra, promovon shembuj të praktikave të mira, nxit personelin akademik për përmirësimin e mëtejshëm të mësimdhënies.</p>	<p>GVJ nga shqyrtimi i dokumentacionit dhe vizitës në IAL vlerëson se nuk gjeti mekanizma të promovimit të praktikave të mira të institucionalizuara. Nga takimi me stafin vihet re pjesëmarrja në mobilitete aplikon një marrëveshje të pashkruar për të siguruar një pjesëmarrje të drejtë por kjo praktikë nuk është e sanksionuar që të mund të përcaktojmë nëse nxitet personeli akademik.</p>						
<p><b>Konkluzione</b></p>	<p><i>GVJ vlerëson që IAL ndjek një politikë të qartë për garantimin dhe promovimin e cilësisë së mësimdhënies dhe harton udhëzues të posaçëm të zhvillimit të metodave dhe monitorimit por vihet re një hendek midis politikës dhe aktiviteteve. <u>GVJ rekomandon më shumë përpjekje për të siguruar shumëllojshmëri praktikash që vlerësojnë dhe monitorojnë garantimin e këtij kriteri.</u></i></p>						
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>	<table border="1"> <thead> <tr> <th></th> <th>Përbushet kryesisht</th> <th>Përbushet plotësisht</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td></td> <td style="text-align: center;">X</td> <td></td> </tr> </tbody> </table>		Përbushet kryesisht	Përbushet plotësisht		X	
	Përbushet kryesisht	Përbushet plotësisht					
	X						

<p><b>Standardi VI.2</b></p> <p><b>Institucioni i arsimit të lartë harton dhe zbaton politika e procedura transparente të posaçme për sigurimin e cilësisë së programit të studimit, në kuadër të strukturave e sistemit të brendshëm të sigurimit të cilësisë.</b></p>	
<p><b>Kriteret</b></p>	<p><b>Vlerësimi i ekspertëve</b></p>
<p><b>Kriteri 1.</b> Institucioni i arsimit të lartë ka politika,</p>	<p>Si është evidentuar edhe më lart, në UNISHK funksionojnë Njësitë për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë në nivel IAL si</p>

<p>struktura dhe procedura për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë (SBC), në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore në fuqi dhe me aktet rregullatore institucionale.</p>	<p>dhe në nivel të njësisë kryesore. Këto njësi janë komisione ad hoc. Këto krijojnë “Strukturën e Cilësisë” dhe hartojnë raporte për veprimtarinë dhe për iniciativat që lidhen me sigurimin e cilësisë. Funkcionimi i tyre është i rregulluar nga Statuti i UNISHK, në përputhje me Kodin e Cilësisë së Arsimit të lartë. NJSBC e fakultetit përpilon dhe harton raporte në lidhje me respektimin e standardeve dhe kritereve të cilësisë. Megjithatë nga takimi me këtë njësi u vu re një mungesë koordinimi dhe roli i tyre për të kërkuar nga strukturat e tjera informacione në lidhje me aspekte të ndryshme të cilësisë. NJSBC në nivel fakulteti harton çdo vit RVB në nivel Fakulteti e cila shërben si bazë së bashku me RVB-të e fakulteteve të tjera për hartimin e RVB-së në nivel institucional, në nivel IAL-je. Në nivel programi studimi është ngritur me vendim departamentesh përkatëse GVB, që ka për qëllim vlerësimin e cilësisë në nivel program.</p> <p><i>Dokument XIX. RAPORT I RVB INSTITUCIONALE</i> <i>Dokument Materiale NJSBC</i></p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Institucioni ka të ngritur, mban në funksion Sistemin e Brendshëm të Sigurimit të Cilësisë dhe zbaton një strategji institucionale për përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë, ku përfshihen studentët dhe bashkëpunëtorë e ekspertë të jashtëm.</p>	<p>Sigurimi i brendshëm i cilësisë menaxhohet nga Zyra e Cilësisë që është pjesë e Drejtorisë së Kurrikulave dhe Standarteve të USH-së. Kjo zyrë në bashkëpunim me Komisionin e Përhershëm për Garantimin e Standarteve të Cilësisë të USH-së, me NJSBC-të në nivel fakultesh ka për qëllim kryesor të kontrollojë veprimtarinë e sigurimit të cilësisë në USH dhe të garantojë zbatimin e kritereve të cilësisë në USH sipas Kodit të Cilësisë. NJSBC në bashkëpunim me drejtuesit e njërive aplikon, koordinon dhe finalizon të gjithë procedurën e akreditimeve institucionale.</p> <p><i>Dokument XIX. RAPORT I RVB INSTITUCIONALE</i> <i>Dokument Materiale NJSBC</i></p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Institucioni përdor instrumentet dhe treguesit e duhur për sigurimin e cilësisë. Sigurimi i jashtëm i cilësisë në arsimin e lartë realizohet përmes proceseve të vlerësimit të jashtëm të akreditimit, vlerësimeve analitike e krahasuese, si dhe proceseve të tjera që promovojnë e përmirësojnë</p>	<p>Strukturat e sigurimit të cilësisë Komisioni i Përhershëm i Sigurimit të cilësisë dhe NJSBC funksionojnë në zbatim të ligjit për arsimin e lartë, statutin e UNISHK dhe rregulloret përkatëse të harmonizuara me Manualin e Cilësisë.</p> <p>Sigurimi i brendshëm i cilësisë menaxhohet nga Zyra e Cilësisë që është pjesë e Drejtorisë së Kurrikulave dhe Standarteve të USH-së. Kjo zyrë në bashkëpunim me Komisionin e Përhershëm për Garantimin e Standarteve të Cilësisë të USH-së, me NJSBC-të në nivel fakultesh ka për qëllim kryesor të kontrollojë veprimtarinë e sigurimit të cilësisë në UNISHK dhe të garantojë zbatimin e kritereve të cilësisë në IAL sipas Kodit</p>



<p>cilësinë në programin e studimit.</p>	<p>të Cilësisë. NjSBC në bashkëpunim me drejtuesit e njësive aplikon, koordinon dhe finalizon të gjithë procedurën e akreditimeve institucionale. n vlerësimi i jashtëm menaxhohet nga ASCAL. UNISHK, sipas vendimit nr. 03, datë 24.01.2020 për 4 vite akademike deri më 23/01/2024 me 5 rekomandime përkatëse.</p> <p><i>Dokument 1-I.STATUTI USH.pdf</i>  <i>Dokument: 10-X. MANUALI I CILËSISË</i>  <i>Dokumenti: Miratimi i perfaqesuesit te departamentit NJSBC e FE</i>  <i>Dokumenti :Miratimi i rregullores NJSBC FE</i>  <i>Dokumenti: Raport permbledhes mbi NJSBC fakulteti 2023</i>  <i>Dokument XIX. RAPORT I RVB INSTITUCIONALE</i>  <i>Dokument Materiale NJSBC</i></p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Institucioni përdor tregues të qartë, të matshëm në mësimdhënie dhe kërkim, për pasqyrimin gjendjes, arritjeve dhe dobësive, të parashikuara dhe në aktet rregullatore institucionale. Mbi bazën e treguesve cilësorë, institucioni bën promovime nxitëse për arritjet më të mira ne programin e studimit.</p>	<p>Si është përmendur më sipër, IAL ka hartuar një sërë strategjish me objektiva specifike, tregues të matshëm dhe aktivitete të parashikuara. Shembuj të tillë i gjejmë në Strategjinë e Mësimdhënies, Strategjinë e Kërkimit Shkencor, Strategjinë e Zhvillimit USH si dhe në strategji të tjera sektoriale si Strategjia e Komunikimit dhe sigurimit të informacionit dhe transparencës. Vet IAL bën një analizë të arritjes së këtyre objektivave cdo vit për të parë hendeqet në arritjen e tyre.</p> <p><i>Dokument 1.2 strategjia e USH-se</i>  <i>Dokument 1.20 Strategjia e FE-se 2018-2022</i>  <i>Dokument 2.25 Strategjia e FE-se 2018-2022</i>  <i>Dokument 4-IV. STRATEGJIA E MËSIMDHENIES 2017-2021...</i>  <i>Dokument 4-IV. STRATEGJIA E MËSIMDHENIES 2022-2026..</i>  <i>Dokument 5-V. STRATEGJIA E KËRKIMIT SHKENCOR</i>  <i>Dokument 6-VI. STRATEGJIA E NDËRKOMBËTARIZIMIT..</i>  <i>Dokument 7-VII. STRATEGJIA E TREGUT TË PUNËS 2</i>  <i>Dokument 8-VIII STRATEGJIA E ZHVILLIMIT 2022</i></p>
<p><b>Konkluzione</b></p>	<p>Si u përmend edhe më sipër IAL disponon akte normative dhe rregullatore, dhe strategji sektoriale në nivel UNISHK-je por nevojitet operacionalizim dhe hapa konkretë të përmbushur në drejtimet që janë vendosur nga IAL.</p>

Shkalla e përmbushjes së standardit		Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
		X	

### Standardi VI.3

**Institucioni i arsimit të lartë monitoron dhe vlerëson përmes njësive të posaçme e në mënyrë periodike programin e studimit, për të garantuar arritjen e objektivave formuese dhe rezultateve të synuara të të nxënit.**

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p><b>Kriteri 1.</b> Institucioni i arsimit të lartë përdor mekanizma e procese formale e të dokumentuara për shqyrtimin, miratimin dhe mbikëqyrjen periodike të programit të studimit të ciklit të parë, që i shërbejnë akreditimit të tij. Në këtë proces realizon evidentimin e arritjeve dhe dobësive, motivimin e praktikave dhe arritjeve më të mira, dhe planin e masave për përmirësim.</p> <p>Rezultatet e këtyre vlerësimeve dokumentohen dhe u bëhen të njohura autoriteteve përgjegjëse dhe vendimmarrëse për programin e studimit.</p>	<p>Procesi i mbikëqyrjes së programeve të studimit bazohet në analizën e objektivave të vendosura si në nivel individual ashtu edhe në nivel departamenti për tu plotësuar gjatë vitit akademik. Në përfundim të çdo viti akademik nga rektorati kërkohet hartimi i raporteve në nivel departamenti dhe fakulteti, ku përshkruhen të gjitha aktivitetet e kryera për përmbushjen e këtyre të mësimdhënies, cilësisë së tyre dhe ato të kërkimit shkencor. Po kështue kryhet vlerësimi i stafit akademik në lidhje me realizimin e objektivave të marra, si edhe hartohet një plan veprimi për të mundësuar realizimin e tyre në të ardhmen. Ky plan veprimi përdoret në vitet në vijim edhe bëhet pjesë e objektivave që duhet të përmbushin pedagogët apo departamentet, me objektivat dhe indikatorë specifikë për arritjen e tyre, objektivat janë përmendur më sipër, bazuar në dokumentacionin e paraqitur nga IAL.</p> <p>Të gjitha raportet e hartuara kombinohen në raportin përfundimtar institucional, i cili miratohet në Senat dhe i dërgohet Ministrisë së Arsimit. I gjithë ky proces dokumentohet në të gjitha hapat e tij, për të siguruar transparencën e nevojshme dhe një proces sa me gjithëpërfshirës për të promovuar praktikat pozitive. Nga vlerësimi i analizave mësimore kërkimore evidenton tregues konkret cilësorë sa i përket, kërkimit shkencor, projekteve dhe ndërkombëtarizimit.</p> <p><i>Dokument 1.2 strategjia e USH-se</i></p> <p><i>Dokument 1.20 Strategjia e FE-se 2018-2022</i></p> <p><i>Dokument 2.25 Strategjia e FE-se 2018-2022</i></p> <p><i>Dokument 4-IV. STRATEGJIA E MËSIMDHENIES 2017-2021...</i></p> <p><i>Dokument 4-IV. STRATEGJIA E MËSIMDHENIES 2022-2026..</i></p>

*Flora*

*[Signature]*

	<p><i>Dokument 5-V. STRATEGJIA E KËRKIMIT SHKENCOR</i></p> <p><i>Dokument 6-VI. STRATEGJIA E NDËRKOMBËTARIZIMIT..</i></p> <p><i>Dokument 7-VII. STRATEGJIA E TREGUT TË PUNËS 2</i></p> <p><i>Dokument 8-VIII STRATEGJIA E ZHVILLIMIT 2022</i></p> <p><i>Dokument 4.6 Analiza procesit mesimor.pdf</i></p> <p><i>2017-XVII. ANALIZA MESIMORE- SHKENCORE...</i></p> <p><i>Dokument analiza e punes kerkimore shkencore FE -...</i></p> <p><i>Dokument: Analiza e punes shkencore e Ad-Biz, 19-...</i></p> <p><i>Dokument Analiza e punes shkencore e Ad-Biz, 21-...</i></p> <p><i>Dokument Analiza e punes shkencore 2019-2020 e...</i></p> <p><i>Dokument Analiza procesit mesimor FE 2018-2019</i></p> <p><i>Dokument Analiza punes kerkimore shkencore FE 17...</i></p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Raportet e vlerësimit duhet të përfshijnë rezultatet e pritshme, rezultatet e vlerësimit, motivimin e praktikave dhe arritjeve më të mira, dhe masat e marra për adresimin e mangësive dhe përmirësimin në vijim të cilësisë, si dhe motivimin e arritjeve më të mira në mësim dhe kërkim nga personeli akademik dhe studentët.</p>	<p>Në evidencat dhe dokumentat strategjike të cituar më sipër, IAL ka paraqitur në mënyrë specifike objektivat në lidhje me mësimdhënien dhe përmirësimin e saj (si indikator vlerësimi I programit nga brenda dhe jashtë nëpërmjet ASCAL, dhe në RVB gjithashtu citohet vlerësimi i brendshëm dhe i jashtëm si një metodologji e strukturuar për të marrë masa në lidhje me promovimin dhe adresimin e gjetjeve. Megjithatë GVJ do vlerësonte nëse IAL do të kishte dëshmuar një praktikë të marrjes parasysh të rekomandimeve që i janë bërë gjatë akreditimit të fundit.</p> <p><i>Dokument 8-VIII STRATEGJIA E ZHVILLIMIT 2022</i></p> <p><i>Dokument 4.6 Analiza procesit mesimor.pdf</i></p> <p><i>2017-XVII. ANALIZA MESIMORE- SHKENCORE...</i></p> <p><i>Dokument analiza e punes kerkimore shkencore FE -...</i></p> <p><i>Dokument: Analiza e punes shkencore e Ad-Biz, 19-</i></p> <p><i>Dokument RVB Bachelor AB...</i></p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Institucioni, në kuadër të vlerësimit të realizimit, mbarëvajtjes e cilësisë së programit të studimit përdor, metoda të drejtpërdrejta, si vlerësim i cilësisë së mësimdhënies, vlerësim të didaktikës, kurrikulës, të mësuarit, vlerësime paralele të provimeve apo detyrave të studentëve, vëzhgime në</p>	<p>Në dhjetor 2022 në nivel USH-je është hartuar nga Komisioni i Përhershëm për Garantimin e Cilësisë në rang universiteti, dhe është miratuar nga Senati i USH-së paketa e instrumenteve matës të cilësisë në USH. Më sipër janë detajuar elementët e vlerësimit. Gjithashtu GVJ vlerëson që raporti i cilësisë është i limituar në analizën e tij duke paraqitur thjesht përgjigjet e pyetësorit të studentëve.</p> <p><i>GVJ rekomandon konsolidimin e këtij raporti si mundësi për evidentimin e gjetjeve për përmirësimin e mëtejshëm të programit të studimit.</i></p>

<p>auditor gjatë kryerjes së ushtrimeve/praktikës, testime lokale apo të standardizuara, rezultatet e arritura në testime ndërinstitucionale apo kombëtare, si: provimi i shtetit për profesionet e rregulluara dhe të tjera.</p>	<p>Po kështu, në dokumentacion nuk evidentohen praktika si vlerësime paralele të provimeve apo detyrave të studentëve, vëzhgime në auditor gjatë kryerjes së ushtrimeve/praktikës, testime lokale apo të standardizuara, vlerësime të tjera të studentëve dhe jo vetëm intervista e strukturuar psh fokus grupet.</p> <p><i>Dokument: Analiza e punes shkencore e Ad-Biz, 19-Dokument RVB Bachelor AB...</i></p>		
<p><b>Kriteri 4.</b> Institucioni, në kuadër të vlerësimit të realizimit, mbarëvajtjes e cilësisë së programit të studimit përdor metoda e instrumente të tërthorta vlerësimi, si: sondazhe e intervista të studentëve, të atyre të diplomuar (alumni), të personelit akademik, ndihmësakademi e administrativ, punëdhënësit e institucionet që bashkëpunojnë në realizimin e programit të studimit dhe palëve të tjera që përfshihen në realizimin apo që shërbejnë për vlerësimin e dijeve e kompetencave të përfutuara nga ky program.</p>	<p>Si u përmend edhe më sipër nga IAL është hartuar paketa e cilësisë ku përfshihen pyetësorë të vecantë për studentët, për lëndët, programin, studentë të punësuar, punëmarrësit etj. Por kjo praktikë ka filluar këtë vit dhe nuk ka një raport të gjetjeve apo adresimeve, prandaj mbetet për tu vlerësuar në të ardhmen. Zyra e Karrierës dhe Alumni e UNISHK, mban kontakte të vazhdueshme me Alumni duke i angazhuar vazhdimisht në aktivitetet e organizuara nga universiteti, më konkretisht në Panairin e punës. Në panairin e zhvilluar në vitin 2022, si pjesë e agjendës kanë qenë dhe intervistat që kanë pasur target bizneset pjesëmarrëse me qëllim evidentimi e nevojave të tyre. Ky panair është pasqyruar edhe në televizionin lokal Starplus Shkodra (<i>Dokument 1.5.1 Panairi i Shkodrës 2022</i>).</p> <p>GVJ e vlerëson si një praktikë të mirë e cila mund t'i shërbejë IAL për të përditësuar programin e studimit BA në AB por edhe në programe të ofertës akademike të FE-UNISHK.</p> <p><i>Dokument 1-I.STATUTI USH.pdf</i>  <i>Dokument: 10-X. MANUALI I CILËSISË</i>  <i>Dokument 6.4 Paketa e instrumentave të matjes së cilësisë në USH</i>  <i>Dokument 1.5.1 Panairi i Shkodrës 2022</i>  <i>Dokument 42 Raport nga zyra e Këshillimi dhe Alumni</i>  <a href="https://unishk.edu.al/studentet/alumni/pyetesor-per-alumnin-e-unishk">https://unishk.edu.al/studentet/alumni/pyetesor-per-alumnin-e-unishk</a></p>		
<p><b>Konkluzione</b></p>	<p><i>GVJ vlerëson që IAL ka krijuar strukturat dhe ka vendosur objektiva të qartë për të garantuar në cilësinë e programit të studimit dhe rekomandojmë një zgjerim të aktiviteteve për të mbledhur sa më shumë gjetje në raport me studentin dhe përvetësimin e njohurive si dhe përdorimin e këtyre njohurive në tregun e punës.</i></p>		
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>		<p><b>Përmbushet kryesisht</b></p>	<p><b>Përmbushet plotësisht</b></p>



			X	
--	--	--	---	--

<b>Standardi VI.4</b>	
<b>Institucioni i arsimit të lartë përfshin njësitë akademike, personelin akademik e studentët në proceset e SBC-së të programit të studimit dhe informon palët e interesuara në lidhje me rezultatet dhe masat e marra në vijim të tyre.</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<p><b>Kriteri 1.</b> Institucioni duhet të parashikojë dhe të garantojë në politikat dhe procedurat e brendshme të cilësisë përfshirjen e aktorëve të brendshëm dhe të jashtëm të interesuara për sigurimin dhe përmirësimin e vazhduar të cilësisë së programit të studimit.</p>	<p>Sic u theksua më lart, strukturat e ngritura dhe procedurat e zbatuara janë në përputhje me Kodin e Cilësisë në Republikën e Shqipërisë, si edhe me Manualin “Per Procedurat dhe afatet për vlerësimin e cilësisë në kuadër të akreditimit të institucioneve të arsimit të lartë dhe programeve të studimit”</p> <p><i>Dokument 1 Statuti i USH.</i></p> <p>KPSSC dhe NJSBC si strukturat përgjegjëse për sigurimin e cilësisë mbështeten nga eksperti i jashtëm dhe nga ai ligjor në përmbushjen e detyrave dhe bazohen në respektimin e procedurave të sanksionuara në Manualin e Cilësisë.</p> <p><i>Dokument 1 Statuti i USH</i></p> <p><i>Dokument 10 Manuali i cilësisë</i></p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Institucioni përcakton përgjegjësi dhe detyra konkrete për njësitë, individët, studentët dhe palë të tjera të angazhuara në sigurimin e brendshëm të cilësisë së programit të studimit dhe garanton ushtrimin me përgjegjësi të këtyre detyrave.</p>	<p>KPSSC dhe NJSBC kanë hartuar një rregullore të brendshme për organizimin dhe punën e Komisionit të Përhershëm për garantimin e standarteve të cilësisë, si edhe njësimin e sigurimit të cilësisë (<i>Dokument 10 Manuali i cilësisë</i>). Kjo rregullore është hartuar duke u bazuar në Ligjin për Arsimin e Lartë në Republikën e Shqipërisë Nr. 80/2015, datë 22/07/2015 në nenin 103 dhe 104, në Nenin 23,24 dhe 25 të Statutit të UNISHK, si edhe në Manualin e Cilësisë. Kësaj rregulloreje i bashkëngjitet edhe rregullorja e NJSBC (<i>Dokument miratimi i Rregullores së NJSBC</i>).</p> <p><i>Dokument 1 Statuti i USH</i></p> <p><i>Dokument 10 Manuali i cilësisë</i></p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Në vlerësimin dhe sigurimin e cilësisë së programit të studimit duhet të garantohet përfshirja e njësisë bazë dhe kryesore, përgjegjëse për programin e studimit, anëtarëve të</p>	<p>KPSSC dhe NJSBC së bashku me Dekanët e Fakulteteve dhe Drejtuesin e Departamentit janë përgjegjës për çeshtjet e cilësisë, duke monitoruar të gjitha proceset aktivitetet dhe veprimtaritë si akademike edhe të shërbimeve, falë mekanizmave të përmendura më lart.</p> <p><i>Dokument 1 Statuti i USH</i></p>

personelit akademik, ndihmësakademik e administrative dhe studentëve e programit të studimit.	<p><i>Dokument 10 Manuali i cilësisë</i></p> <p><i>Dokument 6.4 Paketa e instrumentave të matjes së cilësisë në USH</i></p>		
<b>Kriteri 4.</b> Përfshirja dhe aktivizimi i aktorëve të brendshëm në proceset ciklike të vlerësimit duhet të respektojë integritetin akademik dhe të shmangë çdo lloj diskriminimi apo pabarazie kundrejt personelit dhe studentëve.	<p>IAL Përfshisn aktorë të brendshëm në proceset ciklike të vlerësimit. Kjo evidentohet nga mekanizmat e përmendur më sipër si dhe vendimet e marra për krijimin e Grupeve të Vlerësimit të Brendshëm. Nga takimi me GVB u evidentua pjesëmarrja e një pedagogu të jashtëm e cili vjen nga fusha e biznesit. Po kështu në këtë grup ishte present dhe një student.</p> <p><i>Dokument 1.2 Vendimi per GVB te Ad Biz (2).pdf</i></p> <p><i>Dokument 1.1.2 Vendimi per GVB te Ad Biz.pdf</i></p> <p><i>Dokument 5.3 Vendim per GVB, kordinatorët &amp; anet.</i></p> <p><i>Dokument Vendimi GVB Bachelor ADM-Biznes.pdf</i></p>		
<b>Kriteri 5.</b> Pjesë aktive e proceseve të vlerësimit dhe sigurimit të brendshëm të cilësisë, duhet të bëhen edhe bashkëpunëtorë dhe/ose ekspertë të jashtëm që kanë lidhje me programin e studimit apo mund të japin ekspertizë e mendime të vryera në lidhje me cilësinë e programit dhe përmirësimin e saj.	<p>Në raportin e vlerësimit të brendshëm citohet se “Krahas aktorëve të brendshëm, Institucioni konsultohet edhe me bashkëpunëtorë dhe/ose ekspertë të jashtëm për përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë së programit të studimit. Ekspertët e jashtëm janë profesorë të universiteteve të tjera brënda dhe jashtë vendit të ftuar në universitetin tonë; por edhe profesionistë të fushave të tjera si sipërmarrës biznesi, drejtues të institucioneve publike, etj. Megjithatë kjo praktikë nuk evidentohet konkretisht.</p> <p><i><u>GVJ rekomandon dokumentimin në të ardhmen e kësaj praktike.</u></i></p> <p><i>Dokument RVB Bachelor AB 2020-2023</i></p> <p><i>Dokument Vendimi GVB Bachelor ADM-Biznes</i></p>		
<b>Konkluzione</b>	<p><i>GVJ vlerëson që për programin e studimit Bachelor në Administrim Biznes, IAL përfshin njësitë akademike, personelin akademik e studentët në proceset e SBC-së të programit të studimit dhe informon palët e interesuara në lidhje me rezultatet dhe masat e marra në vijim të tyre.</i></p>		
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>		<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
			<b>X</b>

**Standardi VI.5**




**Politikat, proceset dhe veprimtaritë për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë për programin e studimit, duhet të jenë publike, transparente dhe efektive, dhe të synojnë krijimin e Kulturës së Brendshme të Cilësisë.**

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p><b>Kriteri 1.</b> Politika, strategjia, organizimi dhe veprimtaritë në kuadër të sistemit të Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë për programin e studimit janë transparente dhe bëhen publike për studentët dhe të gjithë të interesuarit.</p>	<p>Politikat dhe procedurat që lidhen me sistemin e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë për të gjitha programet e studimit përfshihen në Manualin e Sigurimit të Cilësisë, Statutin dhe rregulloren e Institucionit. Po kështu, IAL ka hartuar edhe strategjinë e komunikimit në të cilën evidentohet si objektivi për vitet 2022-2026 arritja si më poshtë:</p> <p>Përmirësimi i nivelit të komunikimit dhe informimit përmes zgjerimit të grupeve të audiencës me të cilat duhet komunikojë USH dhe brandimi i pikave të forta (sipas fakulteteve) nëpërmjet:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Intensifikimin e komunikimit brenda universitetit dhe normimin e tij përmes një rregulloreje të posaçme;</li> <li>• Krijimin e strukturave informuese për çdo fakultet, për komunikimin me publikun dhe brandimi i pikave të forta të secilit fakultet;</li> <li>• Transparencën në takimet që organizohen në fakultete dhe departamente, me qëllim qarkullimin e informacionit të gjithë stafeve të USH-së;</li> <li>• Hapësirën më të gjerë për komunikimin online përmes një linku në faqen e USH-së për komunikim direkt me publikun për çdo fakultet;</li> <li>• Decentralizimin e websiteve të USH-së për pasqyrimin e arritjeve, aktiviteteve shkencore e akademike, aplikime për punë, për bursa studimi etj.;</li> <li>• Krijimit të website për çdo departament;</li> <li>• Fushatat e informimit në institucione të arsimit parauniversitar, kombinuar me organizimin e "Ditëve të dyerve të hapura" në USH dhe ngjarjeve të përbashkëta për të nxitur përthithjen e studentëve të rinj përmes njohjes më të mirë të ofertës;</li> <li>• Rritjen e komunikimit me mediat sociale e vizive përmes një strategjie të mirëmenduar;</li> <li>• Përfshirjen e përfaqësive studentore në procesin e informimit dhe komunikimit;</li> <li>• Zgjerimin e komunikimit me audiencën më larg vëmendjes së deritanishme duke krijuar rrjete tematike (përdorimi i teknologjisë), të tilla, si: ish-studentët (alumn-it) dhe pedagogë; organizatat jofitimprurëse me fokus projektet e zhvillimit rajonal; qendrat kërkimore brenda dhe jashtë</li> </ul>

	<p>vendit, universitete të tjera; shoqëria civile; mjete advokuese dhe lobuese;</p> <p><i>Dokument 1 Statuti i USH</i></p> <p><i>Dokument 10 Manuali i cilësisë</i></p> <p><i>Dokument 3 Strategjia e Komunikimit 2022-2026</i></p> <p><a href="https://unishk.edu.al/aktivitete">https://unishk.edu.al/aktivitete</a></p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Institucioni i arsimit të lartë publikon rezultatet e vlerësimeve të programit të studimit, duke respektuar lirinë dhe etikën akademike, si dhe legjislacionin për të dhënat personale.</p>	<p>Në Universitet në përputhje me nenin 7 të ligjit 119/2014“Për të drejtën e informimit” është përgatitur programi i transparencës i cili konsiston në përcaktimin e rregullave bazë të organizimit dhe të funksionimit të universitetit në përputhje me legjislacionin për arsimin e lartë. Programi i transparencës në UNISHK i shërben rritjes së transparencës, integritetit dhe përgjegjshmërisë institucionale të universitetit sipas objektit dhe qëllimit të këtij ligji duke pasur parasysh interesin më të mirë të publikut.</p> <p><u>Urdhërin nr.1359 prot, datë 19.04.2021 "Për miratimin e Programit të Transparencës së Rishikuar në USH".</u></p> <p>Në listën e aktiviteteve të UNISHK paraqiten dhe degjësat publike në lidhje me vlerësimet e ASCAL, degjësja që kanë si fokus ndarjen e rezultateve dhe rekomandimeve midis palëve të interes dekanë, drejtues departamenti, staf akademik, si dhe përfaqësues të rektoratit.</p> <p><b><u><a href="https://unishk.edu.al/multimedia/fotogaleri/degjese-publike-per-raportin-e-sigurimit-te-cilesise-qe-do-paraqitet-ne-ascal-te-akreditimit-te-dyte-institucional">https://unishk.edu.al/multimedia/fotogaleri/degjese-publike-per-raportin-e-sigurimit-te-cilesise-qe-do-paraqitet-ne-ascal-te-akreditimit-te-dyte-institucional</a></u></b></p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Rezultatet e vlerësimit duhet të shoqërohen me një plan masash, që adresojnë dhe synojnë përmirësimin e mangësive e dobësive të evidentuara.</p>	<p>Vlerësimet e kryera dhe rezultatet përkatëse për programin pasqyrohen në Raportin Vjetor të Departamentit dhe shoqërohen me një plan veprimi. Duke u nisur nga ky plan veprimi dhe bazuar në një kalendar të brendshëm, Rektorati i kërkon Përgjegjësve të Departamenteve dhe Dekanëve që të hartojnë projekt-buxhetet e tyre me zërat përkatës duke përfshirë nevojat akademike dhe aktivitetet e departamentëve që synojnë rritjen dhe përmirësimin e cilësisë akademike.</p> <p><i>2017-XVII. ANALIZA MESIMORE- SHKENCORE...</i></p> <p><i>Dokument analiza e punes kerkimore shkencore FE -...</i></p> <p><i>Dokument: Analiza e punes shkencore e Ad-Biz, 19-...</i></p> <p><i>Dokument Analiza e punes shkencore e Ad-Biz, 21-...</i></p> <p><i>Dokument Analiza e punes shkencore 2019-2020 e...</i></p> <p><i>Dokument Analiza procesit mesimor FE 2018-2019</i></p> <p><i>Dokument Analiza punes kerkimore shkencore FE 17...</i></p>



<p><b>Kriteri 4.</b> Institucioni vlerëson dhe siguron efektivitetin dhe ndikimin e veprimtarive në kuadër të monitorimit e vlerësimit të cilësisë në përmirësimin në vijim të cilësisë së programit të studimit.</p>	<p>GVJ vlerëson në lidhje me këtë kriter një harmonizim më të mirë të aktiviteteve të të strukturave të ndryshme të IAL me KPSSC dhe NjSBC në mënyrë që të sigurojë një koherencë, efektivitet dhe gjithëpërfshirje në sigurimin e cilësisë <i>(Dokument 2.13 Raport përmbledhës mbi NJSBC).</i></p>		
<p><b>Kriteri 5.</b> Institucioni organizon veprimtari periodike me personelin dhe studentët për informimin dhe ndërgjegjësimin e tyre për sigurimin dhe përmirësimin afatgjatë të cilësisë së programit të studimit.</p>	<p>Sipas RVB por edhe nga sa u tha më sipër evidentohet që Personeli akademik i FE-UNISHK është vazhdimisht i informuar mbi rezultatet e procesit të vlerësimit të brendshëm të cilësisë. Analizat e punës mësimore shkencore të zhvilluara periodikisht, analizat e pyetësorve të pedagogëve dhe të programit u bëhen me dije përmes mbledhjeve përkatëse në nivel departamenti dhe fakulteti. Studentët janë gjithashtu pjesë e këtij procesi përmes përfaqësuesve të tyre në organet e USH-së, por edhe përmes diskutimeve e takimeve me to me focus përmirësimin e cilësisë.</p> <p><i>Dokument 3 Strategjia e Komunikimit 2022-2026</i> <a href="https://unishk.edu.al/aktivitete">https://unishk.edu.al/aktivitete</a></p> <p><u>Urdhërin nr.1359 prot, datë 19.04.2021 "Për miratimin e Programit të Transparencës së Rishikuar në USH".</u> <a href="https://unishk.edu.al/multimedia/fotogaleri/degjese-publike-per-raportin-e-sigurimit-te-cilesise-qe-do-paraqitet-ne-ascal-te-akreditimit-te-dyte-institucional">https://unishk.edu.al/multimedia/fotogaleri/degjese-publike-per-raportin-e-sigurimit-te-cilesise-qe-do-paraqitet-ne-ascal-te-akreditimit-te-dyte-institucional</a></p>		
<p><b>Konkluzione</b></p>	<p><i>GVJ vlerëson që IAL po bën përpjekje të vazhdueshme për të bërë publike. Politikat, proceset dhe veprimtaritë për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë për programin e studimit nëpërmjet një sërë strategjish ndërsektoriale si ajo e Komunikimit dhe Transparencës që lidhen direkt me këtë standart.</i></p>		
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>		<p><b>Përmbushet kryesisht</b></p>	<p><b>Përmbushet plotësisht</b></p> <p style="text-align: center;"><b>X</b></p>
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës VI</b></p>		<p><b>Përmbushet kryesisht</b></p> <p style="text-align: center;"><b>X</b></p>	<p><b>Përmbushet plotësisht</b></p>

**Përfundime të Vlerësimit të programit të studimit të ciklit të parë Bachelor në:  
“Administrim Biznes”**

**a. Pikat e forta dhe afirmime:**

1. Përvoja shumë vjeçare në tregun e arsimit të lartë të programit të studimit;
2. Ndërkombëtarizimi i vazhdueshëm i stafit të angazhuar në programin e studimit dhe pjesëmarrja në projekte/mobilitete trajnimi, i mundëson personelit akademik dhe studentëve të përfitojnë nga shkëmbimi dhe bashkëveprimi me kërkues shkencor nga BE-ja, përfshirë këtu pjesëmarrjen në trajnime dhe konferenca tematike;
3. Stafit PAK i angazhuar në programin e studimit vjen nga eksperiencia e biznesi, drejtimi i institucioneve publike e private me peshë në qark, duke luajtur një rol të rëndësishëm në ndërveprimin universitet – biznes ose departament- biznes;
4. Staf proaktiv dhe i angazhuar në projekte kombëtare dhe ndërkombëtare dhe në aktivitetet me karakter shkencor të UNISHK;
5. Godina, biblioteka, ambjentet mësimore janë të një standarti të lartë duke krijuar në këtë mënyrë një mjedis që mbështet arritjen e objektivave të programit të studimit;

**b. Pika të dobëta:**

1. Mungon përditësimi i syllabuseve , i literaturës dhe formave të kontrollit të studentëve, (*Standardi II.3, kriteri 4, & Standardi II.4, kriteri 5*) si dhe mungon pasqyrimi i kërkimit shkencor të stafit PAE/PAK në syllabuset e lëndëve që ato ofrojnë (*Standardi III.1/kriteri 3*)
2. Mungesa e lëndëve si inovacion, psikologji, sociologji, digjitalizimi në biznesin e vogël etj; (*Standardi III.4/kriteri 1*)
3. Mungesa e një sinergjie institucionale në funksion të planifikimit, vlerësimit dhe monitorimit të cilësisë (*Standardi V.5 /Kriteri 4*) Mungesa e një raporti vlerësimi cilësie 360 gradë. Raporti permblledhes mbi NJSBC në nivel fakulteti 2023 ofron vetëm një përgjigje të reduktuar të gjetjeve të pyetësorit të studentëve pa një narrative konkrete në lidhje me masa të tjera për sigurimin e cilësisë; (*Standardi VI.1 /Kriteri 2*)

**Rekomandime**

1. GVJ rekomandon që krahas përmirësimit të metodologjisë së kërkimit të tregut për identifikimin e kompetencave aktuale dhe ato të ardhshme të hartohet dhe një analizë Benchmarking ku të analizohen programe studimi të ngjashme në rajon BE dhe më gjerë të cilat janë përdorur si referencë për ndërtimin e programit të studimit. Konsultimi i vazhdueshëm i programeve të ngjashme brenda dhe jashtë vendit do t'i shërbejë IAL-së për të përditësuar dhe ndërtuar një program studimi kompetitiv dhe me impakt në tregun e punës duke pasur parasysh evolucionin e madh teknologjik;
2. GVJ vlerëson dhe rekomandon në lidhje me programin e studimit
  - përshtatjen e programit me nevojat e tregut;



- rishikimi i tërësisë së lëndëve që ofrohen, futja e disa lëndëve të reja që lidhen me zhvillimet e fundit teknologjike, zvogëlimi i peshës së lëndëve të financë – kontabilitetit, kalimi i disa lëndëve në MA dhe anasjelltas;
  - formulimi i silabuseve në përputhje me VKM 41/2018 dhe në gjuhën angleze si dhe një mënyrë vlerësimi kah vlerësimin të vazhduar ( pra më pak peshë provimit final);
  - përditësimi i literaturës dhe përfshirje punimeve shkencore të pedagogëve në literaturën e rekomanduar apo në rastet studimore të mbështetura;
3. GVJ sugjeron pajisjen e FE me një zyrë për informimin dhe karrierën si dhe apo ngritjen e një HUB për studentët e AB dhe mbi të gjitha për një dinamikë që krijon sinergji dhe optimizëm në institucion;
  4. GVJ sugjeron përmirësimet e duhura sa i përket një strategjie të mirëfilltë për mediat sociale dhe komunikimin e integruar;
  5. GVJ sugjeron një frekuencë vjetore në drejtim të auditimit të sekretarisë mësimore;

**Evaluation's conclusions for the first cycle study program Bachelor in "Business Administration"**

**a. Strengths and affirmations:**

1. Many years of experience in the higher education market of the study programme in question;
2. The continuous internationalization of the staff involved in the programme and the participation in training projects/motilities enable academic staff and students to benefit from exchanges and interactions with researchers from the EU, including participation in training and thematic conferences;
3. The staff involved in the programme will play an important role in the interaction between the university and the business world, or between the faculty and the business world, with experience in the business world and in the management of public and private institutions of importance in the region;
4. Proactive staff involved in national and international projects, and in UNISHK scientific events;
5. An environment that supports the achievement of the programme's objectives, with buildings, library and teaching facilities with the required standards;

**b. Weaknesses:**

1. The absence of updating of curricula mechanism, and lack of ongoing student assessment (*Standard II.3/ Criterion 4, & Standard II.4/ Criterion 5*); No existing practices on the inclusion of the scientific research of PAE/PAK staff in the curricula of the courses they offer (*Standard III.1/Criterion 3*)

2. Lacking subjects related to the existing market demand such as innovation, psychology, sociology, digitalization in small enterprises, etc; *(Standard III.4/criterion 1)*
3. Lack of institutional synergy in terms of planning, evaluation and quality monitoring *(Standard V.5 / Criterion 4)*. The lack of a 360 Degree Quality Assessment Report, (the 2023 NJSBC Faculty Summary Report provides only a reduced response to the results of the student questionnaire without a concrete narrative regarding other quality assurance measures; *(Standard VI.1 / Criterion 2)*

## **Recommendation**

1. EEG recommends that in addition to the improvement of the market research methodology for the identification of current and future competencies, a benchmarking analysis should be carried out to analyse similar study programmes in the EU region and beyond, which have been used as a reference for the construction of the study programme. The continuous consultation of similar programmes inside and outside the country will serve the HEI to update and build a competitive study programme with an impact on the labour market, taking into account the technological disruption;
2. Regarding the study programme the following recommendations are presented
  - Adaptation-update of the programme to the needs of the market,
  - The revision of the subjects in alignment with the previous point; the introduction of new courses related to the latest technological developments, reducing the weight of financial accounting topics in this study programme; transferring some subjects to the Master of Science program and vice versa,
  - the formulation of syllabi in accordance with VKM 41/2018 and in English to, as well as an assessment method towards continuous assessment (i.e. less weight on the final exam),
  - literature update according to VKM 41; include the scientific work of the lecturers in the recommended literature or in the supported case studies.
3. GVJ suggests equipping FE with an office for information and career as well as setting up a HUB for AB students and above all for a dynamic that creates synergy and optimism in the institution;
4. GVJ suggests appropriate improvements in terms of a proper strategy for social media and integrated communication;
5. EEG recommends an annual frequency in terms of auditing the university secretariat;



**Shkalla e përmbushjes së standardeve të cilësisë së programit**

FUSHAT E VLERËSIMIT	SHKALLA E PËRMBUSHJES SË STANDARDEVE TË FUSHËS			
			Përmbushen kryesisht	Përmbushen plotësisht
I. OFRIMI, I PROGRAMIT TË STUDIMIT				X
II. ORGANIZIMI, DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI I PROGRAMIT TË STUDIMIT TË CIKLIT TË PARË BACHELOR			X	
III. MËSIMDHËNIA, MËSIMNXËNIA, VLERËSIMI DHE KOMPETENCAT				X
IV. BURIMET NJERËZORE, FINANCIARE, INFRASTRUKTURA, LOGJISTIKA PËR REALIZIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT				X
V. STUDENTËT DHE MBËSHTETJA E TYRE				X
VI. SIGURIMI I CILËSISË SË PROGRAMIT TË STUDIMIT BACHELOR			X	
<b>VLERËSIMI TËRËSOR</b>				<b>X</b>

*ECOR*

*gn*